

Pëllumb
Kulla

PORTRETE
PA
MAK IAZH

Skeçe
monologë
dialogë
komedi me një akt



8/H-2
K 98

Pëllumb
Kulla

PORTRETE
PA
MAKIAZH

20366

skeçe

monologë

dialogë

komedi me një akt

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJERIU I VITIT 2001

(Intervistë e gëzueshme me një njeri të pararojës)

- Profesioni?
- Shofer.
- Për llogari të cilit vit punoni?
- Për llogari të vitit 2001
- Kjo është fantastike! Ju jeni një njeri që keni kapërcyer kufijtë e shekullit tonë. Shumë paskeni ecur!
- E po me makinë ecet shpejt.
- Sa makina keni ndërruar për të vajtur deri në vitin 2001.
- Ehu, sa të ndërrosh makinën, të tjerët të kanë lënë në bisht. Kam mbajtur atë që kisha.
- Jeni i martuar?
- Po. Jam martuar para tetë vjetësh, në vitin 1993.
- A keni fëmijë?
- Në maj të vitit 1994 në shtëpi patëm një gëzim: ime shoqe mbeti shtatzënë dhe fiks pas dy vjetësh lindi djalë.
- Pas dy vjetësh? Sikur fëmijët nuk... Kaq lindje e vonuar?!
- Jo... Të kuptohemi... Ajo lindi normalisht, por ne me shokët gjatë nëntë muajve plo-

- tësua planin e dy vjetëve... Unë flas me kalendarin tonë.
- Keni një kalendar të çuditshëm!
 - Po shumë të bukur ama... Ja për shembull jua merr mendja ku e kemi festuar shekullin e ri, dua të them Vitin e Ri 2001?
 - Me siguri në ndonjë apartament të ngrohtë në mes të bollëkut, verës e portokalleve... Pranë zjarrit.
 - Ç'zjarr më thoni?!... Nën një rrap, pranë një burimi të ftohtë.
 - Jashtë?! Vitin e Ri nën një rrap?! Brrr. Kushedi se si ishit veshur.
 - Ishim katër shokë. Që të katër në kanotiere.
 - Me kanotiere? Jashtë?! Në fund të dhjetorrit?!
 - Kush tha dhjetor? Ishte qershor e ne prisnim të transportonim grurin e parë. Gruri qe bërë det, ne hanim mish, pinim ujë të ftohtë e uronim Vitin e Ri e bukën e re. Verë nuk guxonim të vinim në gojë se trembeshim mos na fluturonte patentat.
 - Pse, edhe me ju të vitit 2001, i rreptë është kontrolli rrugor?
 - Jo në 2001 të kesh shkuar po dhe në 3001! Të falin ata!
 - Duke biseduar me ju na duket vërtet sikur vini nga e ardhmja e bukur e vendit tonë. E dini çfarë? Na përshkruani një nga ditët e vitit 2001.
 - Posi. Gjendem në kabinën komode të një kamioni dymbëdhjetëtonësh të markës shqiptare dhe udhëtoj me shpejtësi në autostradë. Më parakalojnë vetëm disa vetura të tipit të fundit që ka nxjerrë uzina jonë e automobilitave. Për një çast eci paralel me trenin e linjës Shkodër-Sarandë. Në kabinë kam

gazetën. Aty është botuar orari i ri i trenave që nisën nga Korça, nga Vlora dhe nga Peshkopia. Në fund të orarit, për pasagjerët ka këshilla që të frekuentojnë vagonët-bufe dhe vagonët-bibliotekë, gjë që do t'ua bënte atyre rrugën më të këndshme dhe nuk do t'i ndienin vonesat.

— Pse, dhe atëherë do të vonohen trenat?!

— Epo ç'ti bësh, mik i dashur! Sado të ecim përpara ca mbeturinë të keqe nga e kaluara. Me sa duket qenkan zor për t'i shkukur!



GJYSHI DHE NIPI

Dialog

Personat:

GENTI

GJYSHI I GENTIT.

Në një rrugicë parku. Gjyshi ecën ngadalë duke lexuar gazetën.

GJYSHI — *(Kthen kokën pas.)* Genti, shpejtoi hapat! Ja këtu do të presim Albanën të vijë nga kopshti.

(Hyn Genti duke ecur ngadalë, i ngrysur.)

GJYSHI — E shoh unë, ti do që të të marr në krahë.

GENTI — Nuk dua të më marrësh në krahë.

GJYSHI — Po atëherë ç'ke? Kam gjithë ditën me ty. Të kisha marrë Albanën. Ajo është vajzë e urtë... Do prapë akullore?

GENTI — Jo, s'dua!

GJYSHI — Për qejfin e zotërisë sate vajtëm deri tek sarajet e Sinan beut... Kujton

se më kishte marrë malli për to? «Gjysh,
më trego për beun, më trego!»

GENTI — Asgjë nuk më tregove!

GJYSHI — Epo, unë nuk e nxjerr dot beun
nga varri të ta tregoj ty! Sarajet kanë mbe-
tur, ato t'i tregova!

GENTI. — Po. Më gënjeve.

GJYSHI — Pa shiko, djalë i prapë! Gënjen
gjyshi?!

GENTI — Më gënjeve.

GJYSHI — Për kokën tënde jo. Ja, aty jetonte
beu.

GENTI — A the që beu jetonte njëqind herë
më mirë se ju?

GJYSHI — Thashë!

GENTI — Ç'i kishte ato shtëpi beu! Errësirë!
Me mure të trasha! Dritare të vogla, shka-
llë të ngushta! Janë ato më të mira se pa-
llati ynë?

GJYSHI — Avash, avash ti... S'kemi pasur kë-
to pallate ne atëherë. Ne rronim në ka-
solle. Po ti ke të drejtë. Duhet të të tre-
goja më parë kasollet. Më fal.

GENTI — Nuk të fal. Më trego kasollet.

GJYSHI — Oho... kasolle s'gjen një për nishan!

GENTI — Mos më gënjen prapë?

GJYSHI — Jo, për fjalë të nderit!


(Pauzë!)

GENTI — E si kanë qenë kasollet?

GJYSHI — Të vogla, përdhese. Bëheshin me
gardhe të ngjeshura me baltë. Mbuluar
me bar e kashtë.

GENTI — Sipër barit ishte hedhur çimentoja?

GJYSHI — Jo, or, çfarë çimento! Bar, o, bar, vetëm bar.



GENTI — Nuk ju fundosej këmba kur hipnit lart në çati?

GJYSHI — Ç'punë kishim në çati ne!

GENTI — Po si i rregullonit antenat?

GJYSHI — Hej be-la! Ku kishte antena atëherë, mor shpirt i gjyshit!

GENTI — Punonte televizori pa antenë?

GJYSHI — Mos më ç'mend, Genti! Ne nuk kishim bukë, ti

thua televizor. Bukë, o, bukë s'kishim, dë-gjon?

GENTI — S'kishit bukë! Po ku e shtronit gjalp-in e mjaltin?

GJYSHI — Kam faj unë që të tregoj ty!

GENTI — Mirë, mos më trego. Do t'i lutem babit të m'i tregojë. Kur s'di të m'i tregosh...

GJYSHI — Kush s'di të tregojë?

GENTI — Ti.

GJYSHI — Unë?! Kam faj unë se ti nuk ha pykë?

GENTI — (*E shikon ngultas.*) Kujt i thonë pykë?

GJYSHI — Pykë i thonë asaj që ti nuk e kupton që ne rrinim barkthatë. Vuanim nga sëmundjet e s'kishim ilaçe, s'kishim gjilpëra.

- GENTI — S'kishit gjilpëra!? Sa qejf!
- GJYSHI — Qejfi i tyt eti! Kam faj unë që bëj muhabet me ty. Po më nxjerr djersët. Nuk të flas më!
- GENTI — As unë s'të pyes më!
(*I kthejnë kurrizin njëri-tjetrit.*)
- GJYSHI — (*Me vete që të dëgjojë Genti.*) Si nuk erdhi kjo Albana nga kopshti!
- GENTI — (*Me vete që të dëgjojë gjyshi.*) Si nuk u kthye ky babi nga puna!
- GJYSHI — Albana është vajzë e urtë.
- GENTI — Të pëlqen Albana se është qulle. Ajo s'di të pyesë, ti s'di të tregosh: jeni të dy njësoj!
- GJYSHI — Hajd, hajd, mos na çudit tani! Unë kam ca zor se... Ja më pyet, të jap fjalën e nderit që nuk do të nxehem më.
- GENTI — Nxehesh.
- GJYSHI — Fjalë burrash, ja, toke!
(*Tokin duart.*)
- GJYSHI — E lamë te ilaçet... Atëherë jo ilaçe po s'kishte as doktorë. Duhet të merrje rrugën e Tiranës. Me gomar. Ec e ec. Nisëshim në mëngjes shpejt.
- GENTI — Pse, kur nisej treni i parë atëherë?
- GJYSHI — (*Mban zemërimin.*) Ku kishte atëherë tren të parë e të dytë?!
- GENTI — Ishte vetëm i treti?
- GJYSHI — U dorëzova, dëgjon? U dorëzova... S'e mbaj dot fjalën. U nxeha...
- GENTI — Unë të thashë, po ti... (*Largohet.*)
- GJYSHI — S'ka faj djali! Ky kujton se tërë këto të mira kanë qenë gjithmonë. S'e di ky që tërë këto i vumë me luftë e djersë në këtë kohë të Partisë. Plak ma-

tuf! E ke zor?... Po shpjere në muze!
Pse është muzeu. Aty i ke të tëra: të
djeshmen dhe të sotmen. Dhe realitetin
dhe Baba Qemon.

GENTI — (I fshehur, nxjerr kokën.) O gjysh,
kujt i thonë Baba Qemo?

O BURRA SE NA ZUNË

Skeç

Personat:

JONUZ BEU
REFATI
SELAMI
MAJORI FRITÇ
BALLISTË E GJERMANË

Në një oborr të shkretuar disa ballistë të lodhur rrinë të pikëlluar rreth komandantit të tyre. Jonuz beut. Disa janë të plagosur.

JONUZI — Po si ore, ne njëzet vetë, ai fillikat të na ikë?!

REFATI — E mbajtëm rrethuar njëzet e katër orë dhe nuk e zumë dot. More po, s'kemi luftëtarë ne jo! Kemi ca sahanlëpirës, ca dembelë.

JONUZI — Laro, thuaj, pizevengë, gjahtarë kotecesh!

(Që larg vjen me vrap Selami. Ndal vrapin dhe shikon përreth.)

SELAMI — Ç'ka ndodhur? Pse e prishët rrethimin? E zutë?

JONUZI — Komunisti na iku.

SELAMI — Si!!

BALLISTI — Na e la shëndenë.

SELAMI — Mos! (*Plaset përdhe.*) Na piu e zeza, Jonuz bej! Kaq e patëm!

JONUZI — Pse çirresh kështu, more halldup! Ç'ke?

SELAMI — Majori Fritc do të na djegë të gjallë.

JONUZI — Majori Fritc?!

SELAMI — Tani vij nga shtabi gjerman. Ai ishte tërbuar. Turp, tha, një çetë e Ballit kundër një komunisti! Po nuk e zutë të gjallë deri në orën katër, do t'ju lyej me benzinë dhe do t'ju vë flakën duke filluar nga krerët.

(Ballistët ngrihen të alarmuar.)

REFATI — Ç'po na thua, Selam?! Mbaruam!

SELAMI — Nga t'ia mbajmë, more vëllezër?

NJË BALLIST — Oh, moj nënë, të zeztë ne!

JONUZI — Ora është katër pa dhjetë. Kaq e patëm! Fritci e mban fjalën.

(Pështjellim në radhët e tyre.)

SELAMI — Po sikur të marrim arratinë, Jonuz bej?

JONUZI — Ku të vemi? Tek partizanët? Të shpëtojmë nga benzina e të na lyejnë shamikuqtë me vajguri?!

SELAMI — Mbaruam!

REFATI — O po kaq e pati kjo punë, thuaj! Ah, ah!

(Selami i bën me shenjë Jonuzit dhe e heq mënjanë.)

REFATI — O po ç'qe kjo ditë e zezë, mor aman!

NJË BALLIST — Apo të kursejnë tedeskot. Sa më shumë u afrohet fundi, aq më të egër bëhen. Ububu, moj nënë!

JONUZI — Refat!

REFATI — Urdhëro, bej!

JONUZI — Pa hajde pak këtu! (*Pasi i afrohet Refati.*) Dëgjo, Refat! E do beun tënd?

REFATI — Jap jetën për ty, bej, të paça sa malet!

JONUZI — Dëgjo këtu! Duhet ta gënjejmë Fritcin.

REFATI — Po qysh ta gënjejmë?

JONUZI — Ty të takon detyra e madhe historike të shpëtosh beun tënd nga benzina, t'i shpëtosh nderin çetës sonë balliste.

SELAMI — Atdheu nuk do të ta harrojë kurrë këtë, Refat!

JONUZI — As brezat që vijnë dhe as ata që shkuan.

REFATI — Fol, Jonuz bej, se mezi po qëndroj më këmbë.

JONUZI — Kurajo, trimi i beut! Na kanë mbetur vetëm tri minuta. Hiqi këto shenjat e ballit, hiqe këtë festë të nderuar, zbra-thi çizmet dhe futu në atë haur në vend të komunistit që na iku.

REFATI — E pastaj, Jonuz bej, fol aman!

JONUZI — Fritci nuk të njeh. Pas një beteje të ashpër ne do të të zemë.

REFATI — E pasi të më zini?

JONUZI — Pasi të të zemë, do të të dorëzojmë tek Fritci.

REFATI — Bej, më thahet pështyma kur e mendoj.

JONUZI — Mos u bëj budalla! Ne prapë të kemi në dorë. Po qe se ai jep urdhër të pushkatohesh, ekzekutimin do ta kryejmë ne.

REFATI — Nuk ka ilaç tjetër?

JONUZI — Nuk kemi kohë për të menduar.

REFATI — Falmë, o bej, po se si më vjen.

JONUZI — Pizeveng! Vetëm me fjalë e jep jetën për beun tënd ti?! Apo ke qejf që të më lyejë Fritci me benzinë, të ngrohen këta çapaçulët e të pjekin bërçolla në flakën time.

REFATI — Jo, po shiko...

SELAMI — Edhe dy minuta kohë ke.

NJË BALLIST — Që larg po duket vetura e Fritcit.

JONUZI — (*Sheh orën dhe ia heq kapelen Refatit.*) Hajde, hajde se s'të gjen gjë. Na shpëto një herë për një herë, pa shohim e bëjmë.

REFATI — (*Duke qarë.*) Aman, bej!

JONUZI — Hajde, hajde, mbaje veten si komunist. Shiko se mos më qan, se ta hoqa koburen time. (*Jep urdhër.*) Rrethoni vendin! Ju të tjerët na ndihmoni ta zhveshim.

(*Ballistët zhveshin Refatin.*)

SELAMI — Ashtu, zbathur. Prishi flokët!

REFATI — Aman, o bej!

JONUZI — (*Selamit.*) Skuadra jote t'i ketë fisheskët pa plumba në rast pushkatimi... Tani shpërndahuni!

REFATI — Në dorën tënde, bej!... Më paç më qafë, o bej!

JONUZI — (*E shtyn.*) Budalla! Ti na ke në dorë të gjithëve. Të qëllosh në ajër edhe ti, o Refat!

REFATI — Ku kam takat unë për ta zbrazur, o bej!

(*Refatin e nxjerrin nga skena duke qarë. Ndizet një luftë e ashpër.*)

JONUZI — Përpara, o asllanët e Ballit Kombëtar!... Përpara, o fajkonj sypatrembur!
(*Bie barkas.*)

ZËRA — Yxhym!

NJË ZË — Dorëzohu!

TJETRI — Përpara, burra!

(Në skenë futet Fritci, i përkulur, me revolver në dorë. Pastaj shtrihet. Barkaz Jonuzi dhe Fritci i afrohen njëri-tjetrit. Gjermanët e tjerë janë hapur në formacion luftimi.)

JONUZI — Her major, do ta zëmë komunistin. Punë sekondash. Ora s'ka vajtur akoma katër.

FRITCI — Ja, ja, shnel!

JONUZI — Përpara, o luanë të lavdishëm! Gjermania e madhe është me ne! Dorëzohu, o qafir!

(Të shtënat arrijnë kulmin. Nga prapa skenës dëgjohen thirrje: «E zëmë, e zëmë!» Jonuzi dhe Fritci ngrihen më këmbë. Tre ballistë sjellin për krahësh Refatin, ca e shtyjnë me tyta.)

JONUZI — *(E kap prej fyti.)* Maskara! Kujtove se do të më shpëtoje, ëh! Na! *(E qëllon me pëllëmbë.)*

REFATI — *(Nën zë.)* Sikur nuk e patëm kështu, bej!

SELAMI — *(Nën zë, që pas.)* Thirr «Poshtë Hitleri!» Thirr «Kaput Hitleri!», mor tutkun!

REFATI — *(Nën zë.)* E ha unë atë! Pa shikoje koburen? Nuk të durojnë për Hitlerin këta.

SELAMI — Po thirr, more edepsëz se na nxorre lakrat sheshit!

REFATI — Poshtë... Jonuz beu! Kaput Jonuz beu!

JONUZI — A të hëngsha gurmazin! A nuk ke guxim më lart, pizeveng?!

FRITCI — *(Refatit.)* Ti shokë ku?

SELAMI — (Nën zë.) Qëndro si burrë!

FRITCI — Ti shokë ku?

REFATI — Këtu.

FRITCI — Shokë të tjera?

REFATI — Në mal.

FRITCI — Ale imer zagen zoeben!

REFATI — Çfarë thotë, o Jonuz bej, aman!

JONUZI — Jonuzi i tyt eti. Hë tani që të zumë.

Hë!

REFATI — Poshtë Jonuz beu!... Kaput Jonuz beu!

FRITCI — Pushkatim!

JONUZI — Javol, her major!

REFATI — Shiko se mos kanë harruar t'i heqin plumbat ata.

JONUZI — (Selamit.) I hoqët plumbat?

SELAMI — Si urdhëron, bej! Skuadra, gatitu!

Gati për zjarr!

REFATI — Kaput Jonuz beu, kaput!

SELAMI — Zjarr!

(Dëgjohen krisma, Refati bie si i vdekur.)

FRITCI — (Vë dorën te koburja.) Noh ajnen mit revolver!

JONUZI — Na fiku! Do ta qëllojë vetë me revolver në kokë. Po e pa Refati do të ngrihet dhe do të marrë fund meseleja.

REFATI — (Me një sy të hapur.) E hëngra më duket!

(Në këtë kohë dëgjohen thirrje e urra të fuqishme. Zëra nga larg: «Para partizanë! «Të gjithë ilkin me vrap nga sytë këmbët. Në shesh mbetet vetë Refati i shtrirë që hap sytë dhe pastaj vë kujen.) Ngrehuni, o të vdekur, se na zunë të gjallët!

(Largohet me vrap pas të tjerëve.)

FRYMA VULLNETARE

Skeq

Personat:

XHEVITI — mësues

VASILI — mësues

MARIKA — e shoqja e Vasilit

NËPUNËSI I ROJËS

TË RINJ E TË REJA...

(Në sallonin e pritjes së popullit. Duket dhe një copë rrugë. Nëpunësi i rojës bisedon në telefon. Lëvizje nëpër sallon.)

NËPUNËSI — *(Në telefon.)* Mbledhja me të rinjtë që kanë shfaqur dëshirën për në fshat fillon tani. *(Lë telefonin.)*

(Paraqiten dy të rinj.)

I PARI — Ku bëhet mbledhja?

NËPUNËSI — Ju jeni për në fshat?

I DYTI — Po.

NËPUNËSI — Kaloni këtej. Tani fillon.

20366
~~80881~~

(Kalojnë. Vjen një i tretë.)

I TRETË — Mund të futem dhe unë?

NËPUNËSI — Për fshat? Ke shfaqur dëshirën?

I TRETË — Jo... Unë dua ta shfaq sot.

NËPUNËSI — (Qesh.) Futu dhe ti!

(I riu falënderon dhe futet. Ndërkohë në rrugë shfaqen Vasili dhe e shoqja.)

VASILI — E mori djalli, i harrova të gjitha.

MARIKA — E di unë... Çorbë do t'i bësh... Uf!...
Po të thashë, more Vaskë, shkruaji në një gisht letër dhe hidhja sytë me marifet.

VASILI — Moj, po s'ka lezet me letër.

MARIKA — S'ka thotë... Uu! Kot që vete... Na paç në qafë, dëgjon?

VASILI — Harrova si ta nis.

MARIKA — Njëzet e shtatë herë ta kam kujtuar!... S'ta kujtoj më... Nise si të duash!...
Dhe po harrove, veç një gjë mos harro t'i thuash: shoku Agim, më kanë caktuar, por unë në fshat nuk shkoj.

VASILI — Nuk shkoj... Po si ta nis?

MARIKA — Uf!... Do t'i thuash që ke dymbëdhjetë vjet në arsim... Që me ujin që kemi këtu të është stabilizuar kוליti... Thuaj që këtu ke fituar simpatinë e nxënësve. Të kishe marrë atë fotografinë ku ke dalë mes nxënësve!

VASILI — Nuk e mora.

MARIKA — Thuaj që ke ngatërresa familjare...
Thuaja!

VASILI — Sikur nuk ka lezet!

MARIKA — Thuaja! S'ka gjë... Thuaj: Gruaja me nënën nuk shkojnë. Kur grinden, thu-

aj, nënën e çoj nga motra dy-tri ditë sa shihen gjakrat. Po në fshat si t'ia bëj?

VASILI — O po mirë, kjo zgjidhet do të thotë ai... Kjo është subjektive.

MARIKA — Subjektive?... Me atë nënë që ke ti, Vaskë, kjo është objektive e s'e luan topi!... Po lëre se më hipën tani që e kujtova... Thuaja... Dhe atë të shtëpisë thuaja...

VASILI — T'ia them?!

MARIKA — Posi! Sa rregullova shtëpinë, thuaj, të iki?!... Vesha banjën me pllaka majolikë. Leva muret me bojë vaji... Nuk është e drejtë!

VASILI — Marika, nuk shkon kjo e shtëpisë! Është turp, de!

MARIKA — Pse turp? Na ranë duart.

VASILI — T'i them vetëm atë të kolutit dhe simpatinë e nxënësve.

MARIKA — Të gjitha! Dhe simpatinë që kanë nxënësit për ty dhe antipatinë që ka vje-hrra për mua. Kuptove?

VASILI — I kuptova të tëra. Po të më thotë: do të shkosh...

MARIKA — Ti i thuaj: nuk vete! Po me shumë respekt.

VASILI — (*Merr zemër.*) Ai do më thotë: Do të shkosh! — Nuk vete! — do t'i them unë. Pikë!... Dymbëdhjetë vjet në arsim! Kam kolutin, kam motrën.

MARIKA — Nënën!

VASILI — Motrën që të shpie nënën... Mirë të gjeça! (*Niset.*)

MARIKA — (*Që pas.*) Simpatinë e nxënësve! (*Del nga ana tjetër. Veprimi zhvendoset tek*

*nëpunësi i rojës. Dëgjohen duartrokitje.
Vasili i afrohet nëpunësit.)*

VASILI — Desha të takoja shokun Agim.

NËPUNËSI — Është në mbledhje me vullnetarët që shkojnë në ndihmë të bujqësisë.

VASILI — Do të më presë?

NËPUNËSI — Ç'punë kini me të?

VASILI — Jam arsimtar... Duhet të shkoj në fshat.

NËPUNËSI — *(Buzëqesh)* Aha... Jeni nga ata vullnetarë...

VASILI — Jo është ndryshe puna.. Mund t'jua shpjegoj?

NËPUNËSI — Si të doni. Flisni.

(Vasili bëhet gati të flasë. Në sallë shpërthejnë duartrokitje. Vasili flet në mes të zhurmës. Nga lëvizjet kuptojmë se ai ankohet për kolin, për grindjet, flet për simpatinë që kanë nxënësit për të. Duartrokitjet pushojnë.)

NËPUNËSI — Më falni, s'mora vesh asgjë. Ka shumë të rinj; e ka mbetur dera hapur. Flisni.

VASILI — Puna është se unë kam dymbëdhjetë vjet në arsim.

NËPUNËSI — Shumë mirë.

VASILI — Por...

(Bie telefoni.)

NËPUNËSI — *(Në telefon.)* Po. Merreni në zyrë. *(Lë telefonin.)* Urdhëroni *(Vasili matet të flasë, bie përsëri telefoni. Nëpunësi e merr.)* Posi. E pushë... Tani sapo doli... Do të kthehet. *(E mbyll telefonin.)* Vazhdoni... Më falni...

VASILI — S'ka gjë... Unë... *(Shikon me frikë*

telefonin... Pret pak se mos bie zilja e nis.) Halli im...

(Telefoni.)

NËPUNËSI — (Qesh dhe ngre dorezën.) Jo... i keni rënë gabim. (Lë telefonin.)

VASILI — (Merr dorezën e ngre dhe e lëshon mënjanë që të mbetet telefoni hapur...) Problemi im...

(Shpërthejnë duartrokitje. Vasili pa e prishur gjakun, përshëndet me dorë dhe ulet në një stol, duke hequr dorë nga shpjegimi i tij. Hyn Xheviti që mbështetet lehtë në bastun! I afrohet nëpunësit.)

XHEVITI — Tha gjë për mua?

NËPUNËSI — Asgjë...

XHEVITI — Po e pres.

(Duartrokitje në sallë. Gjatë kësaj kohe Xheviti i jep dorën Vasilit dhe ulet pranë tij.)

XHEVITI — Pret shokun Agim?

VASILI — Po.

XHEVITI — Edhe unë.

VASILI — Dua të bisedoj me të.

XHEVITI — Unë dua të përleshem. Ai e çmon nisëativën time por nuk do që unë të shkoj në fshat... Po për ty?

VASILI — Jo... Për mua do, por...

XHEVITI — Aa ti e paske kollaj. Sa vjet ke në arsim ti, Vasil?

VASILI — Dymbëdhjetë.

XHEVITI — Unë rrumbullak njëzet e pesë!... Bëhet mbledhja, ngrihem shfaq dëshirën për në fshat... Mirë... Pastaj anulohet.

VASILI — Anulohet?

XHEVITI — Po, drejtori... Erdhi këtu tek shoku Agim dhe ma anuloi. Vijnë nga ana e tyre dhe një grup nxënësish.

VASILI — Po mirë...

XHEVITI — Pse më ftuan në mbledhje?... Pse më lanë të flas?... Pse më duartrokitën? A, domethënë kot... Mua s'më vajti mendja për gjë, po më futi spicat ime shoqe...

VASILI — Spicat?!

XHEVITI — Gozhdët! Kam frikë, Xhevit, më thotë, se për ty mendojnë që e shfaqe dëshirën kot. Nuk të besojnë se ti ke vërtet dëshirë. Më dogji. Nuk më besojnë nga këmba!... Po që njeriu s'do që të tjerët të radhisin me të paaftët, këtë a e beson ti?

VASILI — E besoj.

XHEVITI — Po që kam luftuar e jam plagosur në ato anë kur kam qenë partizan, e beson?

VASILI — E besoj.

XHEVITI — Po që unë e kam mendjen top se në profesionin tonë këmba s'është pengesë aq e madhe, këtë a e beson?

VASILI — E besoj.

XHEVITI — Ore, m'i thua sinqerisht apo do të më bësh qejfin ti, Vaskë?

VASILI — Sinqerisht, shoku Xhevit, ju kini aftësi të bindni njerëzit shpejt.

XHEVITI — Të shohim... Nuk bindet shoku Agim. Po e di ç'do të bëj? Këtë bastunin do ta fsheh. Do t'i vete pa bastun. Unë eci fare mirë edhe pa të... (Nëpunësit) Ta lë pak këtë bastun? E marr kur të dal. (Kthehet në vend, por rrugës ndien dhembje.) Asgjë... Kur më lodhet, më tkurren muskujt... Veç ti, Vaskë, më rri afër. Unë do të të kap nga krahu me marifet. Ah, këto plagët e luftës. Rrinë, rrinë e të kujtojnë... Dhe dhembje të ja-

pin, dhe fuqi. (Pauzë.) Po ti, Vaskë, pse ke ardhur? Ke pengesa?

VASILI — Asnjë.

XHEVITI — Raport, sëmundje?... .

VASILI — Qiqër jam.

XHEVITI — Se mos ke ndonjë bastun si ai imi.

VASILI — Kisha po e hodha.

XHEVITI — Kur?

VASILI — Pas teje.

XHEVITI — Nuk ta pashë.

VASILI — Nuk duket. Po për të hedhur e hodha.

XHEVITI — Më the se shoku Agim është dakord.

VASILI — Të gjithë janë dakord.

XHEVITI — Po pse ke ardhur?

VASILI — Po he, de? Mbase për të parë këta djemtë vullnetarë. Mbase që të bisedonim bashkë. Ditën e mirë! (Nëpunësit). Prishe emrin.

NËPUNËSI — Nuk do të presësh?

VASILI — U sqarova. Ditën e mirë!

NËPUNËSI — (Mbledh supet.) Që kishte një hall ai, e kishte. Për mua është rasti i parë që një njeri sqarohet pa hyrë në zyrë...

Çudi.

(Duartrokitje. Në rrugë Vasili takon Marikën.)

MARIKA — Vaskë, bisedove?

VASILI — Bisedova.

MARIKA — Ç'të tha?

VASILI — Do të shkosh, më tha.

MARIKA — Ti e kundërshtove?

VASILI — Hiç fare. Do të vete thashë e pikë.

MARIKA — Ua! Po aman, mor Vaskë. Do vu-
ash prapë. Këtë ujë ku do ta gjesh!

VASILI — Hajde se do ma sjellin më autobot!

MARIKA — Po nëna jote, po unë? Ne kemi
grindje...

VASILI — Sot fillojnë bisedimet për paqe! Dhe
o bëni paqe ju, o ju shpalla luftë unë!

MËNGJESE PRILLI...

Skenë lirike për estradën

Personat:

BARDHA — agronome e serrave në një koope-
rativë

MERI — shoqe e Bardhës

VJOLLCA — shoqe e Bardhës

ADRI — i fejuari i Bardhës

*Serrat ku rriten domatet e hershme. Ësh-
të një mjedis plot dritë. Rrënjët e larta
mbajnë përgjatë trupit prodhimin e ri
— domate të shëndetshme që kanë fillu-
ar të skuqen. Bardha me një gërshërë
në dorë. Meri dhe Vjollca punojnë aty
pranë saj.*

MERI — Bardha, Adri!

VJOLLCA — Po të vjen Adri!

BARDHA — Po ju prisni! Ku shkoni?

VJOLLCA — Unë për vete kam punë në qo-
shen më të largët të serrës.

MERI — Dhe mua më pëlqen të punoj në qo-
she.

BARDHA — Vajza!

VJOLLCA — Ç'punë kemi ne këtu afër kur agronomes i vjen i fejuari.

(Largohen duke qeshur. Vjen Adri. Mban syze, është veshur si për të diel. Kalon gjatë korridorit të serrave duke mbajtur për timoni biçikletën, të cilën e mbështet në një tryezë. Bardha befasohet nga pamja e të fejuarit që nuk përshëndet fare.)

ADRI — Dasmën e kemi lënë në gusht, apo jo? Nuk do të martohemi në gusht!

(Pauzë.)

BARDHA — Ke bërë njëzet e dy kilometra rrugë që nga qyteti deri këtu për të më thënë këtë gjë?

ADRI — Në gusht nuk do të martohemi!

BARDHA — Çudi! Jemi në serra. Të paktën të themi mendime të pjekura.

ADRI — Mendimin e kam të pjekur për bukuri.

BARDHA — Vërtet, more?! Ç'janë këto vendime të njëanshme? Kemi dhjetë ditë pa u parë, vjen që larg dhe në vend që të thuash «Mirëmëngjes!» na lëshon bombën: nuk e bëjmë dasmën në gusht. Cili është shkaku?

ADRI — Shkaku? Unë jam i pazoti, jam i prapambetur. Ti i ke të gjitha të mirat: ti studion, ti bën shkencë të lartë, ty të venë nëpër presidiume, ti del e punon edhe të dielën... Ke dalë me të gjithë brigadën?

BARDHA — Jo, dolëm kot me nja dy-tri shoqe.

ADRI — Unë po bëj pushim. Jo vetëm që jam i patalentuar, por jam edhe dembel. Ja shkaqet.

BARDHA — Paçka, unë të dua kështu si je: të pazotin, të prapambetur. Kujton se në da-

smë do ta ketë njeri mendjen në këto gjëra? Krushqit nuk do të bëjnë ballafaqimin e shifrave të eksportit.

ADRI — Si mund të martohet një i patalentuar?

BARDHA — Aq martohen të patalentuarit sa...
Adri, kush të ka fyer?

ADRI — Kanë thënë atë që është...

BARDHA — Adri, ti je shumë i zoti, veç jo pak i butë dhe nuk kërkon sa duhet... Ti do ta vesh shpejt punën në vijë.

ADRI — Beson?

BARDHA — Besoj shumë. Serrën ti e ke mirë. Je ca më prapa nga kjo jona e asgjë. Kot shqetësohesh. Unë kam qenë atje. Ja, na arrite. Kjo do të ndodhë së shpejti.

ADRI — (*Shikon përreth.*) Po, po së shpejti!
Mos pyet!

BARDHA — (*I shkon afër.*) Ky dëshpërimi yt, ah! Tregojnë se dikur, qindra vjet më parë, një plak pat martuar vajzën e madhe me një punëtor kamine që piqte tulla e tjegulla, të voglën me një bostanxhi që nxirrte bukën duke prodhuar bostan e zarzavate, si ne. Shkoi plaku të shikonte vajzat. Tullaxhiu kishte shtruar tjegullat dhe shikonte me frikë qiellin. «Aha, u tha vjehrrit, po ra shi unë do të vras veten!» U mërzi vjehrrit dhe shkoi tek vajza e vogël. Bostanxhiu shikonte dhe ai qiellin me shpresë. «Po nuk ra shi, tha, unë do të vras veten». U kthye plaku në shtëpi. «Ç'kishim nga vajzat? pyeti plaka. «Unë nuk di ç'kishim e ç'nuk kishim, tha plaku, di që rënka shi, s'rënka shi, njërin nga dhëndurët e kemi të vdekur!»

ADRI — Bëra njëzet e dy kilometra të dëgjoj barcaleta! E pse ma tregon këtë?

BARDHA — As unë s'e di. Mbase nga gëzimi. Mbase për të thënë se populli në shekuj i ka ëndërruar këto serra. Mbase ngaqë kjo histori ka vajza që martohen...

ADRI — Ai bostanxhiu po të martohej me ty do të shpëtonte.

BARDHA — Shpëto ti, o bostanxhiu im i gjorë!

ADRI — Ja pra, këto janë tamam mendimet e tua!

BARDHA — (*Befas tepër serioze*) Adri, ty të kanë fyer.

ADRI — Po. Kam dëgjuar të thonë se Adri ka zgjedhur me mend. Nusja do ta nxjerrë nga situata.

BARDHA — T'u thoshe që ne duheshim që në institut.

ADRI — Dikush ka thënë: ja një martesë që mezi po e pret dhe drejtorja e fermës.

BARDHA — E kanë thënë me shaka. (*Qesh me të madhe.*)

ADRI — Dikush tjetër paska thënë: sapo të vij unë atje, gjendja do të ndryshojë. Pse nuk qesh më?

BARDHA — E kush qenka ky dikushi tjetër?

ADRI — Ti vetë. Mbase të kujtohet. Pastaj kishë folur gjerë e gjatë për rolin e masave dhe të individit në histori.

BARDHA — Këto nuk i thashë në altoparlant por ia thashë mamasë sate, pa të keq. Bashkëshortët që kanë të njëjtin profesion ndihmojnë njëri-tjetrin dhe përfitojnë të dy. A nuk do të vij unë një ditë tek ti?

ADRI — Do të vish. Atëherë do të ndodhë çudia e do të na mbytë bollëku.

BARDHA — Po mirë, le të ndodhë çudia para se të vij unë! Unë këtë dua!

ADRI — Do të ndodhë mos u bëj merak.

BARDHA — Kur?

ADRI — Së shpejti. A nuk the se e pe vetë gjendjen dhe ne po ju arrijmë?

BARDHA — (*Duke buzëqeshur.*) Thashë dhe e besoj.

ADRI — (*Me vendosmëri.*) Tamam atëherë do ta bëjmë dasmën!

BARDHA — (*Kërcen e shqetësuar.*) Je në vete, deri atëherë?

ADRI — Pse gjithë ky shqetësim? Së shpejti, pra.

BARDHA — (*E zënë ngushtë.*) Së shpejti... së shpejti... Unë thashë që të të jap zemër, por që të varet nga kjo martesë jonë, unë s'jam dakord.

ADRI — Shkurt, ti as që e ke atë besimin e famshëm që the. Dhe as që merakosesh për fyerjen që më bëjnë fjalët e thëna lart e poshtë. Po punë e madhe për besimin tënd. Unë ose i sjell serrat në atë gjëndje që duhet ose... ose...

BARDHA — Ose... do të vrasësh veten... Bostanxhiu im i dashur!

ADRI — Veten jo po do bëj atë që thashë në fillim.

BARDHA — Më lerë rehat me gjithë martesë. Kujton se po të lutem. Po deshe e lemë fare.

ADRI — Jo, fare nuk do ta lemë.

BARDHA — E lënë është. Ti kurrë nuk do ta vesh punën në terezi. Ti je qull. Të mungon plehu, nuk e ngre zërin! Vë re që s'janë në rregull shërbimet, nuk e ngre

zërin! Ke mungesa të ndryshme, nuk e ngre zërin! Thyhet disiplina shkencore, nuk e ngre zërin! Ti veç një herë në jetën tënde e ke ngritur zërin: kur the: «nuk do martohemi në gusht!». Ja ku ta them unë tani: mos më prit as në gusht, as në janar, as në shkurt, e as kurrë!

ADRI — Pse?

BARDHA — Ndërrova mendje. E tani lemë rehat të shikoj punën time.

(Nis të punojë me gërshërë. Adri nuk di ç'të bëjë.)

ADRI — Ti atëherë nuk më do!

BARDHA — Jo.

ADRI — E kisha vënë re!

BARDHA — E kishe vënë re?! Po që të telefonoj dy herë në ditë e ke vënë re, sigurisht? Ku ta vije re ti që çdo mbrëmje numëroj ditët e mbetura dhe dje thashë dhe njëqind e dymbëdhjetë ditë na ndajnë nga nëntë gushti!

ADRI — Njëqind e trembëdhjetë... Unë llogaris, llogarisja dhe nëntë gushtin.

BARDHA — *(Duke shkuar tek tyreza.)* Nuk e ke vënë re që jam qorruar duke përgatitur këtë fletore për ty... Mbase të vlenin për punën këto të dhëna për çdo rrënjë. Ky është ditar... Mbjellë. krasitur, lidhur, shërbimet, lulja e parë, vaditja... ç'ta bëj tani këtë? *(E hedh tutje.)*

ADRI — Botoje.

BARDHA — Nuk botohet, është vetëm për ty. Aty në çdo faqe shkruhet: «E dua Adrin!... Lulja e parë — s'rroj dot pa Adrin... U lidh kokrra e parë — ç'bën tani Adri?»

(Adri merr fletoren, lexon dhe qesh. Pastaj i afrohet Bardhës së pikëlluar.)

ADRI — E ti thua që unë ta marr?

BARDHA — Pse jo?

ADRI — Këtë punë e ke bërë nga keqardhja për mua?

BARDHA — Jo, e kam bërë nga keqardhja për veten time.

ADRI — Atëherë po e marr. *(E fut në xhep, pastaj i zë dorën vajzës. Kthen kokën.)*
Kush lëvizi aty?!

BARDHA — Vajza! Dilni që aty dhe ejani.
(Vijnë të qeshura Meri dhe Vjollca.)

BARDHA — Ju po përgjonit bisedën tonë?

MERI — Ç'nevojë kishim të përgjonim?! Në të gjithë serrën dëgjohej për bukuri biseda juaj...

VJOLLCA — ... tekniko-shkencore.

BARDHA — E ç'kuptuat ju nga ajo bisedë?

VAJZAT — *(Shohin njëra-tjetrën.)* Që më nëntë gusht ju NUK do të martoheni!

BARDHA — Gjynah!... S'kishin mbetur veç njëqind e dymbëdhjetë ditë.

ADRI — Njëqind e trembëdhjetë.

BARDHA — Unë s'e zë nëntën.

ADRI — Unë e zë. Apo s'janë të gjata ditët në gusht.

ILAÇET KUSHTOJNË LIRË

Monolog

Tek ne edhe ilaçet kushtojnë fare, fare lirë. Këtë e di edhe ime shoqe, Vera, që, pa i ardhur keq për lëndën dhe punën e harxhuar për to, një tog ilaçesh me emra simpatikë belafom, eritromicinum, piperazinum, tetraciklinum, perhidrol, klorofenikol e tjera, e tjera i mori sot dhe i zbrazi në plehra...

Që ilaçet nuk kushtojnë, bile që janë gratis për fëmijët e vegjël, e di edhe Agathia, e cila ka një fëmijë njomëzak. Pa ia mbaruar foshnjës kurën e nevojshme ajo vjen dhe i thotë gruas sime:

— Veva, ia bëra gjëlpëvën djalit... I va tempevatuva. Ilaçet e tjeva nuk do t'i pëvdov.

I hedh dhe i shpërdoron ilaçet dhe, matyrisht, kur pas dy ditësh fëmija i sëmuret, përsëri vjen e na thotë:


— Mova ilaçe të tjeva... Sa mivë që janë pa pava!

Që ilaçet kushtojnë lirë e di edhe doktor Qamoja, që për një status gripalis të mbush mashallah: tre receta bashkë, para e prapa, që për t'i përgatitur duhet mobilizuar i tërë kolektivi i farmacisë.

— Këtë tre herë në ditë! Këto katër herë nga tre të katërtat e kokrrës! Këtë me pika, detyrimisht çdo gjashtë orë! Këtë: dy pika në hundë e tre në vesh, këtë dy në vesh e tre në hundë! Këtë do ta pish me lugë çaji pastaj me lugë gjelle dhe mundësisht me lugë kazani të pastër... para buke.

Dhe pasi të ka dendur mirë e mirë me kokrra dhe shurupe që duhen pirë para buke, ec e ha bukë po deshe! Po pate vend!

Dhe s'do mend pacienti mërzhitet e i le stok. Se s'janë të gjithë si ata që kemi përballë, që në mes të natës tundin pallatin për të zgjuar gjyshin e tyre që të pijë ilaçin për gjumë.



S'janë të gjithë edhe si im vëlla, Çeloja, që zbaton me përpikmëri kurën për oreks që i dha doktor Qamoja. Oreksi i erdhi Çelos menjëherë. Tani ai ha sa për katër e pi sa për shtatë! Ka borxh të hajë qengjin e pjekur komplet e pastaj të gllabërojë një tepsi byrek e një shalqi shtatëkilësh!... E megjithatë, vazhdon me fana-

tizëm kurën e doktor Qamos, akoma pi ilaçe për oreks në vend që të pijë ndonjë shurup për administrimin dhe mirëmbajtjen e stomakut të mbingarkuar!

Jo vëllezër! Ilaçet, nuk duhen shpërdoruar... Duhet kuptuar kjo: «ilaçet kushtojnë, por ne i blejmë lirë!». Po e kuptuam këtë, atëherë dhe këshillat e mjekut do t'i ndjekim plotësisht dhe doktor Qamoja do të heqë dorë nga recetat kilometrike... Dhe ime shoqe nuk do t'i hedhë ilaçet, as nuk do t'i lerë ashtu rrëmujë. Atëherë nuk do të na ndodhë më ajo hataja, që e shumëdashura nëna e saj dhe e shumërespektuara vjehrra ime në vend që të merrte kokrrat për tretjen e ushqimit, në rrëmujën e dollapit mori e piu kokrra për të mos e zënë autobusi... Dhe i hipi temperatura e s'i zbriste!... Pamë ç'pamë e nxorëm vjehrrën për krahësh e hipëm në autobusin e Unazës e filluam të bënim xhiro derisa i ra temperatura...

KUNGULL, KUNGULL...

Skeç

Personat:

GOGOJA — kryetar i një kooperative

MUÇOJA — punëtor në uzinë

LILI — motra e Gogos dhe grua e Muços

Shtëpia e Muços në qytet

MUÇOJA — Moj gruaja ime e mirë! Nuk pritet mysafiri kështu si ke ndërmend ta presësh ti.

LILI — Mysafiri është vëllai im.

MUÇOJA — Është vëllai yt, po është edhe kunati im. Pa e kemi edhe kryetar kooperative. Pa fshati me qytetin...

LILI — Ohua! Leri këto, Gogo! Ai nuk vjen për mysafir, por e kanë thirrur në komitet e me atë rast kthehet edhe tek ne. Do t'i kenë dhënë një kritikë ata që nuk do të ketë ditur si të përdridhet.

MUÇOJA — Kritikë? Përse?

LILI — Nuk kanë realizuar planin e perimeve.

MUÇOJA — Nuk ditke gjë. Planin e perimeve vëllai yt e ka realizuar me kohë.

LILI — Realizim i bukur! Në vend që t'i jepnin tregut specat, domate, mashurka, bizele e bamje i ranë shkurt: i mbollën të tëra parcelat me kungull.

MUÇOJA — Me se? Me se?

LILI — Me kungull! Kishin gjetur një farë të mirë dhe, o burra! Ngado që të hidhje sytë nëpër parcela: kungull! Si kooperativë nuk kishin pasur humbje. Ua kishte zbardhur faqen kungulli.

MUÇOJA — Do ta ketë pasur pisk sot në komitet.



LILI — Jo, po meqë doli i nderuar në dritëra, kujtonte se për këto të tjerat nuk do t'i thoshnin gjë.

MUÇOJA — Mirë që fermat dhe kooperativat e tjera nuk kanë vajtur me mendjen e vëllait tënd. Tregu s'ka mbetur me kungullin e Gogos. (Duke e zbutur të shoqen.) Frigoriferin e kemi plot. Mjaft e ka kritikën e komitetit.

LILI — (E vendosur.)
Jo!

MUÇOJA — Vetë Gogoja të tregoi për këtë?

LILI — Ai nuk më tregoi fare. Dukej në merak, por nuk më tha përse e kërkonin. Bi-

le ai kujton se nuk dimë gjë. Po shoferi
i tyre m'i tha të gjitha.

MUÇOJA — Po ia dëgjoj hapat. Erdhi.

LILI — E paskan shkundur mirë.

MUÇOJA — Me kujdes e me takt. (*Gogos.*) Haj-
de kunat. U vonove.

(*Hyn Gogoja.*)

GOGOJA — Popo... Ju lashë edhe juve pa ngrë-
në!

MUÇOJA — Po hë, si shkoni me punë? Me rea-
lizimin e detyrave? Me grurin?

GOGOJA — Me grurin? Ç'pyet? Shkëlqyeshëm!
Kur është fjala për grurin nuk të falim
ne.

MUÇOJA — Me bulmetrat?

GOGOJA — Mrekulli.

MUÇOJA — Me perimet?

GOGOJA — E e e ...mirë, mirë.

MUÇOJA — Ju lavdëruan besoj?

GOGOJA — Ëhë... Posi! Na lavdëruan, bile na
lavdëruan ashpër... Dua të them, na tha-
në fjalë të mira... Eh, kur punon edhe ga-
bon... Nesër na kërkojnë përsëri.

MUÇOJA — Përsëri nesër?

GOGOJA — Po, po. Do të na lavdërojnë edhe
nesër.

MUÇOJA — Lum si ju. Lavdërimet gjithmonë
janë të këndshme.

GOGOJA — Shumë. Mirë, mirë, jo keq... (*Lili
i zgjat tabakanë me reçel.*) Ç'është ky,
Lili?

LILI — (*Duke qeshur.*) Një reçel i thjeshtë. Re-
çel kungulli!

GOGOJA — Reçel kungulli?! Pse, u bëka reçel
me kungull? E shikoni pra? Ja ku hyn
kungulli! E shikoni?

LILI — Çfarë?

- GOGOJA — (*Me krenari.*) Reçel kungulli! Gëzuar!
- MUÇOJA — Po ti, grua, ç'i dhe reçel. Tani do të hamë drekë.
- GOGOJA — S'ka gjë... Kam një uri unë që... Do të shikoni. Eëëë kungulli...
- LILI — Urdhëroni! Tryeza është shtruar.
- GOGOJA — Epo, mirë se ju gjeta!
- LILI — Merr supë! E kam bërë për merak. Është supë me kungull.
- GOGOJA — Me kungull? Të lumtë, motër! E shikoni? Ja ku hyn kungulli! Hani! Urdhëroni!
- MUÇOJA — E po mos na nxit ne ti! Ne jemi zotër të shtëpisë!
- GOGOJA — Ah, po, po! Këto supa me barishte të ndryshme...
- LILI — S'ka barishte të ndryshme. Është vetëm kungull.
- MUÇOJA — Ju, Gogo, bëtë sivjet.
- GOGOJA — Çfarë?
- MUÇOJA — Kungull.
- GOGOJA — Bëmë ca... Çka, jo keq.
- MUÇOJA — S'është çudi të jetë nga kungulli juaj!
- GOGOJA — (*Pa qejf.*) Mbase.
- MUÇOJA — Ha, ha. Duhet të jetë kënaqësi e madhe kur vjen në qytet mysafir tek motra dhe ha kungull që ke prodhuar vetë. Ëh?
- GOGOJA — Shumë. Kënaqësi e madhe.
- MUÇOJA — Ngreje gotën. Gëzuar! Ha mish! Me se na e ke bërë, moj grua?
- LILI — Me kungull të skuqur...
- GOGOJA — (*Me pirun në gojë.*) I skuqur është ky, ëh?
- MUÇOJA — Posi... Ja ku paska hyrë prapë kungulli.

LILI — A po të pëlqen, vëlla?

GOGOJA — Shumë i mirë.

LILI — Po pse s'po ha, atëherë? Ti the se je
i uritur. Merr byrek, byrek me kungull.

GOGOJA — Dhe byreku me kungull?

LILI — Me kungull dhe byreku...

GOGOJA — *(Duke ngritur gotën.)* Jo, këtë nuk
ma priste mendja! Kjo rakia, mos është
dhe kjo prej kungulli?

MUÇOJA — Ku i dihet?... *(Me qortim të shtirur.)* Ky i uruar kungull sonte...

LILI — Veç kungull kishte dyqani jonë.

MUÇOJA — Të shkoje në të tjerët.

LILI — E pse të lodhesha? E kisha kollaj kështu.

MUÇOJA — *(Gjoja i nxehur.)* Ç'kemi tjetër?
Duam të hamë?

LILI — *(Qetë.)* Do të hamë kungull me kos, krem
kungulli për ëmbëlsirë, kungull të pjekur
me sheqer dhe shurup me lule kungulli.

MUÇOJA — A a a! Po nuk ta ka borxh yt vëlla!

GOGOJA — Ore hallin tim qan, ti?

MUÇOJA — Tëndin posi!

GOGOJA — Ore, më vjen keq për ty, sa për
mua, në do ta dish copë, jo veç këtë
drekë, po kungull le të ha derisa të mbarohet
i gjithë ai që i kam dhënë tregut.
Unë e meritoj. *(Duke ngrënë me zor.)*
Drejt e në autokritikë nesër. Oj, të kup-
tuar. Ma pret edhe mua kungulli!... Pthu!...
Edhe në muhabet po na hyn. Ku s'hyn
ky i uruar kungull!

(Vazhdon të hajë, të hajë, të hajë.)

KONTROLL NË MAGAZINË

Skeç

Personat:

KOZI — magazinier

PEÇOJA — shok i tij

TEFTA — drejtoresha e ndërmarrjes

Ngjarja zhvillohet në një magazinë. Kozi është shtruar e po ha bukë me peshk.

PEÇOJA — Të bëftë mirë, Kozi!

KOZI — Do të më biesh një herë me grusht ti mua?... Më ka mbetur një halë në grykë...

PEÇOJA — E provove me tul buke?

KOZI — Më mbeti dhe tuli.

PEÇOJA — Të bie vëllai ty! Daç me grusht e daç me shqelm. Në daç po rrëmbej varrenë. (*Godet.*) Këtu?

KOZI — Më fort.

PEÇOJA — (*Duke e goditur.*) E, si t'u zu sot, ore derëzi! Sot që ju erdhi drejtoresha e re... (*Godet.*) Me drejtor Thanasin e kishë grurë. Po ja vjen dita që s'ka më Thanas! Bëj raporte kontrolli punëtor:

«Magazina në gjendje të vajtueshme! Po prishen materialet. Të merren masa për magazinier Kozin!»... Mirëpo miku është mik! Drejtor Thanasi ia gjente anën dhe Koz magazinieri s'lëvizi që s'lëvizi nga magazina.

KOZI — Më ka mbetur keq.

PEÇOJA — Pi ujë. E ke provuar me ujë?

KOZI — S'pi dot më, kam pirë dy çini.

PEÇOJA — Mor, po hala e peshkut kalon, po kjo drejtoresha e re... Se kjo nuk është as burrë, mor vëlla. Kjo kafen s'ta pi, cigaren jo, fërnetin e konjakun, hiç! Në raki s'të shtrohet. Apapa!... Opo unë nuk qaj vetëm hallin tënd. Qaj dhe timin. Më parë këtu në magazinë unë hyja si në shtëpinë time... Zgjdhja ç'të më deshte zemra.

KOZI — Të hysh, ore, pa frikë. Përsëri të hysh!

PEÇOJA — Hë, po ajo?

KOZI — Drejtoresha e re është çupa e tezes sime!

(Pauzë.)

PEÇOJA — Aaaaa! Vërtet, o Kozi?

KOZI — Vërtet dhe kaluar vërtetit.

PEÇOJA — *(Duke e goditur më fort, nga gëzimi.)* Ke lindur me fat, or qerrata!

KOZI — Më kaloi hala. për nder. Uh!

(Qeshin e gëzojnë.)

PEÇOJA — *(Befas.)* Po le ta kesh kushërirë... E di që të pjell belaja me gratë?

KOZI — E hua!... Sa ka parë Kozi! Unë kam përdredhur në tel drejtorin burra e jo më një copë grua! Ajo do nja dy vjet që

t'ia marrë radhën punëve. Pastaj edhe po i ra ndonjë çrregullim në sy... Epo, çupën e tezes e kam de! Nënata motra. Baballarët miq. Jemi një gjak. E kam — më ka! Tëndi mishin ta ha, po kockën ta ruan! He-he-he!...

PEÇOJA — Djall, o Kozi, që të shkon kungulli mbi ujë! Demek magazinën tënde do ta kem si timen?...

KOZI — Dhe unë tënden si timen!... (Befas Peçoja e godet fort në kurriz.) Po mjaft de, të thashë! Hala më kapërceu.

PEÇOJA — (I ngrirë me vështrim nga dera.) S'e kam për halën... Ajo! Drejtoresha e re!... (Në magazinë ka hyrë drejtoresha, Tefta. Dy miqtë kthehen dhe e shohin.)

PEÇOJA — (Kozit, avash.) Popo, sa e rreptë duket!



KOZI — Popopo sa i ngjet! Tezja në vend!

TEFTA — Ç'janë këta njerëz të huaj në magazinë?... Pse nuk zbatohen rregullat?!

PEÇOJA — Unë..

TEFTA — Dilni jashtë, ju lutem. Po të keni ndonjë punë keni shefin e furnizimit.

PEÇOJA — Unë... Kozin... e kam shok... Ne...

TEFTA — Ju lutem, dilni jashtë!

(Duke mbledhur supet Peçoja del jashtë. Pauzë.)

KOZI — Do vish të hamë peshk?

(Tefta nuk flet.)

KOZI — Do të ulesh? Ja, rrotulloje atë fuçinë atje dhe ulu se karriget nuk e di kush m'i ka marrë.

TEFTA — Nuk është mirë kështu, Kozi.

KOZI — Çfarë nuk është mirë?

TEFTA — Që lejon këtu njerëz të huaj... që ha bukë me peshk...

KOZI — E po ç'të bëj unë! Salçiqet u mbaruan.

TEFTA — ... që t'i kanë marrë karriget, që nuk ngrihesh kur hyn drejtoresha e ndërmarrjes...

KOZI — Për karriget s'kam faj unë, por të kenë turp ata që i kanë marrë. Sa për drejtoreshën, ti e di që unë jam dhjetë vjet më i madh nga ty dhe të kam mbajtur në krahë, në kurriz dhe kalakiç... Ti ishe e vogël e nuk më thoshje dot Kozi por Koko e unë për përkëdhelje s'të thoshja Tefta por Teta... Që je bërë drejtoreshë, të lumtë e mua më bëhet zemra mal... Po Kokoja nuk ngrihet kur hyn Teta...

(Pauzë.)

TEFTA — Pse, me këto marrëdhënie do punojmë bashkë?

KOZI — Epo, gjaku ujë s'bëhet... Si është tezja?! I vuri dhëmbët e rinj?

TEFTA — *(Që mezi përmbahet.)* Si është tezja,

- eja dhe pyet pasdite në shtëpi. Tani kam ardhur për kontroll në magazinë dhe pyes unë: në ç'gjëndje është magazina?
- KOZI — *(I habitur nga toni i rreptë i Teftës.)* Shiko, Teta!
- TEFTA — Thashë që dua të shoh magazinën!
- KOZI — *(Ngrihet me zor duke shkundur thërrimet.)* Koko, Koko cilën ke mbajtur kalakicë! *(Teftës.)* Urdhëroni, shoqja drejtoreshë... Ja, magazina.
- TEFTA — *(Duke kontrolluar me sy.)* Ç'është ky material këtu?
- KOZI — Materiali i ndërmarrjes sonë, quhet... prit, prit.. quhet ma... ma-mi...mi...mi Jo, prit! Am... am... am...
- TEFTA — Amiant.
- KOZI — Amiant, tamam! Është material importi.
- TEFTA — Përse e lini në tokë? Përse nuk e ke ni vënë në raftë?
- KOZI — Raftet janë plot dhe raftë të tjera unë nuk pranoj të bëhen!... Harxhojmë dërrasë... Kursimi, shoqja drejtoreshë.
- TEFTA — Kursimi?!
- KOZI — Posi! E di ç'domethënë dërrasë?!... Pastaj ky është material i jashtëm. Pyet ky nga lagështia!
- TEFTA — Leri të qeshurat!
- KOZI — *(Me dhëmbë shtrënguar.)* Teta! Teta! T'u bëftë Kokoja, mos u sill kështu, eh... Me kushëririn sillu si kushëri.
- TEFTA — Unë do të sillem si drejtoreshë, me një magazinier që nuk sillet mirë me materialet... Mos do që të sillem butë përpara kësaj rrëmuje?!
- KOZI — Avash, moj, avash... Të kishte njerëz të tjerë e po hajde. Ta falja hakërrimin.
- TEFTA — Unë nuk bërtas për t'u shtirur, i da-

shur kushëri, po ngaqë revoltohem... I di vleftat e këtyre materialeve që dërgjen kështu? E di që i blejmë jashtë? Po ky material këtu?

KOZI — Kabëll i skremuar.

TEFTA — (*Korrigjon.*) I skromuar!

KOZI — I skromuar, po. I skremuar thonë për qumështin. Kabëll i skromuar zero... zero... zero... Prit ta shoh.

TEFTA — Zero katërsh!

KOZI — E ditke, për nder! E po me kabëll ke punuar deri tani atje në repart...

TEFTA — Sa metra ke?

KOZI — Metra e kilometra plot!

TEFTA — Më sill kartelat!

KOZI — T'i sjell, po nuk i kam të plotësuara.

TEFTA — Ashtu?! Fletëhyrjet, fletëdaljet...

KOZI — (*Mekanikisht.*) Fletëhyrjet, fletëdaljet...

TEFTA — M'i trego!

KOZI — Do të të tregoj vetëm fletëdaljet. Fletëhyrjet kam tri ditë që s'po i gjej dot.

TEFTA — (*E skandalizuar.*) Ashtu? — (*Pauzë e nderë.*)

KOZI — Tezja... ka qenë mirë me shëndet! I vuri dhëmbët? Dëgjo, Teta... marr angazhim që brenda dy javësh fletëhyrjet t'i gjej...

TEFTA — Dy javë janë ca si shumë, Koko! Brenda dy-tri ditëve do të shkarkojmë si magazinier.

KOZI — Të më shkarkoni?

TEFTA — Po.

KOZI — E ku do të më ngarkoni pastaj?

TEFTA — Nuk e di... Ku të vendosë drejtoria, që do të analizojë punën tënde të keqe, bile shumë të keqe në ruajtje të pronës. Këtë problem do ta ngre që sot.

KOZI — Ta ngresh ti? Po a e ngre dot? A të bën zemra ta ngresh. Po si s'të vjen zor nga vetja, moj! Rritur së bashku... Kalakiç. Nën timer motra, baballarët miq... Një gjak... Bëje!... Bëje ti... Pesë drejtorë kanë kaluar e nuk e bënë këtë... Ta bësh ti! Je në vete? Hyn këtu pa trokitur, më zë peshkun në grykë e... e.

TEFTA — Që të jesh i qetë, ky nuk është vetëm mendimi im... Këtë e ka kërkuar më parë kontrolli punëtor... (*Tregon dosjen.*) Ja raportet njëri pas tjetrit.

KOZI — Po ku u gjenden?

TEFTA — Pse, mos kujton se do të humbnin si fletëhyrjet e tua?!

KOZI — Po tezja?... Kalakiçi... Kokoja... Teta... Do t'i harrojmë?

TEFTA — Nuk do t'i harrojmë, Kozi! (*Duke dalë.*) Prandaj përgatitu të paraqitesh me autokritikë të fortë që të më nderosh dhe mua, Tetën tënde.

KOZI — (*Që pas.*) Do vij pasdite nga shtëpia... Për tezen... Për dhëmbët. Do bisedojmë.

TEFTA — Nga shtëpia shko. Tezja, i vuri dhëmbët. Mua s'do më gjesh se do kemi mbledhjen e drejtorisë. (*Del.*)

KOZI — Për mua me siguri. Unë të shkoj për dhëmbët e tezes!... Hajde kushërirë, hajde! Nënës ia vure, mua m'i shkule!...

KOSTUMI

Skeç

Personat:

VJOLLCA

LILOJA

PEÇI

TEKNIKU i riparimit të makinave qepëse

Në paradhomën e rrobaqepësisë Vjollca po mat stofin që ka mbi tryezë. Liloja del nga paradhoma dhe takon Peçin.)

PEÇI — Lilo, mirë që të gjeta! (Nxjerr një tu-fë ftesash.)

LILOJA — Ç'janë këto?

PEÇI — (Duke kërkuar ftesën e Lilos.) Ke një ftesë për në dasmë.

LILOJA — Kush martohet kështu?

PEÇI — Një djalë shumë simpatik.

LILOJA — Vërtet? Cili?

PEÇI — Gjeje. Një azgan, një bukurosh...

LILOJA — S'po i bie dot në të.

PEÇI — Një petrit, një syshqiponjë...

LILOJA — Nuk e gjej dot, Peçi, po ma thuaj.

PEÇI — Martohet Peçi, dora vetë! Urdhëro ftesën!

LILOJA — Urime, urime!... Nuk më shkonte mendja! Se ti po thoshe simpatik!

(Qeshin)

PEÇI — Gjithë këtë javë jam në gaz. Sikur po fluturoj. Nuk e prish gjakun për asgjë...

LILOJA — Po këtu?

PEÇI — Erdha të marr kostumin e dhëndërisë.

LILOJA — Bukuri. Ç'kemi nga ndërmarrja?

PEÇI — Asgjë... Flitet që po martohem unë.

(Qeshin e ndahen.)

PEÇI — Mirë se të vish, Lilo! Mirupafshim!...
(Vjollcës.) Tungjatjeta, shoqe!

VJOLLCA — Tungjatjeta!

PEÇI — Unë erdha për atë kostumin e martesës.

VJOLLCA — Nuk e mbaj mend... Martohen shumë pasnesër, kemi shumë punë. E ke faturën?

PEÇI — Posi! Urdhëroni!

(Vjollca merr faturën dhe kontrollon në dollap.)

VJOLLCA — Martohesh vetë, personalisht?

PEÇI — Bashkë me nusen.

VJOLLCA — E kuptoj... Këtu nuk është. Të shohim brenda në punëtori. Më fal pak.

PEÇI — Posi!

(Vjollca del. Peçi ia merr këngës ngadalë.)

PEÇI — Më fal... Pa dashur ia mora këngës.

VJOLLCA — S'ka gjë, shok, ke punën tënde ti, po kostumi nuk është bërë.

PEÇI — Ashtu?! (I qeshur.) Po vij nesër.

VJOLLCA — Nuk bëhet as nesër.

PEÇI — (Pa e prishur gjakun.) Pasnesër atëherë.
(Kujtohet.) Uuu pasnesër jo. Pasnesër mar-
tohem... Marr nusen.

VJOLLCA — Jemi të detyruar ta shtyjmë do-
rëzimin e kostumit.


PEÇI — (Akoma i qeshur.) Puna është se unë
nuk mund ta shtyj dasmën!

VJOLLCA — Ç't'ju them unë?! Bëjeni atëherë.

PEÇI — Pa kostum?

VJOLLCA — Gjëra që ndodhin. Ju ç'punë bëni?

PEÇI — Tornitor. Mos do të më propozosh që
të vesh kominoshet atë ditë.



VJOLLCA — Jo, dua të them se dhe juve në
punë mund t'ju ndodhin gjëra të tilla.

PEÇI — Aspak. Ne kemi një punë që nuk lemë
njeri pa martuar. S'kemi të bëjmë me
dhëndurë.

VJOLLCA — Ndoshta... Ejani një herë të hënën,
shoku dhëndër.

PEÇI — Kur?

VJOLLCA — Të hënën.

PEÇI — Ma merrni përsipër ju, ta shtyni të di-
elën pas së hënës?

VJOLLCA — Ne nuk marrim përsipër gjëra të
tilla.

PEÇI — (*I nxehur.*) Ju merrni përsipër vetëm
kostume dhe nuk i bëni në afat.

VJOLLCA — Ju lutem, shok, mos u nevrikosni.

PEÇI — Të mos nevrikosem?! Për dembelizmin
tuaj, për neglizhencat tuaja, për mungesat
që keni në organizim...

VJOLLCA — Ne nuk kemi faj. Nuk ju ndodh
dhe juve që...

PEÇI — Nuk na ndodh. Ndërmarrja jonë është
pararojë.. Ne e kemi realizuar planin 107
pikë 3 për qind! Kuptove!?

VJOLLCA — 107 dakord, por...

PEÇI — Jo 107, por 107 pikë 3! Atë pikë 3
mos e harroni!... Po ju?... Unë jam qy-
tetar i thjeshtë, por pa t'ju pyesim një
çikë hollë hollë: pse çaloni ju këtu?

VJOLLCA — Ne i kemi gjysmat e makinave
në remont.

PEÇI — Bukuri. Pa plan ecni ju? Ç'bëjnë ata
teknikët tuaj? Flenë?

VJOLLCA — Nuk kanë material... Ja, që ndodh...
Juve në ndërmarrje a nuk ju ndodh?...

PEÇI — Shiko, motër, ndërmarrjen time mos ma
përmend!

VJOLLCA — Mirë, mirë, e di që keni realizu-
ar 107 për qind...

PEÇI — Pikë 3!... Dhe nuk jemi në kontakt
me kërkesat e popullit.

VJOLLCA — Djalë i mirë, të gjithë për popullin punojmë ne!

PEÇI — Bukur... Unë dua kostumin. (*Ulet.*)

VJOLLCA — Unë nuk jua jap dot. (*Ulet.*) Keq më vjen.

(*Shihen sy ndër sy.*)

PEÇI — (*Zgjat faturën.*) Fatura thotë që kostumin ta marr pikërisht sot.

VJOLLCA — Për arsye teknike kostumi sot nuk jepet!

PEÇI — (*Tund ftesat.*) Po këto ku t'i çoj unë? Për arsye teknike ç'të bëj me to? Fresk? (*Vjen tekniku i remontit.*)

TEKNIKU — Ç'është kjo zhurmë?

VJOLLCA — (*Peçit.*) Shoku merret me remontin dhe i di punët më mirë. Mund t'ju sqarojë... (*Teknikut.*) Shoku ka një dasmë.

PEÇI — Uuu dasmë!... Dasmë! Dasmën e hallës apo të tezes? Kam dasmën time, shoqe!

VJOLLCA — ... Ka dasmën e tij dhe ne kostumin nuk ia kemi bërë.

TEKNIKU — (*Peçit*) Ne më duket se njihemi...

PEÇI — (*Gjithë vrer.*) Gëzohem shumë!

TEKNIKU — Sa gjë e bukur! Shumë gjë e bukur! Shumë, shumë gjë e bukur!

PEÇI — Më falni... Do të filloni të na bëni poezi tani?

TEKNIKU — Gëzohem shumë që jeni pikërisht ju!

PEÇI — Mirëmëngjes!

TEKNIKU — Më vjen mirë që keni kostum për të marrë!

PEÇI — Po nuk po e marr se!

TEKNIKU — Shumë mirë që s'po e merrni!

- PEÇI — *(Vështron përçarë i habitur. Qetë.)*
Shok, si e keni hallin ju?
- TEKNIKU — Ju kujtohet ku jemi parë?... Unë jam ai shoku që ju erdha pardje në ndër-marrje për të tërhequr ato bokolat e vogla... Ato bokola duheshin pr makinat qepëse. Ju na i vonuat dy javë. Ti je tornitori që duhet t'i bëje.
- PEÇI — Nuk marr vesh. Unë ç'hyj në këtë mes?
- TEKNIKU — Ti? Ti dhe shefi yt rendni pas punëve me leverdi, që ngrenë peshë për planin global, dhe punët e vogla, si këto tonat, i lini pas dore.
- VJOLLCA — E kanë realizuar planin 107 për qind... *(Me nxitim.)* pikë 3, më falni.
- TEKNIKU — Atëherë jo ti, po ne duhet të bërtasim. Ju, shoku punëtor, pse nuk i kryeni porosinë e vogla sipas marrëveshjes? Ka shokë që martohen... Gjynah... Djem të rinj... ka ca që mezi po e presin...
- PEÇI — Po, po... Ja unë, për shembull, ka dy vjet e gjysmë.
- TEKNIKU — Posi dhe ne detyrohemi të mos e mbajmë fjalën.
- PEÇI — Domethënë kostumi nuk është qepur për fajin tim?!
(Niset të dalë i dërrmuar. Tek dera kthehet.)
- PEÇI — Nuk ka ndonjë shpresë? *(Tekniku tund kokën në shenjë mohimi)* Fare, fare?
- TEKNIKU — Fare.
- PEÇI — Nuk di a më kuptuat?... Martohem.
- TEKNIKU — Aaa martohesh! *(Qesh.)* Do të bëjmë të pamundurën!... Pa gjumë do të rrimë!

PEÇI — Vërtet? Urra!

(Sulet t'i përqafojë nga gëzimi. Përqafton teknikun dhe pastaj i sulet Vjollcës.)

VJOLLCA — Ej, ej! Pikë tresh! Mos të bëhet xheloze nusja!

PEÇI — Ju faleminderit, në emrin tim dhe të nuses. Mirupafshim!

TEKNIKU — Po nuk dimë a na kuptove?

PEÇI — *(Tund dorën.)* E kuptova tani, lëre!

GRUAJA IME E DASHUR ME PALLTO ME CËRKA...

Monolog

Të bukurën dhe banalen i ke pranë. Mjaf-ton që të zgjatësh dorën, i prek...

Dëgjojmë plot njerëz të kënaqur për mall-rat me cilësi të mirë, për rroba të gatshme të bukura e me shije. Po dëgjojmë edhe për pro-dhime standarde që krijojnë stoqe nëpër dyqane.

Hm... Ndodh... Në dyqanin tonë erdhën një ditë pesë pallto grash. Të bukura. Stof i kuq me çërka, me të çara, me rrip e xhepa jashtë. Njerën e mori gruaja ime.

Pas gruas sime u sulën disa gra të tjera, po pesë pallto ishin ato! I ngritën. «Pate fat!», i thanë shoqet gruas sime, që, e kënaqur, kre-kosej me pallton e rrallë.

Pas disa ditësh dyqani u furnizua me një-zet pallto si ato. Ai stof, ai model! U kënaqën dhe njëzet shoqe të tjera. Në krye të javës dy-qani mori edhe njëqind e njëzet pallto të atij lloji. I njëjti model: me të çarë, me rrip e xhe-pa jashtë, stof i kuq, me çërka. Tani në çdo njëqind metra has nga një grua me po atë lloj palltoje. Në dyqan, prej dy muajsh, rrinë va-rur me dhjetëra e dhjetëra pallto si ato. Nuk i merr njeri. Dhe është e natyrshme, mos du-

het të vishen të gjitha gratë e qytetit tonë me një model e me një stof? Ja pra shpërndarja e keqe! Ja mungesa e shijes! Ja modeli standard. Ja stoku! (Befas shikon një grua që pret disa metra më tej.)

Ah, ja dhe gruaja ime, me pallton që ju përmenda! (Duke shkuar drejt saj.)

Keni rast të shihni pallton. Po mos ia shani. (E kap lehtëzi gruan nga supet.) Bëj një rrotullim, e dashur, që ta..

GRUAJA — Uh! Si guxoni ju, shok?!

(E skandalizuar gruaja e panjohur largohet gati me vrap duke vështruar me frikë dhe përbuzje burrin që e preku nga supet. Ai ka mbetur si i ngurosur.)

— Me këto pallto po... po ngatërrojmë gratë!



PËRVOJËN E KE PRANË

Skeç

Personat:

KOZMAI

VITA

KOLA

Ngjarja zhvillohet në zyrën e përgjegjësit të sektorit. Në zyrë Kozmai dhe Vita. Kozmai rrotullon dorezën e telefonit.

KOZMAI — Alo... Do dalç apo s'do dalç?! (Rrotullon dorezën.)

VITA — Kjo është punë boshe. Po të më pyesësh mua...

KOZMAI — Epo, nuk të pyes fare atëherë! Qenka punë boshe ta kërkosh e ta vjelësh përvojën e përparuar, ëh?!

VITA — Mirë, mirë, po ku e kërkon!

KOZMAI — Ku të jetë! Njëqind-dyqind-treqind kilometra! Larg! Ia vlen. Nuk ma mban kurrizi kritikën. (Imiton.) Çfarë bëni ju, shoku Kozma, për të tërhequr përvojën e përparuar?» «Kozmai s'del nga guska e tij». Ama kështu! Tani do ta bëj fora!

10 23

Dhjetë veta pas dhe të, në Dropull! Në Devoll! Në Zadrimë! S'e lë më sektorin unë me tridhjetë kuintalë grurë për hektar!

VITA — Mirë, shkojmë në Levan, në Cakran...

KOZMAI — Këtu, me?! Kaq afër?! Në ujërat tona do jenë dhe ata... Një re na mbulon. Larg, larg! Ka lezet. Bie në sy. Dy ditë rrugë. Ec e ec! «Nga kini ardhur?», «Larg, nga Fieri» «Urdhëroni!» (Në telefon.) Alo! Centrali i Fierit?... Lushnjën?!... Nuk e dua Lushnjën, moj jo. Kush ta kërkoi?! Në Lushnjë vete me biçikletë unë! Sonte do të më lidhësh: me Sarandën, Përmetin, Ersekën... (Zë telefonin me dorë.) Vita, hartën! (Në telefon) Korçën, Peshkopinë, Shkodrën... Tropojën s'ma ke dhënë, mos gënje... E desha dhe dje, dhe pardje. — S'punonte linja. — Sonte të dua Tropojën! (Mbyll telefonin.)

VITA — Të gJORËT ata që do vijnë me ty për të parë e mësuar!

KOZMAI — Këtë nuk e bëj kot unë! Kur të lodh rruga, nuk e harron atë që ke mësuar.

VITA — Po sikur të shkojmë në Levan?! Po prit! T'i biem nga Gjirokastra, Sarandë — Himarë, — Vlorë — Levan... Marrim përvojën e Levanit dhe pastaj prapë fiu Vlorë — Sarandë...

KOZMAI — Vitë, qepe se po më hipin xhindet! (Vita del duke qeshur. Bie zilha e telefonit.) Po.. Mojë, më çmende ti! Kush ta kërkoi Beratin? Unë Beratin e shoh nga penxhërrja! Ohuaa! (Përplas telefonin.)

VITA — (Duke hyrë.) Ata të Elbasanit e të Pogradecit e morën farën e jonxhës. Tani ka ardhur një shok tjetër, për tubat.

KOZMAI — Të na presë ca.

VITA — Ka ardhur nga larg. S'ka lezet. E kemi nga Topoja.

KOZMAI — Tropoja?! Po ti nuk dëgjon që unë po e kërkoj? Shok nga Tropoja dhe e le përjashta?! (*Niset të dalë me vrull.*)

VITA — Shoku Kozma nuk më kuptove...

KOZMAI — Nuk të kuptoj hiç! Pikën e inisiativës nuk e keni! Hiç! Tropoja, thotë, e rri si e shushatur!

(*Del me rrëmbim.*)

VITA — Unë i them që është nga fshati Topojë që kemi këtu në kooperativën e Semanit, ai nuk do të dëgjojë. I është bërë mendja Tropojë e Konispol!

(*Hyn Kozmai duke sjellë Kolën.*)

KOZMAI — Po si, he burrë!... Qe, ajo punë ka marrë fund!

KOLA — Faleminderit!

KOZMAI — A e pi cigarin? (*I zgjat paketën.*)

KOLA — (*Merr*) Faleminderit!

KOZMAI — Kam kryer shërbimin ushtarak an-dej kah anët tuaja.

KOLA — Kjo qenka e bukur! Se unë e kam kryer këtu, tek ajo kodra aty.

KOZMAI — Po më bahet qejfi. Paskena me i fol njani-tjetrit me gjuhën e zemrës. A të ka lodhë rruga?

KOLA — Jo dhe aq. Rrugë e shtruar.

KOZMAI — Po, i baj një za agronomit. Më fal një minutë. (*Del.*)

KOLA — (*Vitës.*) Po ngriset, do të më vononi shumë?

VITA — Pak besoj... Si jeni me rendimentet?

KOLA — Në përgjithësi mirë. Bile kemi brigada, që janë shumë mirë.

VITA — Ja, këto na interesojnë se duam të vijmë e të shohim atje tek ju.

KOLA — Mirë se të vini.

VITA — Për këto interesohet edhe përgjegjësi.

KOLA — A posi! Me gjithë qejf... Më pëlqeka... E paski malësor përgjegjës? Nuk e paski vendali?



VITA — (Qesh.) Jo, e di si është puna. Ai...

KOZMAI — (Duke hyrë.) Nuk e gjeta... Më fal... Si të quajnë, or mik?

KOLA — Kolë.

KOZMAI — Kolë... Bukur! Baca Kolë, me grurin nuk jena dhe aq mirë. Tridhjetë kuintalë për hektar. Po ju?

KOLA — Po ja, për shembull, brigada e trembëdhjetë tek ne është në pararojë. Pesëdhjetë e dy kuintalë!

KOZMAI — Sa?!...

KOLA — Pesëdhjetë e dy.

KOZMAI — Kuku! Të marsha të keqen! (Vitës) Folë, ti, po deshe! (Kolës.) Misri? Kallamoqi

- KOLA — Në brigadën e dytë merret tetëdhjetë e katër kuintalë.
- KOZMAI — (Vitës) Ç'më thua, moj. Ne marrim dyzet e tetë. (Kolës) Pambuk, mor aman... Apo nuk mbillni ju se klima...
- KOLA — Mbjellim, po si... Rezultati më i mirë trembëdhjetë kuintalë!
- KOZMAI — Ne nëntë! Nandë ne, o baca Kolë!
- KOLA — Po tek ne është punuar mirë, ç'është e vërteta... Përvojën e mirë e ke pranë... Ja, e marrim nga brigada në brigadë, nga sektori në sektor... Mësojmë dhe nga kooperativat më të mira të rrethit. Pastaj gjërat me vlerë i marrim dhe nga rrethet e tjera. Po këto që kemi afër, më parë!
- VITA — Po, s'do mend! Ashtu duhet.
- KOZMAI — (Kolës) Unë do të sjell nja njëzet vetë atje tek ju... Të shohin, të përfitojnë.
- KOLA — Me gjithë qejf.
- KOZMAI — Ah, ty të lumshin kambët, he burrë!... (Vitës) Cakto njerëzit. Sa të marrë makina! Pasesër nisemi! Dhe na, i thuj të vishen trashë. (Kolës) A keni borë andej kah ju, baca Kolë?
- KOLA — (E sheh i habitur.) Borë? Tallesh ti... Ne detin një pëllëmbë afër...
- KOZMAI — (I habitur, Vitës.) Ç'det thotë ky? Ku kanë det këta?
- VITA — (Duke fshehur gazin.) Si duket, thotë për liqenin e Fierzës...
- KOLA — Të flasim për tubat se unë duhet të iki sonte.
- KOZMAI — Tash në mbramje? A do me na koritë, a?
- KOLA — Jo besa... Më presin kalamajtë e bëhen merak.

KOZMAI — Po me çka don me ikë? A ke ndonji veturë?

KOLA — Joo, ç'veturë! Me biçikletë.

KOZMAI — E ke me motor?

KOLA — Jo, or, jo... Me këmbë... Po ja ku është Topoja!

KOZMAI — Kush?

KOLA — Topoja.

KOZMAI — Moj Vitë! Po ky qenka prej këtej, moj.

VITA — Këtej, shoku Kozma, nga kooperativa e Semanit, sektori Topojë. Unë ta thashë qartë.

KOZMAI — Myzeqar qenke, ti, or baca Kolë?

KOLA — Po, pse për cilin më more ti, baca Kozma?

VITA — Ç'rëndësi ka se si të mori përgjegjësi. Ju jeni më përpara nga ne e ne prej jush duhet të përfitojmë.

KOZMAI — (I nxehur.) Vitë, Vitë, rri se këtu ma kë sjellë.

VITA — Të betohem, shoku Kozma, ti pate qejf ta merrje vetë ashtu. Po unë them s'prishi gjë... Kooperativistët e Korçës, Sarandës e Tropojës kanë rezultate të mira e ne na bëhet qejfi po dhe ne këtu në rreth kemi përvojë të mirë e do ta marrim.

KOLA — Gjuhën e malësisë e flisje mirë... Tani më thuaj, he burrë i dheut, a po vini pasnesër?

KOZMAI — Jo. Anulohet! Do t'ju vijmë që nesër!

SHOKU BURHAN DEL PËR KONTROLL

Skeç

Personat:

BURHANI
KOMSHIU I
KOMSHIU II
KOMSHIU III me gruan

Një rrugë natën vonë. Nga shkallët e pallatit zbret Burhani duke mbërthyer pardesynë. Befas kthehet dhe me guriçka mundohet të godasë dritaren e tij për të tërhequr vëmendjen.

KOMSHIU I — Mirëmbreëma, shoku Burhan! Për ku kështu natën?

BURHANI — Ja, more Beqo. Dua të bëj një kontroll në ndërmarrjen time.

KOMSHIU II — Kontroll?

BURHANI — Kontroll nate, e kam lënë për sonte. Jam sinjalizuar se hera-herës ka çrregullime. Pa, po rastis që ndonjëri edhe fle në turnin e tretë.

KOMSHIU — Do që t'u shkosh papritur!

BURHANI — Papritur, ashtu ka efekt kontrolli. Beqo, kur të ngjitesh lart thuaj pak gruas sime të më hedhë shallin, harrova e qënka ftohtë.

KOMSHIU I — I them unë. Natën e mirë e punë të mbarë.

BURHANI — Gjumë të ëmbël, Beqo!
(*Afrohet komshiu II*)

BURHANI — Erdhe, Loni?

KOMSHIU II — Unë erdha, ti po shkon?... Ku? U, harrova. Sonte do bësh atë kontrollin në turnin e tretë.

BURHANI — Sonte.

KOMSHIU II — Do t'u vesh papritur, ëh? Ata s'dinë gjë?

BURHANI — Këto lloj kontrollesh, ti e di, po nuk u mbajtën sekret...

KOMSHIU II — Ashtu, ashtu. Natën e mirë!

BURHANI — Gjumë të ëmbël, shoku Loni!
(*Loni ngjitet lart.*)

ZËRI I GRUAS — Ëh, Burhan, ç'do?

BURHANI — Më hidh shallin se kam ftohtë.

ZËRI — Kthehu, mos shko!

BURHANI — Oh, muhabet kot në mes të natës. Po kontrolli?

ZËRI — Ke tre ditë që na hëngre me këtë kontroll.

BURHANI — Bela! Kontrolli që dua të bëj është sekret e s'ka nevojë të vesh tellall në mes të natës.

ZËRI — Si the?

BURHANI — Kontrolli që kam caktuar për sonte në ndërmarrjen time është jashtëzakonisht sekret, prandaj hidhe shallin dhe qepe!

(*Bie shalli nga lart. Burhani e merr dhe*

niset. Përballet me komshiun e tretë që kthehet me të shogën.)

KOMSHIU III — E, Burhan, po shkon për atë muhabetin, ëh?

BURHANI — Jo, do t'u vete papritur. Natën e mirë!

(Burhani nisat për të kryer detyrën e rëndësishme.)

KOMSHIU III — *Gruas.*) Burhani sonte...

GRUAJA — Ka vendosur të bëjë kontroll... E di... Ma thanë...

(Kanë kaluar disa orë. Kthehet Burhani i mbështjellë me shall. Fytyra e tij duket disi e vrarë nga gjumi dhe nga inati.)

BURHANI — Asnjë thyerje disipline!... Asnjë rast gjumi! Me siguri e prisnin kontrollin... Hë, si del ky qerrata sekret! Kush e nxjerr, xhanëm?



NJERIU I «MREKULLUESHËM»

Personat:

NUÇI — përgjegjës i sektorit

LIPJA — kooperativist

RUSTEMI — kooperativist

Zyra e përgjegjësit të sektorit. Aty ndodhen Nuçi dhe Lipja.

NUÇI — E, Lipe, e shikon tani se ku ka arritur zullumi i tët biri?

LIPJA — E shikoj, shoku Nuçi.

NUÇI — Asgjë nuk shikon! Po të shikoje, ti i dilje të keqes përpara... Alamet djali, plot trembëdhjetë vjeç...

LIPJA — Do edhe dy muaj t'i mbushë.

NUÇI — Nuk ka rëndësi... Rëndësi ka që ka fituar një ves të dëmshëm... Hip dhe shkund pemët e papjekura akoma...


LIPJA — Kjo nuk është e vërtetë... Ju kanë raportuar gabim... Ai i shkund që nga toka.

NUÇI — Kështu që... (*Merr në dorë procesin*) më datën shtatëmbëdhjetë, që nga toka ai ka shkundur dy rrënjë mollë të koope-

- rativës. Në pemë s'mbeti asnjë kokërr.
Të gjitha mollët ranë përdhe.
- LIPJA — Në shtëpi ama nuk solli asnjë kokërr.
Dhe kjo të shënohet në proces.
- NUÇI — E përse t'i sillte? Ato nuk hahen.
- LIPJA — Po dua të them se nuk patëm ndonjë
fitim si familje.
- NUÇI — Po ama i shkaktuat dëm kooperativës,
pasurisë sonë të përbashkët, tëndes, ti-
mes, tonës.
- LIPJA — Të atyre, të të gjithëve.
- NUÇI — Dëmi arrin shumë pesëqind lekë. Ko-
misioni i zhdëmtimit ka vendosur që kë-
to para të t'i ndalojë nga ditët e punës.
(*Lipja ul kokën.*)
- NUÇI — E shikon ku arriti puna?
- LIPJA — (*Psherëtin*) E shikoj.
- NUÇI — Ç'do të bësh tani?
- LIPJA — Ja, do ta zë djalin e do ta shqep në
dru... Do t'i futem me rrip nja njëqind
herë që t'i vejë pesë lek rrip, t'i vejë!
- NUÇI — Gabim, gabim... Nuk edukohen njerë-
zit me rrip.
- LIPJA — E di si... ta them troç unë... A do të
ma falni, o shoku përgjegjës?
- NUÇI — Dëmi është dëm.
- LIPJA — Po ama dhe përgjegjësi është përgje-
gjës... Dhe përgjegjësi e ka kaq në dorë.
Ty të mban në gojë gjithë fshati. Nuk e
fale Rakipin kur iu kalbën patatet nga
pakujdesia? Kush i fali Raqit tjegullat e
hangarit? Ti. Kur Nasi, pa dashur dogji
mullarin, u tha do ta paguante. Kush e
fali? Ti. Si do ma bësh?... E, mo shoku
Nuçi, se s'bëhet kiameti...
- NUÇI — Dëgjo, Lipe, ti je njeriu ynë.
- LIPJA — I yni jam.

- NUÇI — Punëtor i palodhur.
 LIPJA — I palodhur jam.
 NUÇI — Tanët jemi.
 LIPJA — Po, de, jemi dhe tanët!
 NUÇI — Po ta fal... (*Gris procesverbalin.*) Ja...
 Por ama që nesër e tutje...
 LIPJA — More kurrë! Mollët nuk kanë për të
 pësuar gjë...
 NUÇI — As mollët, as dardhët, po dëgjo këtu:
 që nesër e tutje...
 LIPJA — Që nesër e tutje...
 NUÇI — Djali të jetë në binarë.
 LIPJA — Mos ki merak... Shumë, shumë të fa-
 lem nderit... Ti je i mrekullueshëm.
 NUÇI — S'ka nevojë për faleminderit!
 LIPJA — Ti je shpirt njeriu. Ti je përgjegjësi
 më i mirë në kooperativë. Ta paça hua,
 o Nuç Ferra!
 (*Del deri tek porta e kthehet përsëri.*) Ti
 ke zemër të bardhë... Ti... ti... ti...
 NUÇI — Mjaft, mjaft!... Njerëz jemi... Fundja
 pesëqind lekë janë...
 LIPJA — E po fundja mollët të kooperativës ja-
 në!... E kooperativa ka...
 NUÇI — Jo të kooperativës, jo!... Por tonat... të
 tuat, të miat...
 LIPJA — Të tuat, të atij, të asaj.
 NUÇI — Tonat, tonat!... Unë i quaj si të miat
 dhe ti t'i quash të tuat.
 LIPJA — Ashtu është... Mollët e mia desh i pa-
 gova nga xhepi im... Ti je zemër flori!...
 Ti je... ç'të them! Me të mira...
 (*Niset të dalë. Përplasat me Rustemin që
 sjell gazetën.*)
 RUSTEMI — Po si nuk ia hoqe djalit atë drejt
 zakon, more Lipe.
 LIPJA — Cilin zakon?

RUSTEMI — Ja atë, që shkund pemët e botës.
 NUÇI — Nuk është mirë që t'i kujtojmë tjetrit
 vend e pa vend gjynahet e vjetra!
 RUSTEMI — Të vjetra? Çfarë të vjetra! Djali
 i Lipës edhe tani sapo i kishte shkundur
 dy-tre kuintalë mollë.
 NUÇI — Të papjekura?
 RUSTEMI — Të papjekura.
 NUÇI — Ç'na polli belaja me të! Ik, Lipe, ik...
 Po ama mos harro që nesër e tutje...



LIPJA — Mos e zgjat... Shumë ju falem nderit!...
 Pa atij ia rregulloj unë!
 NUÇI — Me durim, pa rrip... Pa dru!
 RUSTEMI — Ti, shoku përgjegjës, e ke zemrën
 të gjerë.
 LIPJA — Të gjerë dhe prej floriri... Sopa ia
 thashë... Është i mrekullueshëm.
 RUSTEMI — Dhe këtij njeriu, të mrekullueshëm,
 yt bir i shkoi në oborr dhe i shkundi, pa
 u pjekur, dy kuintalë mollë!...
 NUÇI — Si, mollët e mia?
 LIPJA — Ka shkundur mollën e përgjegjësit?
 RUSTEMI — Po.
 (Pauzë.)
 LIPJA — Shejtani!
 NUÇI — S'po kuptoj... Ka shkundur tonat apo...

- RUSTEMI — Jo, jo të tuat... Personalet...
- NUÇI — Domethënë të miat fare... I shkoi dëm?
- RUSTEMI — S'ka lënë asnjë kokërr!?... *(Pas një pauze.)* Ditën e mirë o shokë! *(Del)*
- LIPJA — Ditën e mirë, o shoku Nuçi! *(Bën të dalë.)*
- NUÇI — Lipe!
- LIPJA — Urdhëro!
- NUÇI — Do të dukesh sot në mbrëmje një çikë andej nga shtëpia ime?
- LIPJA — Pse, shoku Nuçi, si është puna?
- NUÇI — Keq më vjen, po dëmi që u bë duhet llogaritur.
- LIPJA — E ti thua mos e rrih!
- NUÇI — More, djalin daç rrihe, daç mos e rrih. Puna është që duhet të paguash.
- LIPJA — Të paguaj?! Po ne thamë: «nga nesër e tutje»...
- NUÇI — Thamë për ato të kooperativës.
- LIPJA — Ashtu?! Po nuk do të ma falësh, o shoku Nuçi?
- NUÇI — Asnjë qindarkë! Pa fjalë! Mos e zgjat hiç!
- LIPJA — Po unë jam i palodhur... Jam njeriu ynë... Jemi tanët. Ti ato pesëqind lekët tona, që ishin dhe të tuat, m'i fale... Edhe këto të tuat e tjera m'i fal... Hë, shoku Nuçi... Ti je njeri i mrekullueshëm!
- NUÇI — *(Duke u larguar.)* Të pres në shtëpi.
- LIPJA — Shoku Nuçi!... Iku... Qëparë u prek thesi i përbashkët: yni, tuaji, i atij. U tregua zemërmirë... Iu prek qeska e tij e vockël e u bë menjëherë djall me brirë!

LIDHEMI ME LINJËN

Skeç

Personat:

LONI — përgjegjës i një punishteje

LECI — shefi i llogarisë

DY MYSAFIRË me kominoshe.

Zyra e përgjegjësit të punishtes.

Hyn Leci me një telefon të ri në dorë.

LECI — Shoku Loni, ja dhe telefonin na e prunë.

LONI — Më në fund... U kujtuan ata të PT-së.

Shyqyr! Telefoni ka lezet. Telefoni ta

mbush zyrën. Zyra pa telefon... si... si...

si... zyra pa telefon! Ka krahasim më të

mirë? Tani e ndiej veten si me krahë.

Një t'u lidhur me linjën dhe e di kë do

të marr të parin? Eh! Drejtorin e ndër-

marrjes. E ndieja veten ngushtë kur për

çdo problem trokisja në zyrën e tij. E po

jam përgjegjës punishteje, dreqi ta hajë.

Bukur!

LECI — Bukur për besë.

(Të dy ia kanë ngulur sytë aparatit telefonik. Heshtje.)

LONI — Bukur, bukur! Më kënaqë, Lec. Shefi

bën lejen dhe kur vjen, hop, një e papritur e këndshme: telefoni i ri fringo!

LECI — Kam edhe një të papritur tjetër, shoku Loni, bile të rëndësishme, po kam frik se nuk është fort e këndshme.

LONI — Ashtu?! Pa folë!

LECI — Te ne para pesë ditësh ka ardhur një gazetar për punën prodhuese. Një grup punëtorësh kishin përgatitur një fejtון për ju...

LONI — Për mua?!

LECI — Po... Për tendenca burokratike e ku ta di unë... Teksti më ra në dorë edhe mua. Të them të drejtën, ishte një gjë e bukur...

LONI — Lec...

LECI — Unë po flas nga ana artistike... Sikur ta lexoje dhe ti vetë do të shqyheshe gazit. Po problemet që ngrinin s'janë të vërteta... Aspak...

LONI — Po ai gazetar si duket?

LECI — Djalë simpatik, trup mesatar, me kominoshe...

LONI — Leri, mor, kominoshet. Po të pyes si duket, ç'mendon për fejtounin ai?...

LECI — Ah, po... tha se pasi të bindet që puna ka çaluar e pasi të të njohë edhe ty do ta redaktojë dhe do ta botojë.

LONI — Ashtu? Bukur! E deri tani ç'ka bërë?



LECI — Ka pyetur lart e poshtë.

LONI — E askush nuk i ka folur një fjalë të mirë për mua? Kështu?

(Pauzë)

LECI — (Nxiton) Besa, mua nuk më ka pyetur akoma.

LONI — Cili është ky gazetar? E njohim ne?

LECI — Posi more... Ai që shkruan me pseudonimin «Piperka».

LONI — Hm... Mirë, shko ti shko.

LECI — Po shkoj, po shkoj... (Del)

LONI — (Vetëm) E bukur kjo punë! Tani do të ishte mirë të dilja njëherë nëpër reparte. Ai do të më shihte në aktivitet. Takohesha me të gjatë punës dhe atje do të mund t'ia ktheja mendjen. (Shkon pranë dritares.) Jo, atje në prani të punëtorëve nuk do të thoshja dot as dy llafe, se mund të ma përplasë ndonjë punëtor e më dalin lakrat... Ja! Ja ku është! Ai vetë duhet të jetë «Piperka». Me kominoshe... Di unë se si ta vërtis me të... Sigurisht, nuk do të jem shumë i sjellshëm, po as edhe brutal... (Befas i alarmuar.) Po pyet! E ngrihti dorën nga dritarja ime! (Tërhiqet pak.) Po vjen! Ç't'i them?... (Ulet në karrige. Ngrihet prapë. Ulet. Merr telefonin.) Po sikur... Se mos e di ai që telefoni s'është i lidhur. (Fsheh kordonin e varur.) Kështu. (Trokitje) Hyr! (Në derë shfaqet një djalë me kominoshe. Loni me një indiferentizëm të shtirur e fton të ulet. Djali me kominoshe ulet. Loni vazhdon për një kohë të gjatë të dëgjojë në receptor dhe kur gjen rastin që tjetri nuk e sheh, e studion me sy të çapëlyer. Kordonin e varur e fsheh me marifet. Troket përsëri dera.)

LONI — Hyr!

(Hyn një djalë tjetër me kominoshe, dhe ky i panjohur për Lonin. Loni ia bën edhe këtë me dorë, si të parit. Ulet dhe tjetri.)

LONI — *(Me vete.)* Po ky?! Tani u ngatërrua puna. Ky i dyti cili të jetë vallë? Cili nga këta është «Piperka»? *(Pa u ndarë nga telefoni u zgjat paqetën. Ata nuk e pijnë të dy.)* *(Në telefon.)* Po, po... dhe thashë... gjëja e parë që do të bëjë do të vizitoj re-partet... Kam kaq ditë që jam shkëputur prej tyre. *(Qesh)* Natyrisht... *(Pauzë.)* Ohu, ju paskeni pritur sa të mbaroj lejen që të m'i thoni gjithë këto lëvdata?! T'ia kishit thënë kolektivit, shoku drejtor i përgjithshëm. Po. Ai është i mrekullueshëm. Vetëm në gjirin e tij unë munda të bëhem i denjë për këto lëvdata që po më thoni. Përse? Ah, për ato novacionet e fundit. Po, po. Jua thashë, shoku drejtor, që nuk duhet të më lavdëroni vetëm mua... Si? Nuk e them për modesti. Si? Po e pranoj... Është deri diku merita ime... Ashtu keni raportuar edhe më lart për punën time? Më falni, unë s'mund t'ju korrigjoj por këtë nuk duhet ta kishit bërë. Nuk duhet, se tani, si të thuash, do të kemi telashe. Do të më vijjnë shokët e radios, të gaze-tës... Jo, jo, nuk them se është keq. Faleminderit!... Jam i lumtur, por... jemi pak të drojtur ne, shoku drejtor, se ky popullaritet na huton. Ne dimë vetëm të punojmë në heshtje. Ju faleminderit! Shoku drejtor, mos ma merrni për mungesë respekti, por ju propozoj ta ndër-

presim bisedën. Më duhet të zbres nëpër reparte. Si?... E kam zakon këtë?... E po mirë, s'më vjen turp të them që e kam zakon! Jo vetëm kaq, po kam në zyrë edhe nja dy punonjës të cilët duhet t'i dëgjoj me vëmendje. Patjetër... Mirupafshim! Veç një gjë kisha, shoku drejtor... Po erdhën shokë nga gazeta ose radioja, informoni ju atje e mos na, i dërgoni se... Mirë, mirë dakord që do të duan të vijin këtu në vend, por ka telashe kjo punë. Pa unë s'jam dhe fotozhenik. Përndër, njëzet vjet martesë, një fotografi me gruan s'kam bërë. Nuk dal mirë... Si? (Kategorik.) Jo, jo! Në asnjë mënyrë! Nuk jemi nga ata ne! Le të na gjejnë kështu si jemi: me të mirat dhe të metat tonë... Mund të qëllojnë të takohen dhe me njerëz që venë në dukje vetëm të meta. S'ka gjë... E vërteta është... si të them, është si e vërteta! A ka krahasim më të mirë?! Ajo del në shesh. Mirupafshim! (Le telefonin.) Hë shokë, si e keni hallin? Më falni, unë nuk ju njoh, kush jeni ju?

I PARI — Unë kam disa ditë këtu. Kam ardhur për punën prodhuese... Jam gazetar, mbase ju kanë thënë.

LONI — Aha, shumë mirë... Jo, nuk më kanë thënë. I kam porositur të mos më lajmërojnë kurrë për gjëra të tilla. Po ju?

I DYTI — Unë kam ardhur për telefonin.

LONI — Si, për telefonin?

I DYTI — Jam punonjës i centralit telefonik dhe kam ardhur që të lidh telefonin tuaj të ri me linjën...

ENDRRAT E LIPES

Skeç

Personat:

LIPJA
KRYETARI
SADIKU

*Zyra e kryetarit.
Një telefon i varur
në një anë. Kryeta-
ri po bisedon.*

KRYETARI — Po... U pre...
Si, moj, u pre?!... (Po
mirë, na lidhni pra-
pë. Kush që, komi-
teti? Këtu jam, në
telefon.) *E mbyll te-
lefonin dhe shkon
në tryezë.)* Kështu,
o Isuf, unë nuk jam
dakord... Toka e
bukës është tokë
buke, vëlla... Nuk
do ta le më për kullotë. Shikojmë rrugën
më të lehtë. Po të jemi në rregull me sila-



zhin e zahirenë, nuk do të arrijmë në këto propozime... Nisu tani, shiko a u mblo dhën çobanët... Do të vij edhe unë në mbledhje. (Del Isufi.) Ti, Sadik, ç'kishe?

SADIKU — Për nesër...

KRYETARI — Aha, për aksionin me goditje të përqendruar që ka brigada juaj. Mirë, nuk harroj. Në ç'orë duhet të jemi atje?

SADIKU — Në katër e gjysmë.

KRYETARI — Mirë, në katër e gjysmë. (Sheh sahatin e nis ta kurdisë.) E keni organizuar mirë, apo jo?

SADIKU — Besojmë se po.

KRYETARI — Ajo është kryesorja. Organizimi i mirë të nxjerr në dritë. Hajd, natën e mirë! Ti, Lipe, çfarë halli ke?

LIPJA — (Shumë i preokupuar.) Unë, shoku kryetar, kam një problem tepër të rëndësishëm.

KRYETARI — Ohu, vërtet?!

LIPJA — Po, po vërtet.

KRYETARI — Si është puna?

LIPJA — Mua, shoku kryetar, më ha merakun që fshati ynë të jetë mirë e më mirë... Kooperativistët...

KRYETARI — Si, më mirë? Pse, ç'kanë kooperativistët tanë!?

LIPJA — Asgjë s'kanë. Për bukuri janë... u lumtë. Në pararojë janë. Por unë dua që dhe në rrugë t'i shohim të rregullt, të veshur, të qethur, të rruar...

KRYETARI — Ore Lipe, mos na sill vërdallë...

LIPJA — Si urdhëron... Unë, shoku kryetar, kam vënë re një gjë aspak të pëlqyeshme... Me keqardhje, por jam i detyruar ta them.

KRYETARI — Çfarë?

LIPJA — Ka kooperativistë, midis tyre bile dhe nga ata të dalluarit, që rruhen një herë në dy ditë dhe bile dhe një herë në tri ditë. Le për t'u qethur pastaj...

KRYETARI — More Lipe, aman se më fryve! Ku kërkon të dalësh? Nuk kam kohë unë ta humb me ty. Ou, bjeri shkurt!

LIPJA — Shkurt, si urdhëron, shkurt! Shoku kryetar, unë, shfaq dëshirën, vullnetarisht, pa më detyruar njeri, vullnetarisht ëh, të më largoni nga puna në fushë e të punoj berber me berberët e tjerë... Ja kjo qe...

KRYETARI — Vërtet, more? Kaq shumë dëshirë ke?

LIPJA — Shumë. E beson? S'më zë gjumi natën.

KRYETARI — Prandaj fle ditën në fushë ti! More Lipe, mos më sheh gjë pa rruar ti mua?

LIPJA — Jo, shoku kryetar, nuk e thashë për ty... Megjithëse, sikur të hiqje një brisk të lehtë tani s'do të qe keq. Edhe pak anët dhe hajd, me shëndet!

KRYETARI — Prit, ore, prit, leri karagjozllëqet. Në rregull jam. Dhe Sadiku nuk ishte i parruar. Dhe Isufi në rregull qe, apo jo? Cilin shikon pa rruar ti? Se na e bëre problem të madh. Tre berberë i kemi mjaft.

LIPJA — Jo, të më kuptosh drejt... Unë e pranoj... Por ja që e kam qejf, jam lindur për berber... Që i vogël, për nder dy vjeç kam qenë, më merrte gjyshi në prehër. Unë menjëherë dorën tek mjekra. I lindur, s'ke ç'thua, i lindur. Më bëj mura-tor, furxhi — s'kam qejf... Tani dhe ato

me ditë fikse janë. Mirë janë. Po nuk i kam qejf... Berber...

(Bie zilja. Kryetari ngrihet dhe shkon te telefoni.)

KRYETARI — Alo... Po unë jam... Faleminderit! Ç'kemi andej nga qyteti?... Mirë. Urdhëro. Nuk dëgjoj... Po... Duhet një njeri nga kooperativa jonë ta dërgojmë në kurs tremujor për regjisor? E mora vesh... Teatro... Mirë, mirë do ta keni aty pas një jave... Posi. Hajd, me të mira!

(Lë telefonin dhe vjen tek karrigia. Lipja, si berber, i pastron karrigen dhe ia kthen jastëkun. Kryetari s'ulet.)

KRYETARI — Flije mendjen, Lipe! Në fushë! Atje e kemi frontin kryesor. T'i vemë forcat atje. Mos e zgjat më... Ik tani se po më presin çobanët.

LIPJA — Një minutë, shoku kryetar.

KRYETARI — Hiqe nga mendja berberin të thashë.

LIPJA — E hoqa, mbaroi.

KRYETARI — E po ç'do atëherë?

LIPJA — Meqë u ndodha këtu, dëgjova bisedën tuaj në telefon. U dashka një njeri për tre muaj në qytet për regjisor... Ja ku jam. Vullnetarisht pa më detyruar njeri, vullnetarisht shkoj unë... E ndiej që kam lindur...

KRYETARI — *(Duke ikur.)* Lipe, po bindem se ti ke lindur vetëm për rehatllëk.

(Del kryetari. Nga ana tjetër nis të dalë dhe Lipja.)

NJË ZË — Lipe, e ore. Bisedove me kryetarin për në rrojtore?

LIPJA — Bisedova. Asgjë. Si rruar-qethur!

DREJTORI I NDËRMARRJES

Skeç

Personat:

DREJTORI

SHEFJA E KUADRIT

ASIMI | punonjës që vijnë të bëjnë punën

KIÇOJA | në prodhim

PUNËTORË të objektit

*Objekt që ndërtohet. Punëtorët punojnë.
Vjen shefja e kuadrit.*

SHEFJA — Mirëmëngjes, shokë!

ZËRA — Mirëmëngjes!

SHEFJA — Drejtori ku punon?

NJË ZË — Shikoj nga grapa e gëlqeres.

NJË ZË TJETËR — Jo, jo! Po suvaton në ka-
tin e parë.

SHEFJA — Ju falemi nderit!

*Pamja e vendit ku punon drejtori. Drej-
tori është i veshur me rroba punë e s'ka
asnjë ndryshim nga punëtorët. Po suvaton.*

DREJTORI — Sillni llaç!

SHEFJA — Mirëmëngjes, shoku drejtor!

DREJTORI — Mirëmëngjes, Neta! Ç'kemi?
SHEFJA — Si po shkon puna në prodhim?
DREJTORI — Mirë, ja po mbaron. Dhe dy ditë kam.

SHEFJA — I bëtë që i bëtë të plota.

DREJTORI — Epo, duhen bërë. E di ti që po mësoj zanat?

SHEFJA — Kështu po thonë të gjithë. Ju lumtë!...

(Pauzë. Drejtori ndez cigaren.)

DREJTORI — Me cigaren e kam pisk... Jam mësuar në zyrë me nga dy paketa, po këtu s'të lë njeri. Brigadieri më ka tërhequr tri herë vërejtjen.

SHEFJA — *(Qesh)* Unë kam një problem të ngutshëm në zyrë. Duhet të jeni edhe ju patjetër.

DREJTORI — Keni nëndrejtorin aty.

SHEFJA — Duheni ju medoemos. Na kërkohet një relacion urgjent. Po sikur t'ju marrim leje te brigadieri?

DREJTORI — Mos na ngatërroni... Puna në prodhim është punë në prodhim. Vij pas dy ditësh.

SHEFJA — Është punë e ngutshme, ju thashë.

DREJTORI — Atëherë po vij kur të mbaroj orarin e punës.

SHEFJA — Por...

DREJTORI — Neta, mos e zgjat se më le pa plotësuar normën... *(Bërtet.)* Sillni llaç... Është e treta herë që po ju them. Ej, Viktor, më jep mistrinë time se me këtë nuk punoj dot.

(Shefja largohet duke qeshur.)

Pamja e parë. Në oborrin e ndërtesës vullnetare. Vijnë Asimi dhe Këçoja

KIÇOJA — Mbase ua mbushim mendjen që të na e quajnë edhe ditën e djeshme.

ASIMI — Kjo duhet të jetë. (Shefes) Mirëdita, shoqe! Ju jeni shefja e kuadrit?

SHEFJA — Po.

KIÇOJA — Ju po ju kërkonim. Ne jemi dy shokë që na kanë dërguar të kryejmë punën në prodhim.

(I japin shkresat.)

ASIMI — Mundësisht na caktoni ndonjë punë pak kështu...

KIÇOJA — Pa normë dhe të mos jetë aq, si të thuash, e ndotshme...

ASIMI — Pa normë dhe pa lodhje të madhe.

KIÇOJA — Të jetë pa normë, pa lodhjes ia, tregojmë qejfin vetë.

SHEFJA — Jo do punoni në banesat... Këtu kemi nevojë...

ASIMI — E ç'do të bëjmë këtu?

SHEFJA — Të mbani tulla e llaç.

TË DY — Tulla, llaç?!

SHEFJA — E pse jo edhe zhavorr... Po me normë, ama.

ASIMI — Po në banesa është puna më e vështirë.

SHEFJA — Pikërisht!

KIÇOJA — Unë nuk e kuptoj pse silleni kështu. Ç'ju kemi bërë?... Me ne do t'i bëni banesat ju?

ASIMI — Ky caktim është tendencioz, ambicioz dhe skandaloz.

KIÇOJA — S'ka ndonjë vend për marangoz?

ASIMI — Që ditën e dytë të punës në prodhim drejt e në të thella.

SHEFJA — Dita e dytë? Pse e dyta?

KIÇOJA — Se ne puna në prodhim na ka filluar që dje.

SHEFJA — Mund ta keni filluar edhe para një jave, po këtu tek ne ju fillon që nesër.

TJË DY — Që nesër? Po kjo punë?

KIÇOJA — Në shkresë e kemi që dje, po dje u përgatitëm, u matëm mirë e mirë se s'është kollaj. Po nejse... Pse jo që sot?

SHEFJA — Ora është dhjetë. Tek ne puna fillon më shtatë. Objektin ja ku e keni... Sot njihuni me punën e njerëzit e nesër të filloni. Më shtatë pa një çerek fillon gjimnastika. Mirupafshim! (*Largohet*)

KIÇOJA — Dhe gjimnastikë! Obobo! U futëm shumë thellë.

ASIMI — Unë s'kam bërë gjimnastikë ka pesë vjet.

KIÇOJA — Do të bësh tani sa për pesëmbëdhjetë. Unë do të ankojem.

ASIMI — E hu! Leri llafet dhe hajde të njihemi me punën... Mbase na qëllon ndonjë usta i mirë.

Pamje e dhomës ku punon drejtori. Drejtori është i thelluar në punë.

KIÇOJA — Të tregohemi të thjeshtë... Se këta punëtorët e ndërtimit e di sa vënë re? Dhe fjalët me kujdes. Jo fjalë të mëdha se mund të ketë nga ata që s'i marrin vesh.

ASIMI — Aman se më mërzite... Unë kam hallin e krahëve, ti ke hallin e gojës... Tungjatjeta, shok!

DREJTORI — Tungjatjeta!... (*U jep dorën.*)

ASIMI — Ndize! (*I zgjat paketën.*)

DREJTORI — Prit t'ju jap unë...

ASIMI — Jo, jo, merre këtu!

DREJTORI — (Më *dysh*) Do ta marr, po e teprova... Po më pa brigadieri...

KIÇOJA — E paskeni të rreptë.

ASIMI — S'ka gjë, je me ne...

(E *ndezin*)

ASIMI — Sa është masa e investimit për këtë banesë?

KIÇOJA — Të thashë, leri fjalët e mëdha... Investime. E ku kupton ai. (Drejtori) Vetëm këtë banesë ka në plan ndërmarrja juaj?

DREJTORI — Vetëm këtë. Po ju çfarë jeni?

KIÇOJA — Jemi nëpunës. Kemi punën në prodhim.

ASIMI — Dhe na e ngopën këtu... Po ka zot që bën njëzet e gjashtë ditë këtu?!

DREJTORI — Po ne të tjerët ç'jemi?

ASIMI — Tjetër ju, mor ti shoku punëtor, tjetër ju. Ju e keni zanat. Juve nuk ju bën përshtypje. Kurse ne nuk jemi mësuar.

DREJTORI — Aq më mirë, do të mësoheni.

KIÇOJA — Po kishte edhe sektorë të tjerë. S'u bë kiameti!

ASIMI — More Kiço, kur s'vajtëm të qaheshim tek drejtori... Thonë, se është burrë i mirë.

DREJTORI — Çka, por nuk ka ç'ju bën drejtori. Është vendim i prerë. Puna do të bëhet këtu.

ASIMI — Po sidoqoftë ne ta takonim.

KIÇOJA — Po mirë, shkojmë e takojmë. Drejtorja ja ku është.

DREJTORI — Nuk do ta gjeni në drejtori. Edhe ai po kryen punën në prodhim.

ASIMI — Dhe ai në prodhim?! Kjo qenka e bukur! Dhe me siguri do të ketë sajuar ndonjë qoshe të lehtë...

- DREJTORI — Çka, nuk e ka të vështirë...
- ASIMI — Po s'do mend. S'janë budallenj dynjaja! Ne na kanë lënë llaçin dhe tullat. Puno, vëlla, puno, se të lamë pa punë.
- KIÇOJA — Se ke për të ushqyer kalamajtë, ore!
- ASIMI — Apo s'bëjnë kalamaj këta... Xhaxha, sa kalamaj ke?
- DREJTORI — Gjashtë dhe një e pres tani shtatë.
- KIÇOJA — Të lumtë!
- ASIMI — Po brigadieri çfarë temperamenti ka?
- KIÇOJA — Shih ky me «temperament»... Xhaxha! Është ndonjë çikë zevzek ky brigadieri juaj?
- DREJTORI — Po punove është shpirt njeriu...
- TË DY — Aha, po punove?!
- KIÇOJA — Të them të drejtën, or vëlla, unë kam qejf të punoj me ty.
- ASIMI — Dhe unë... Pa puno një herë të shohim...

(Drejtori punon.)

- TË DY — O hoho... Kësaj i thonë punë!
- KIÇOJA — Fiu-fiu... I shpejtë qenke, xhaxha.
- ASIMI — Të lumtë, xhaxha, mjerë ai ndihmës që punon me ty... Mbase na caktojnë të dyve së bashku.
- DREJTORI — Dërgoni llaç!...
- NJË ZË — Erdhi!
- DREJTORI — Më falni! Me këtë mistri nuk punoj dot... Po shkoj të marr mistrinë time. *(Del)*
- ASIMI — Shko, usta shko!
- KIÇOJA — Këtë të mirë ka puna në prodhim... Njihesh me klasën punëtore... Ai do të na japë përvojën e tij të jetës, kurse ne do

t'i sqarojmë atij situatën ndërkombëtare,
koston e prodhimit...

(Vjen një punëtor me llaç.)

ASIMI — *(Nxjerr paketën.)* Si jeni, shok... Ur-
dhëroni, ndizeni!

PUNËTORI — Faleminderit, nuk e pi!

KIÇOJA — Ndhmës jeni?

PUNËTORI — Po.

KIÇOJA — Të mirë e keni ustain, ë? Sa vjet
ka në zanat?

PUNËTORI — Kush?

KIÇOJA — Ja ky ustai që punon këtu.

PUNËTORI — Ai s'është usta. Ai s'ka asnjë
muaj këtu. Bën punën në prodhim. Është
drejtori i ndërmarrjes.

TË DY — Ah!

KIÇOJA — Ky xhaxhoja?!

ASIMI — Këtij ne deshëm t'i sqaronim situa-
tën... Po si punon?

PUNËTORI — Siç e patë. Ashtu tetë orë rresht!
Kenë parë drejtor në tabelë me punonjë-
sit e dalluar? Ja ky yni është.

(Largohet)

KIÇOJA — Ke gojë tani?

(Asimi e qep gojën me gishta.)

KIÇOJA — Njëzet e gjashtë ditë nga tetë orë,
dyqind e tetë orë llaç.

ASIMI — Plus gjimnastikën e mëngjesit.

DREJTORI — *(Kthehet)* Po mirë, pse nuk fillo-
ni?

KIÇOJA — Nesër fillojmë... në orën shtatë.


ASIMI — Më shtatë pa një çerek. *(Bën lëvizje
gjimnastikore.)* Erdhëm sa për t'u njohur
me punëtorët dhe me punën.

DREJTORI — Epo, si ju dukemi ne punëtorët?
 ASIMI — Ju punëtorët?!... Hi hi hi!...
 KIÇOJA — Si punëtorët. A ka krahasim më të mirë?!

DREJTORI — Po puna?
 KIÇOJA — Puna bëhet... Do ta bëjmë.
 DREJTORI — Hoqët dorë nga mendimi për t'iu ankuar drejtorit?
 ASIMI — Pu pu pu!

DREJTORI — Pse? Ju njoh unë me të.
 TË DY — S'ka nevojë, e njohëm shumë mirë tani...

KIÇOJA — Mirupafshim nesër në ora shtatë, xhaxha!
 ASIMI — Mirupafshim më shtatë pa një çerek, xhaxha!



PEÇOJA KA REZERVA

Skeç

Personat:

PEÇOJA
DHIMITRI

Në rrugë.

PEÇOJA — Kështu që Shkëlqimi u propozua të dekorohet, ëh?

DHIMITRI — Po.

PEÇOJA — Djalë xhevahir, punëtor i papërtuar. Ta gëzojë dekorimin!

DHIMITRI — Ta, gëzojë, vërtet! E meriton.

PEÇOJA — Pehlivan i shkathët... Pa, pa, pa!... Mori formë të prerë?

DHIMITRI — Ti e di që

po. Ky problem u diskutua hapur... Kush kishte vërejtje mund t'i thoshte.



PEÇOJA — Pse më pas nuk mund t'i thuash?
Se të dekorohesh....

DHIMITRI — Ore Peço! Ke ndonjë gjë për
Shkëlqimin?

PEÇOJA — Dhe në kam, or ti shoku Dhimo,
shoku Miti, unë matem... Matem se shpesh
jam ndeshur me të... Debat! Bam! Debat!
Po unë jam nga ata njerëz që atë që më
kritikon e dua më shumë... Po më shu-
më, më shumë, më shumë dua dinjitetin
tonë... prestigjin!... Shkëlqimi ta gëzojë!...
E kyça! (Bën të ikë). Po të mos kujtojë
se ne hamë bar! Mbahet më të madhe si-
kur fap, na lindi sot... Dhe ai ka të ka-
luarën e tij... E kaluara hm, hm...

DHIMITRI — S'ka njeri pa të kaluar, po ti mos
bëj dëngër-mëngër... Çfarë ke thuaje aty
ku duhet thënë...

PEÇOJA — Ti mos u nxe!... Se ti je në rre-
gull. Ty të pifsha dollinë, se ti je brigad-
ier. Ore, të jenë të gjithë si ti, por nuk
janë. Unë nuk jam as shef e as drejtor,
po nëpunës i thjeshtë antiindiferent, an-
timoskokëçarës, antiliberal...

DHIMITRI — Bën mirë të jesh edhe antirrotull-
-rrotull... Fol!

PEÇOJA — Kam mbledhur ca të dhëna... Ve-
tëm që i dua të mirën atij dhe mbroj di-
njitetin e ndërmarrjes... E njeh Shkëlqi-
min?

DHIMITRI — E njoh.

PEÇOJA — Po të fejuarën?

DHIMITRI — Dhe atë.

PEÇOJA — Bukur, e dini ku banon e fejuara?

DHIMITRI — E di.

PEÇOJA — Kë ka përballë?

DHIMITRI — Ehu, ç'më duhet?

PEÇOJA — Ah jo, ç'më duhet... Këtu fillon indiferentizmi! Ne duhet të jemi antiindiferentë, antimoskokëçarës.. E di kë ka përballë?

DHIMITRI — E di, Gogon.

PEÇOJA — Gogoja ka qenë një vit në burg për rrahje me bisht lopate.

DHIMITRI — Je në terezi ti, Peço? Ç'lidhje ka Shkëlqimi me Gogon... Mos m'i ngre nervat, ne flasim për shoferin tonë e jo për komshinjtë e të fejuarës.

PEÇOJA — Eh, duket si pa rëndësi! Po a e di ti pse u rrah Gogoja me bishtin e lopatës?

DHIMITRI — Ma merr mendja se nuk kishte bisht tjetër në dorë!

PEÇOJA — Jo. Sepse Gogoja dhe ai tjetri deshën të fejojeshin me atë që është sot e fejuara, e Shkëlqimit! Tani lind pyetja... Përse kjo vajzë u prish mendjen qytetarëve?

DHIMITRI — Po e?...

PEÇOJA — Dhe përse Shkëlqimi nuk u ruhet këtyre skandaleve? Tjetër, e di kush e sjell bukën në dyqanin tonë?

DHIMITRI — Jo... A, po, po... një burrë me karrocë.

PEÇOJA — E njëh atë burrin?

DHIMITRI — Jo, as burrin, as karrocën.

PEÇOJA — Po kalin?

DHIMITRI — Ç'hyn kali këtu?

PEÇOJA — Hyn që ç'ke me të... E bën gabim që nuk interesohesh. Atë kalë e mbath me patkonj një nallban, i cili ka marrë bakshish nën dorë dhe i është hequr dy vjet leja e profesionit. E pra, atë nallban Shkëlqimi e ka kushëririn e tretë të nënës.

DHIMITRI — Jo more, kushëri të tretë?!

PEÇOJA — Të nënës! Ka, më e afërt se nëna?... Shkëlqimi do të dekorohet! Dhe tamam Shkëlqimi, që mbase ju nuk ë dini që para tre vjetësh iu mor patenta.

DHIMITRI — Pastaj ua dha prapë dhe iu fal gabimi se ishte i ri.

PEÇOJA — S'ka rëndësi patenta, ka rëndësi gjesti, gjesti!... Shpejtësia e tij ishte e lahtarshme, nuk numëroheshin dot shtyllat e telefonit!... Sa thoshe ti «një»... ato kishin kaluar pesë!... Fiu! Fiu! Fiu!

DHIMITRI — Ti ishe në makinë?

PEÇOJA — Brenda. Pra rrezikoi veç të tjerash edhe jetën e një njeriu, të një nëpunësi të thjeshtë, por që bën një punë kyçe... Po sikur të ishim rrëzuar? Do të kisha vdekur... Po le unë, se fundja po salkrifikoj, po makina që ishte blerë me valutë?! Po plani, plani, shoku Dhimitër?!

DHIMITRI — Ke më, Peço?

PEÇOJA — Plot!... Në gjimnaz e kanë nxjerrë nga mësimi dy herë se ka bërë zhurmë. A nuk kemi ne shofera me të kaluar më të pastër, që nuk u është marrë patenta dhe që nuk janë nxjerrë jashtë në gjimnaz?

DHIMITRI — Ore, në fillore nuk shkove të pyesësh?

PEÇOJA — Jo! Pse, shoku Dhimitër, rezulton gjë?

DHIMITRI — *(Konspirativ)* Po, rezulton se ka derdhur bojën e shkrimit në dyshemenë e pastër të klasës dhe në orën e zoologjisë kishte sjellë fshehurazi një macë. Në kopsht s'ka pasur qëndrim të mirë, kurse në çerdhe ka përvetësuar biberonin e një shoku dhe ka thyer një oturak.

PEÇOJA — (*E kupton talljen.*) Prit, shoku Dhimitër!

DHIMITRI — Këto ishin nga e kaluara e hershme e Shkëlqimit. Kurse sot mbi shpatullat e tij rëndon fakti që Dhimitri i nxehur, Peços që kërkon qimen në vezë po gatitet t'ia bëjë kurrizin më të butë se barkun!

PEÇOJA — (*Duke u larguar me frikë.*) Shoku Dhimitër, shoku Dhimitër, shoku Miti... U nisa nga dëshira e mirë se jam antiindiferent, mos antikokëçarës... Mori së prapi!.... U prish tërë puna... (*Largohet me vrap.*)

ALMA RRJEDH NGA MAJMUNI

(Tregim i një vajze katërvjeçare)

Sot në kopsht, kur po shikonim ca revista me kafshë, edukatorja na tha një gjë që ne nuk e kishim dëgjuar më parë:

— Ne njerëzit rrjedhim nga majmuni!

Mbetëm me gojë hapur. Shikonim edukatoren.

— Po, po fëmijë të dashur, ne së bashku rrjedhim nga majmuni...

— Edukatore, të gjithë? — pyeta unë.

— Pa përjashtim, — tha edukatorja dhe iku e na la vetëm.

Floriani dhe Brikena filluan të qanin. Pastaj filluan të qanin dhe nja dhjetë të tjerë. Ishin që të gjithë nga katër vjeç dhe që të gjithë rridhnin nga majmuni.

Erdhi edukatorja dhe mezi i pushoi.

Ne e pyetëm përsëri edukatoren që të na e shpjegonte, po ajo na e preu:

— Pushoni, se ju s'merrni vesh. Është shkencore... Ne nuk e pyetëm më se ajo bëretet pastaj. Dhe një ditë, kur Eriona shkeli bariin ku kullosnin disa lopë, edukatorja tha:

— Të dashur fëmijë, Eriona shkeli qumështin, se bari bëhet qumësht.

E pyetëm si bëhet, ajo tha:

— Mbylleni gojën, se kjo është shkencore...

Po punë e madhe për bariun! Mua më mbeti mendja te majmuni! Kur dola, nga kopshti s'mendoja gjë tjetër. Domethënë dhe xhaxhi Liku, që shet kartolina ngjitur me kopshtin tonë rridhte nga majmuni, dhe xhaxhi Stefani që kishte hipur mbi shkallë e rregullonte antenën rridhte po nga majmuni.

Ia tregova gjyshes.

— Nuk e di për të tjerët, — tha gjyshja, — po fisi ynë, me ç'mbaj mend unë, jo një herë! Majmunë s'kemi pasur ne.

Vrapova tek gjyshja tjetër, mami i mamit. Ajo u inatos:

— Majmunë nga raca jonë?! Ç'janë këto marrëzira! Ne në fis kemi pasur vetëm njerëz të pashëm e me shëndet të plotë.

U gëzova. Sa u gëzova!

Kur erdhi babi nga puna ia tregova gjithë historinë duke qeshur.

— S'ka gjë për të qeshur, — tha ai, — vërtet ne rrjedhim nga majmuni. Po ti s'ke njohuri shkencore e nuk e merr vesh. Tani më lerë rehat se jam i lodhur.

Shkova tek mami. Ajo po lante në govatë.

— Do, s'do ti, — më tha, — ne rrjedhim nga majmuni. Puna na bëri njeri, po hiqmu se kam akoma punë! Shko fli!

Dhe më dëboi nga banja.

U shtriva po nuk flija dot. Pastaj më zuri gjumi. U zgjova shpejt. Kot që na e thanë këtë shkencoren. Tani unë nuk e dija si ishte e vërteta. Rrjedhim apo nuk rrjedhim

nga majmuni. Se ca thonë po e ca thonë jo.
Unë vendosa:

E vërteta është si thonë gjyshet. Ato janë të vjetra dhe e dinë më mirë. Pra, unë rrjedh nga gjyshet e nga gjyshërit e mi që janë aq të mirë e aq të bukur.

Majmunët.. Majmunët po deshën le të pëlcasin nga inati!

USHQIMI I FËMIJËVE TANË

Skeç

ANDONI

KIÇOJA — shok i Andonit

LETA — gruaja e Andonit

*Dhoma e pritjes në shtëpinë e Andonit.
Andoni dhe Kiçoja kanë përpara tyre fletë të të përhapura e përgatitin me to një temë për ta referuar.*

ANDONI — *(Duke verifikuar shënimet e tij.)*

Që prindi duhet të mos bëjë asnjë lëshim në tekat e fëmijëve e kemi thënë?

KIÇOJA — *(E verifikon.)* E kemi thënë.

ANDONI — Po... se kjo sjell pasoja të dëmshme në edukimin me konsekuencë...

(Zhurmë nga kuzhina.)

ANDONI — Më fal një minutë.

(Andoni del, Kiçoja shkruan. Kthehet Andoni.)

ANDONI — Ku e lamë? Shtegu i lëshimeve, po u hap, do s'do zgjerohet.

KIÇOJA — Ja, kjo është e bukur. Ta themi.

(Dëgjohet përsëri zhurmë në kuzhinë.)

ANDONI — *(Vë veshin andej nga vjen zhurma, pastaj.)* Na ka gjetur belaja me djalin, nuk na ha.

KIÇOJA — Nuk hanë, more, nuk hanë.

ANDONI — I tërbon bollëku, nuk u mungon asgjë prandaj.

KIÇOJA — Naze! Vetëm naze! *(Shkruan duke përsëritur.)* Shtegu i lëshimeve...

(Leta me pjatë e lugë në dorë ka qëndruar tek dera.)

KIÇOJA — Ç'kërkon nusja?

ANDONI — Nusja le të vetëveprojë! Vazhdo ti...

KIÇOJA — *(Me takt.)* Mos u druani nga unë, ju lutem!

ANDONI — Në asnjë mënyrë! Dhe si për ironi po shkruajmë pikërisht këtë temë për ta lexuar përpara lagjes.

LETA — S'ka vënë gjë në gojë!

ANDONI — Le të mos verë!

LETA — Ka humbur treqind gram.

ANDONI — Treqind gram?!... Bravo i goftë! Ato treqind gram ia kam futur vetë nga goja me këto duar çik e çik...

LETA — Andon, të lutem!

KIÇOJA — Po ç'kërkon gruaja?

ANDONI — Gruaja, pasi i rreshtoi djalit në tryezë të tëra të mirat, do që të plotësojë tekat e tij. Kam bërë ç'kam bërë, tani s'bëj më! Le të mos hajë!

KIÇOJA — Mos ia prish shoqes.

LETA — Se të parët e kanë thënë: shpirti nga goja hyn dhe nga goja del. Unë po pres

dhe një minutë e po e ve në gjumë pa ngrënë... Me barkun bosh. (*Largohet*)

ANDONI — (*I nevrikosur*) Vazhdojmë! (*Duke kërkuar nëpër fletë*) Vazhdojmë!... (*Befas*)
Pa prishur punën, Kiço, a bezdisesh sikur herë pas here unë... të ulërij?

KIÇOJA — Të ulërish? Po pse?

ANDONI — Ç'ti bësh! E kemi mësuar. Që ai të hajë unë duhet të bëj si ujk.

KIÇOJA — Ju lutem, ju lutem. Kjo s'na pengon. Bëni si ujk.

ANDONI — Ta marrë djalli! Kur isha unë i vogël dhe më jepnin për të ngrënë s'kishte nevojë as për ulërima as për angullima (*Ulërin*) U u u u!

KIÇOJA — Ujku nuk bën ashtu. Ai bën a u u u u!

ANDONI — S'ka rëndësi. Mjafton të hajë. Mos ju bezdis?

ANDONI — Më falni: U u u u! Urdhëroni!

KIÇOJA — Aspak. Vazhdoni. Jua kuptoj hallin. Kam unë djalin tim...

KIÇOJA — Djali im, Tani, nuk ha fare po nuk pa të hanë edhe fëmijët e tjerë.

ANDONI — Po ju vetëm një keni.

KIÇOJA — Po, por në drekë tek ne kemi vazhdimisht dhe tre shokë të djalit... I ushqejmë dhe ata që të hajë Tani ynë. Harruat të ulërimi.

ANDONI — U u u u! (*I nevrikosur*) Po i gris të gjitha...

KIÇOJA — (*I zë dorën*) Mos u bëj i marrë. Fundja ne me këtë edukojmë prindërit e tjerë. A doni t'ju ndihmoj dhe unë?

ANDONI — Eee... kështu ai do të hante më shpejt.

KIÇOJA — Ju lutem, me gjithë qejf.

ANDONI — Po po. U u u u!

(Tani Andonin e shoqëron dhe Kiçoja.)

ANDONI — Shkruaj: Plotësimi i tekave nuk tregon aspak dashuri ndaj fëmijës, por... U u u u!... dobësi!... U u u u! Prindi në këtë pikë duhet të jetë shembull i papërkulur — U u u u u!... i ashpër — U u u u!... dinjitoz — U u u!

LETA — I dha fund pjatës. Kiçon e kërkojnë dy fëmijë. Hajdeni, çuna!

(Futen fëmijët.)

FËMIJA I — Xhaxhi Kiço, do vini të ushqeni Tanin se duam të hamë ne. Do të ikim në shkollë.

FANTAZI ME TEMË PROVIMESH...

Skeç

Personat:

LONI

VELOJA

LONI -- S'do të na ecë... Shkolla të gjitha i ka të mira. Të gjitha! Një gjë ka të keqe -- provimet!

VELOJA -- Aty ngec dhe unë. E di si do t'i kisha unë qejf provimet?

LONI -- Ç'më thua! E di se si i ëndërroj unë provimet?

VELOJA -- Prit... Unë më parë... Ja se si i ëndërroj unë... Një sallë të madhe, me lule...

Ëndrra e Velos

Një tryezë provimesh. Loni i veshur si profesor, me syze, shumë i ëmbël, është ulur e ka përpara tezat.

VELOJA -- (Tele porta.) Mirëdita!

LONI -- Mirëdita, Velo! Ku je, Velo? Si je?
(Ngrihet e merr në qafë e pastaj për

krahu e sjell tek tryeza. Po hë, erdhe të japësh provimin e historisë? Je përgatitur?

VELOJA — Si të them...

LONI — Pa dyshim, pa dyshim... Tërhiqe... tezën... Bukur! (*Pasi Veloja e tërheq tezën.*)
Të pëlqen?

VELOJA — Nuk më ecën... E dija... Pyetja më e vështirë!

LONI — Tërhiq një tjetër. (*Veloja tërheq.*) Po këtë tjetrën, hë?

VELOJA — Nuk më ecën, jo... Dhe kësaj i trembesh... Profesor, a t'ju propozoj diçka?

LONI — Hë, Velo...

VELOJA — Të tërheq një tjetër?

LONI — Propozim me vend.

VELOJA — Të mbetet hatri?

LONI — Aspak, zgjidh.

(*Loni, për të mos parë, ulet me takt nën tryezë, Veloja një nga një i zbulon të gjitha duke i lënë në vend.*)

VELOJA — Këtë jo!... Au!... Pu pu pu!... Hi-qu tutje!... Au! Këto të gjitha janë ka-tran! Më besoni, profesor, unë të gjitha i di përmendësh këto por...

LONI — S'ka gjë, Velo. Leri tezat... Fol ç'të duash.

VELOJA — Për mësimin e historisë apo dhe kështu çfarë të dua?

LONI — Ç'të duash, ç'të duash, po të këtë dhe pak histori brenda.

VELOJA — Historia është një nga shkencat shoqërore... Historia... Njëra nga shkencat shoqërore është edhe historia.

LONI — Mjaft, Velo. E qartë! Do të më fa-

lësh që s'do të të vë notë më të mirë
se dhjeta. Dhjetë! Më shumë s'mundem!
VELOJA — Të lutem, asgjë...

(Mbaron ëndrra.)

VELOJA — Po ku më gjen një profesor të ti-
llë, ku? S'ka. Padrejtësi.

LONI — S'ka, vëlla, s'ka! Padrejtësi... Provimi
është dramë me një akt. Me dy perso-
nazhe ballë për ballë... Kulminacion!...
Njëri i qetë. Tjetri dridhet... Njëri i ngo-
pur me gjumë, tjetri hiç... Njëri në ankth,
tjetri nuk e prish terezinë... Po s'është e
drejtë, more vëlla!... Pse të mos jetë dhe
ai në ankth?... Ja se si e ëndërroj unë
provimin... Unë të jem ulur më parë në
tryezë, i qetë...

Ëndrra e Lonit

*(Një tryezë provimesh. Aty është ulur,
Loni... Troket dera.)*

LONI — Hyni! *(Askush nuk hyn.)* Hyni, hyni
ju thashë! Pa frikë.

(Hapet dera, hyn Veloja.)

VELOJA — Me leje? Ju jeni Loni Faqekuqi?

LONI — Po.

VELOJA — Jam profesori i historisë... A ka
mundësi ta jepni provimin?

LONI — Si të them?... *(Mendueshëm)* Hajdeni,
hajdeni se po e jap.

(Veloja ulet nga ana tjetër e tryezës.)

LONI — Jeni përgatitur?

VELOJA — Si të them...

LONI — Mund të filloni...

VELOJA — Pah, sa i emocionuar që jam!

LONI — Mos u druani. Pse e merrni me frikë?

I kenë sjellë tezat?

VELOJA — Urdhëroni, zgjidhni!

LONI — (*Pasi tërheq.*) Teza numër dymbëdhjetë... Më ka rënë Pirroja i Epirit dhe Ali Pashë Tepelena. Më kontrolloni pa rezervë. Hajdeni, pse keni frikë?! (*I jep zemër duke i rënë miqësisht supeve.*) Flisni!

VELOJA — Po ja, për shembull, e dini që Pirroja ka jetuar në shekullin e tretë p.e.s.

LONI — Të them të drejtën, e di...

VELOJA — Pirroja krijoi shtetin e fuqishëm të Epirit apo jo?

LONI — Po.

VELOJA — Po atë fitoren e tij në Itali ku humbi shumë ushtarë dhe prej së cilës mbeti fjala «fitore si e Pirros» e dini?

LONI — S'do mend që e di! I di, i di të gjitha... Kaloni në pyetjen tjetër... Më kontrolloni pyetjen për Ali Pashën.

VELOJA — (*Konfidencial*) Po e ditët dhe këtë, dhjetën e keni të sigurt... Sa i emocionuar që jam! E dini që Aliu ishte i biri i Veliut?

LONI — Ç'janë këto pyetje kaq elementare!... Thellohuni, thellohuni.

VELOJA — E drejtë. (*Duke kapërcyer pështymën.*) Aliu formoi pashallëkun e Janinës?

LONI — Mos ju shkon mendja se nuk e di?!

VELOJA — Aspak. Ju lutem... U bë vezir dhe u nda nga sulltani... Këtë e dini?

LONI — Këtë e dinë dhe ata të kopshtit. Tjetër?

VELOJA — Tjetër?! Hm... ynë... hm... Por...

LONI — Shoku profesor, do të më pyesni apo jo? Thuajeni copë: dini të më kontrolloni apo jo? Shkurt: jeni përgatitur apo do ni të mendoheni?

VELOJA — Ju lutem, më lini të mendohem...
Edhe unë habitem... Tani asgjë s'më kujtohet... Sa i emocionuar që jam!

LONI — Ndodh, ndodh... I ka provimi këto...
Mirë, po ju le tre minuta kohë, të mendoheni se ç'pyetje do të më bëni...
(Loni shëtit me duart prapa. Veloja — profesori, rri i zhytur në mendime aty në tryezë. Befas gjen rast dhe shfleton librin.)

LONI — A pa pa!... S'më shpëtoni dot. Ju zura me libër të hapur. Ne kësaj i themi kopje.

VELOJA — Më fal, nuk e përsëris më!
(Mbaron ëndrra e Lonit.)

VELOJA — Kështu, do të ishte bukur..

NJË ZË — Loni, Velo, ju presin për provim!
(Djemtë shihen sy ndër sy.)

VELOJA — (I zgjat dorën me mirësjellje.) Urdhëro, Loni!

LONI — (Ia zgjat dhe ai dorën drejt sallës së provimit.) Të lutem, të lutem pas teje!

VELOJA — Djersa po më lag këmishën.

LONI — Mua po më del përmbi xhaketë.

NJË NGJARJE NË TREN

Skeç

Personat;

VALBONA — studente për mjekësi.

DRITA — studente për gjuhë të huaja

NDREKOJA — pasagjer.

Një vagon në stacion. Valbona dhe Drita kanë zënë vend në vagon. Zëri nga altoparlanti: treni për Tiranë gati për nisje!

DRITA — Po Yllka ku zuri vend? Të dal e të shoh.

VALBONA — Dil. (Befas) U u kush po vjen! Prit, Drita, se do të na vijë të na ulet këtu.

DRITA — Mos e ke fjalën për atë djalin me xhakëtë me kuadrate?

VALBONA — Dhe ti e njeh?

DRITA — (Duke imituar.) «Ju bezdis prania ime?».

VALBONA — «Ju shikoj shpesh që udhëtoni. Udhëtimet janë të bukura. Transport emocionesh. Transport njohjesh të rastit!».

(Qeshin)

DRITA — Duket i paska formula gjysmë të gatshme!

VALBONA — Një tip i shpifur që të bezdis me llafe. (Imiton duke qeshur.) «Pedagog i gjuhës frënge». E ke koleg.

DRITA — Jo, është mjek. Pra, kolege do t'i bëhesh ti.

VALBONA — Mjek?!

DRITA — Mua kështu më ka thënë.

VALBONA — (E vendosur.) Ky nuk është asgjë. Shet të trasha.

DRITA — E lezetshme! Mua që studioj për frëngjisht më është shitur si mjek!

VALBONA — Kurse mua, kur e mori vesh se studioj për mjekësi, m'u shit si pedagog i frëngjishtes.

DRITA — Po në të vërtetë ç'është?

VALBONA — Një parazit që ka ndërruar dyzet profesione.

DRITA — Po shkoj të shoh për Yllkën.

VALBONA — Prit një herë të zerë vend ai se mos na vjen këtu!

DRITA — Po erdhi i tregojmë sa i vlen lëkura.

VALBONA — Ohu! Po ike ti, ai me siguri do të më vijë këtu e do të më thotë: «Ju bezdis prania ime?»

DRITA — Mirë, mirë. Le të vijë po të dojë!

(Drita largohet duke qeshur. Nëpër korridorin e trenit çan Ndrekoja.)

NDREKOJA — (Majtas e djathtas.) Më lejoni... Më falni... Më falni... Më lejoni! (Sheh Valbonën vetëm dhe nxiton ecjen.) Më lejoni... (Valbonës.) Ju bezdis prania ime?

VALBONA — Aspak, uluni.

NDREKOJA — Si shkoni?

VALBONA — S'po shkojmë. Po rrimë në vend.

U tha: «Gati për nisje», por s'po nisët.

NDREKOJA — Ja, u nis. Jemi parë edhe një herë tjetër, apo jo?

VALBONA — Po, në mos gabohem ju jeni pedagog i gjuhës frënge?

NDREKUA — Urdhëro? Jo, unë... Ju nuk jeni studente për frëngjisht?

VALBONA — Jo.



NDREKOJA — Sa keq... Do të kishim biseduar frëngjisht deri në Tiranë... Francuskëmo... Ju studioni, për...

VALBONA — Për mjekësi...

NDREKOJA — Ekzaktëmo... Sa do ta thosha... Dhe s'kisha se si ta harroja... Atë ditë që udhëtuam së bashku.

VALBONA — Ishte natë...

NDREKOJA — Natë, natë... Më kujtohet shu-

më mirë, por unë them ditë, kështu, figurativishtëmo!... Nuk di, mos ma merrni për keq, por më dukej si ditë e plotë.

VALBONA — Jo, jo, ishte natë.

NDREKOJA — E di, e di... Për këdo ishte natë. Për mua ditë!... Bile një çast m'u duk se pashë diell...

VALBONA — Ku?

NDREKOJA — Në Rashbull... Kështu e ka udhëtimi: transport emocionësh, transport njohjesh të rastit. «Zhave zhur tur dy fua, pur l'amur nu purkua! — thotë Zhan Mareja.

VALBONA — E ç'do të thotë shqip kjo shprehje?

NDREKOJA — Shqip? Shqip do të thotë... E ku përkthehet shqip kjo shprehje e mrekullueshme! Formidablo! Kanë plot të tilla ata... Ose për shembull ajo e famshmja: «Zhakë petitë lukumua, roshëfor e darta-njan!»! Eksepsion!

VALBONA — As kjo s'përkthehet?

NDREKOJA — Bah! Janë mbledhur tërë shkençetarët e botës e s'e përkthejnë dot!

VALBONA — Po ju pse i mësoni këto?

NDREKOJA — Thjesht për kulturë... Po më mirë flasim për profesionin tuaj. Si e shpjegoni ju një dhembje që më ze në gjoks sa herë ndiej që koha ikën shpejt si vetëtimë e unë dua që të mos lëviz nga vendi ku jam ulur... Ja, për shembull, si tani.

VALBONA — Ju dhemb?

NDREKOJA — Më filloi.

VALBONA — E ku ju dhemb?

NDREKOJA — Këtu. (Vë dorën në gjoks.)

VALBONA — Ku me saktësi?

NDREKOJA — Si t'ju them? Në jugë të supit
e në veriperëndim të stomakut...

VALBONA — Duhet ta keni nervore... Ose të
trashëguar.

NDREKOJA — Të trashëguar... *(Pak si me ve-*
te.) Të trashëguar! Ju nuk jeni e fejuar?

VALBONA — Jo, ju thashë që herën e parë
që u pamë.

NDREKOJA — E di, e di, por sepse kam qejf
të ma përsërisni... D.m.th. jemi bashkë
deri në Tiranë.

VALBONA — Po.

NDREKOJA — Do të desha të shkonim edhe
më tej.

VALBONA — Mirë do të ishte, por deri aty
i venë shinat.

(Vjen Drita.)

DRITA — Mund të ulem?

NDREKOJA — Urdhëroni, ju lutem... megjithë-
se... Urdhëroni! *(I bën vend.)*

*Tani Ndrekoja ndodhet në mes të dy
vujzave.)*

DRITA — Si jeni?

NDREKOJA — Mirë.

DRITA — Ju kujtohet...

NDREKOJA — Po si... Ju studioni për...

DRITA — Për frëngjisht.

NDREKOJA — *(Nxiton.)* Aa... shumë ngadalë
ecin këta trenat...

DRITA — Megjithatë të ecësh në tren është
gjë e bukur... Atë ditë, pasi udhëtuam
bashkë po u tregoja shoqeve: «Sot, u tha-
shë, kam bërë një udhëtim të këndshëm
me një mjek...»

NDREKOJA — *(Nxiton të mos dëgjojë Valbona.)*

Aaa, në Sukth ndalon ky tren?

DRITA — Do të zbrisni?

NDREKOJA — *(Vetëm Dritës.)* Po kam një pa-
cient aty... E kam operuar.

VALBONA — *(Që deri tani sheh nga dritarja.)*
Si? Do të zbrisni?

NDREKOJA — *(Vetëm Valbonës.)* Kam një nxë-
nës aty... Do t'i kontrolloj foljen «me
genë».

VALBONA — Po ju thatë...

NDREKOJA — Tani m'u kujtua.

VALBONA — A: e keni më atë dhimbjen në
gjoks?

NDREKOJA — Jo, më iku...

VALBONA — Nga ju iku, në lindje apo në pe-
rëndim.

NDREKOJA — Në veri. *(Vë dorën në ballë.)* Këtu.

DRITA — Në kokë e keni operuar?

NDREKOJA — *(Nxiton t'ia mbulojë fjalën.)* Po...
po... po... Pse nuk i ndezin ventilatorët
këtu?

VALBONA — Jam kurioze, si i thonë frëngjisht
«Të dolën lakrat sheshit».

NDREKOJA — Sheshit?!

VALBONA — Në frëngjisht.

NDREKOJA — *(Nxiton.)* Nuk e di... *(Këndon.)*
«Oo bubullin o ke shkëmbi...».

DRITA — *(Valbonës.)* Ju, për Tiranë?

NDREKOJA — *(Që s'do t'i lërë të merren vesh.)*
«O se vrave beun...».

VALBONA — Po.

DRITA — Dhe unë. Studente?!

NDREKOJA — «O ti, mor djalo...»
*(Kur e sheh që ato do të merren vesh, ai
largohet me nxitim pa përshëndetur. Vaj-
zat bashkohen duke qeshur dhe flasin që
pas.)*

DRITA — Shoku doktor!... Shoku doktor!

VALBONA — Shoku profesor!... Shoku profesor!

KATËR SY TË MBYLLUR DREJT GJENDJES CIVILE

Parodi dashurie

Historia e Sokolit është për të qeshur e për të qarë. Është për të qeshur se në këtë gabim nuk është Sokoli që bie i pari. Është për të qarë se të tilla gjëra nuk duhet të ndodhin...

Nuk duhet të ndodhin këto gjëra që bashkojnë në një unitet qesharak operetën dhe dramën klasike...

Sokoli ra në dashuri. Ra në dashuri jo me shikimin e parë, por pa e parë fare! E ndjeu. E ndjeu se diku pranë ishte ajo që do t'i bëhej gruaja e ardhshme...

Pastaj e pa... Ajo shëtiste me shoqet buzë detit. E ndali. I propozoi. Ajo nuk pranoi. Ia përsëriti propozimin. Vajza u lëkund. Djali i deklaroi se po të mos pranonte të lidheshin, ai do të mbytej në det!

Ajo nuk e la të mbytej.

U lidhën. Cila ishte, e kujt ishte, sa ishte, si ishte, ç'kishte e ku kishte — nuk kishin rën-

dësi! Vogëlsira banale. Dashuria qëndron mbi këto vogëlsira. Kjo ishte një dashuri klasike dhe për Gonxhen e tij Sokolit i vinin në buzë dhjetëra melodi klasike:

Kur më vjen Gonxhja përballë, kur
më vjen,
më vijn' pallatet vërdallë, frymëzi-
mi më rrëmben.

Kur më zë Gonxhja për dorë, kur
më zë,
puf-puf nis më rreh, zemra, puf-
puf-puf nis më rreh.

Ulemi bashk, në lëndinë, m'ethë
rreth veç trëndëlinë,
eh eh eh, lum si ne!

Kur e pyes për farefisën, për babanë për
shtëpinë,
nuk kuptoj as dhe një fjalë, veç shijoj
melodinë.

Kur e pyes lexon libra thotë jo nuk ka
kohë,
s'lexon po mendon për mua, sa më do,
o bobo.

Si të bëka dashuria, herë luan e herë buf,
ja martohem, ja martohem, ja bëj puf!

Dhe u martua Sokoli me Gonxhen... «Vdes për ty — vdes për mua. S'ka forcë që na ndan» e pllaq e plluq, e dëngër e mëngër. Meqë s'kishin ç'të bënin filluan ta njihnin njëri-tjetrin..

Tani po, kishin kohë të njiheshin. Ishte një njohje gazmore. Pakënaqësitë nuk zgjatnin. Akull nuk bëhej se nuk e linte dielli i dashurisë.

Një ditë Sokoli vuri re se Gonxhja, një-
rën bebëzë e kishte më të bardhë se tjetrën! E
ku ta vinte re më parë?! Ai i mbyllte sytë kur
e përqafonte...

Kurse Gonxhja kishte filluar të ndiente
se, kur vinte era nga deti dhe Sokoli gjendej
në mes, hundën e saj e godiste një aromë fër-
nti. Nuk e pat ndier më parë. E ku të linte era
e trëndelinës!

Gonxhja ka qejf të ndjekë në televizor
përrallat e fëmijëve:

Sokoli nuk shkon kurrë të psonisë!

Gonxhja nuk di të qepë një pullë në kë-
mishë. Ta qep bashkë me kanatieren. Uh!

Sokoli flet në gjumë. Puh!

Gonxhes i ngallosen dhëmbët nga i kuqi
i buzëve dhe nuk di të bëjë byrek.

Sokoli vonohet me shokë dhe prish gjys-
mën e rrogës.

Gonxhja rri net të tëra nga e ëma. Po o
zgjati do ta ndaj.

Puna është sa të të vijë ndarja në men-
dje pastaj mendja punon vetë: Ndarje — ndarje
— ndarje!

Asnjëri nga të dy nuk e kupton se keq-
kuptimet e vogla në shtëpi duhen kapërcyer dhe
se bashkëshortët duhet të respektojnë njëri-tje-
trin e të mos shohin veç qejfet e tyre.

Jo jo... Tani Sokoli për Gonxhen nuk
është më sokol, po buf! Gonxhja për të shoqin
s'është më gonxhe, po një lule e vyshkur.

Mallkuar qoftë dita që dolën buzë detit
e u njohën! Tani duan të shohin me sy pell-
ge. I urrejnë dhe detet dhe liqenet!

Tani kënga e dikurshme në buzët e Sokol-
lit nuk ka më melodi, nuk ka më mjaltë:

Kur më vjen Gonxhja përballë.
kur më vjen,
më vijnë pallatet vërdallë, më
përzjen, më përzjen.

Kur vjen e më thot' mirëmbërëma,
kur më vjen, përhëndet,
duket plakë si e ëma, pa lezet, pa
lezet.

Kur më hedh dorën në qafë
trembem mos bëj ndonjë gafë,
nuk e zgjas më këtë punë, unë jam
burrë e nuk jam buf!

Ja do ndahem, ja do ndahem, ja
bëj puf! Puf!

Shumë nga ju duan të dinë se si mori
fund kjo histori... Mua më duket se historia e
vërtetë mbaroi... Se për të pajtuar Gonxhen e
Sokolin u futën në valle familjet e shoqëria por
në fund të fundit ç'rëndësi ka kjo?!

U, bë ç'u bë — kurrë mos u bëftë më!



KUJT I BËRTISNI JU?!

Skeç

Personat:

KLIENTI

SHITËSJA

PËRGJEGJËSI

Në një dyqan ushqimor. Shohim një burrë të përkulur në dysheme që po mbledh ushqimet që sapo i kanë shpëtuar nga dora. Shitësja del nga banaku dhe shkon t'i ndihmojë duke e sharë e duke i bërtitur.

SHITËSJA — Ku e ke mendjen! Yh, i humbur! *(Hyn përgjegjësi dhe që nga dera i shikon dhe i dëgjon të gjitha.)*

KLIENTI — As unë nuk e kuptova se si më ranë... Më qenka keputur doreza e zimbilit.

SHITËSJA — Shiko, ia vuri fajin zimbilit tani! Pse nuk thua drejt që je i hutuar, i hutuar si buf.

KLIENTI — Jo, moj, ç'thua... Ua, qenka derdhur edhe vaji! Paska plasur shishja!

SHITËSJA — Le po tani duhet të laj dhe fun-

din e dyqanit! Yh, i lënë... Hajde, luaji duart. Duartharë!

PËRGJEGJËSI — (Që mezi e ka mbajtur veten, bërtet me të gjithë forcën.) Mjaft! Mjaft! (Klienti dhe shitësja kthehen nga ai. Shitësja ngrihet në këmbë e turbulluar.)

SHITËSJA — Shoku përgjegjës! Urdhëroni!... Unë...

PËRGJEGJËSI — Nuk ka nevojë të më ftoni. Unë kam ardhur me kohë. Dhe i dëgjova të gjitha. Të kini turp! Kujt i bërtisni ashtu, ëh?

SHITËSJA — Të më kuptoni, ky shoku...

PËRGJEGJËSI — Aaa!... U kujtuat më së fundi t'i thonë shok tani? Çfarë nuk i thatë: duartharë, buf, i humbur! (Klienti, që rri akoma i hutuar përmbi ushqimet e derdhura.) Më falni që po i përsëris! (Shitëses) Kujt i bërtisni ju? Klientit?! Sa herë ju kemi mbledhur e ju kemi porositur që me klientët të silleni mirë... T'i prisni mirë e t'i përcillni si duhet...

SHITËSJA — Unë gjithmonë mirë, i kam përcjellë, por duhet t'ju them se ky...

PËRGJEGJËSI — Kjo e sotmja i kalon të gjithë kufijtë! Nesër që në mëngjes të vish tek unë në zyrë. Atje do ta shohim mirë punën tuaj.

SHITËSJA — Shoku përgjegjës...

PËRGJEGJËSI — Asnjë fjalë! Kështu të lini përshtypjen se klientët i prisni me buzëqeshje, kurse në realitet çfarë ndodh? I humbur! Duartharë! Buf! (Klientit) Më falni që po i përsëris. (Shitëses) Turp të keni!

SHITËSJA — Më falni t'ju them... Ky është burri im.

PËRGJEGJËSI — (I hutuar.) Burri?!

KLIENTI — E burri... Tani t'ju pyes unë: kujt i bërtisni ashtu ju?

PËRGJEGJËSI — Nuk kuptoj.

KLIENTI — Çfarë nuk kupton, more?! M'u përgjigj këtu: me ç'të drejtë i bërtet asaj?! Oj, i bërtet tjetrës sikur... Ka burrë ajo! Ka kush i del zot!

PËRGJEGJËSI — *(I hutuar)* Ju i dëlmi për zot asaj. Po ajo ju bërtiti e ju quajti...

KLIENTI — Po le të më bërtasë. Më ka, burrë!

PËRGJEGJËSI — O po le të të bërtasë, meqë ke qejf, po këtu unë të kam klient e do të të marr në mbrojtje.

KLIENTI — Unë nuk dua të më marrësh në mbrojtje.

PËRGJEGJËSI — E po unë do të të mbroj.

KLIENTI — Po nuk dua unë.

SHITËSJA — Spiro!

KLIENTI — Rri, moj, ti! Më quaj si të duash. Të kam thënë gjë unë... Por në sy tim të m'i bërtasë ai gruas. Nuk duroj... Kam dinjitet unë.

PËRGJEGJËSI — Dinjitet? Or shok, këtu në dyqan unë nuk dua të dëgjoj fjalë të ashpra. Unë të marr në mbrojtje.

KLIENTI — Më hëngri me këtë mbrojtje ky! Nuk dua mbrojtje!

PËRGJEGJËSI — Kurrë mos e daç! Dhe ja ku të jap fjalën për këtë rast nuk do të marr asnjë masë! Dëgjove! Asnjë masë! Natën e mirë!

(Përgjegjësi largohet.)

KLIENTI — Tuaf njeri! Vjen e fut hundët në punët e tjetrit. Dësh na futi grindje në familje!

NË MATARNITET NATËN E VITIT TË RI

Skeç

Personat:

BESNIKU

PERTEFI

NJË PUNONJËSE e maternitetit.

Materniteti ka dhe ai petkun e festës së Vitit të Ri. Besniku po flet në telefon, kurse Pertefi shëtit i shqetësuar.

BESNIKU — Mama... Po mos u shqetëso, moj mama, sapo të lindë do të të njoftoj ty të parën... Ti do që Viti i Ri të të gjejë me mbesë?... Po nuk e kam në dorë unë. Mirë, do të interesohem...

(Sirena e një autoambulance.)

PERTEFI — Sollën dhe një grua tjetër.

BESNIKU — *(Në telefon)* Gëzuar!.. Po ja që mua më takoi ta kaloj festën në sallonin e pritjes së maternitetit... Mirë! *(Mbyll telefonin.)* Thotë që në çantë më ka vënë të gjitha mjetet, instrumentet dhe lëndën e parë për ta festuar. *(Merr çantën.)*

PERTEFI — (Duke sjellë edhe ai një çantë në tyrezë.) Pikë për pikë si nëna ime.

(Duke hapur çantat.)

BESNIKU — Ç'punë bëni?

PERTEFI — Shef llogarie... Kontabël... Po ju?

BESNIKU — Tornitor... Ju nuk duhet ta keni të parin?

PERTEFI — Gaboheni... E kam të parin... Jam martuar pak vonë... Jemi pak vonë dhe për fëmijën.

BESNIKU — Pse kështu?

PERTEFI — Punë... Bilance... Inkuadrime... Ju, të parin?...

BESNIKU — Të parën, se unë e dua vajzë... Për mua të lindë çfarë të dojë... Vajzë e e pret māmaja ime. Në fisin tonë kemi shumë meshkuj.

PERTEFI — Uroj me gjithë zemër t'ju lindë vajzë... Unë e dua djalë... Përndryshe s'di ku të futem nga māmaja... Është pak e mosshuar.

(Nxjerrin nga një gotë e shishe, kukulla e fiqfiqe. Besniku nxjerr dhe një pemë të vogël.)

PERTEFI — Gëzuar!... Më ka hyrë frika.

BESNIKU — Pse?

PERTEFI — Sot më datën 31 në këtë maternitet kanë lindur 14 djem... E kuptoni: të gjithë djem!

BESNIKU — Po aq më mirë për ju. Qenka ditë djemsh.

PERTEFI — Kështu mund të flasin njerëzit me bestytini, kurse ne të llogarisë e dimë që natyra ka vënë ekuilibër... (Konspirativ) Pra, tani mundësia më e madhe është që

të fillojë seria e vajzave... Ky maternitet
e ka tejkaluar planin e djemve.

(Telefoni)

BESNIKU — (Në telefon.) Jo, moj mama, ako-
ma... Do të të mar unë... (Merr gotën.)
Gëzuar! (Mbyll telefonin.) Nuk i durohet.

(Shëtitje)

BESNIKU — Thonë se fëmijët e parë dalin më
të zgjuarit.

PERTEFI — Ju lutem, nuk ua kam borxh të
më ofendoni.

BESNIKU — Pse?

PERTEFI — Sepse unë jam fëmija i shtatë.

BESNIKU — Prisni... Në fakt shkenca thotë që
ky mendim është kryekëput i gabuar. Më
të zgjuar janë fëmijët e fundit.

PERTEFI — Përsëri po më ofendoni. Pas meje
babai ka lidur edhe pesë të tjerë.

(Hyn një punonjëse e veshur në të bardha)

PUNONJËSJA — Pa shiko, ju këtu paski festë
të vërtetë.

BESNIKU — Ngrejeni një gotë me ne.

PUNONJËSJA — Gotë jo... Por vetëm mund ta
trokas...

(Trokasin gotat.)

PUNONJËSJA — Gratë i dërguam në sallë... Mos
u shqetësoni... Keni frikë!

BESNIKU — Aspak, pse?!

PUNONJËSJA — (Perteftit) Po, ju?

PERTEFI — As unë... Jam tip që kam të dri-
dhura.

PUNONJËSJA — Po këtu është ngrohtë.

PERTEFI — Unë jam tip që dridhem dhe në të ngrohtë.

PUNONJËSJA — Unë po shkoj në sallë. (Del)

(Telefoni)

PERTEFI — Po të thërret mamaja... Hajd, mor burrë, thuaj që lindi e ta flerë mendjen... Merre telefonin... (Imiton piskamën e foshnjës.)

BESNIKU — (Në telefon) Mama, qetësohu, lindi. (Befas mbyll gojëzën) Na ngatërrove... Pyet vajzë apo djalë?

PERTEFI — (Merr telefonin) Nuk janë bërë akoma formalitetet, mama... Shkurt nuk është vendosur akoma.

BESNIKU — (Merr telefonin) Një keqkuptim, mama, një keqkuptim. (Mbyll telefonin)

PERTEFI — (Sheh orën.) Mendoja me frikë se nuk është hiç e favorshme të lindësh natën e Vitit të Ri.

BESNIKU — Përkundrazi... Bukur... Të gjithë festojnë dhe duket sikur festojnë ditëlindjen tënde. Gruaja ime vetë ka lindur natën e Vitit të Ri.

PERTEFI — Ashtu. Keni të drejtë se çdo gjë vete mbarë... Llogari të sakta, muaj të plotë për efekt moshe, shkollë, leje etj.

BESNIKU — Po atëherë?

PERTEFI — Unë i trembësja personelit të shërbimit. Ja, thosha, mund të kenë zilinë e atyre që festojnë, kurse vetë u ka takuar të punojnë... Kurse tani që i shoh sa të qeshura janë, kam besim se çdo gjë shkon bukuri.

BESNIKU — Po s'do mend... Se puna e tyre është fisnike... dhe ato e ndiejnë... Ja, ju thatë se sot lindën 14 djem... Janë 14 ushtarët e parë të Republikës për këtë vit. A s'ju gëzon kjo?

PERTEFI — Të gjithë këta ushtarë më gëzojnë por edhe unë dua të kem ushtarin tim... Kurse... ti do vajzë.

BESNIKU — Dhe vajzat janë ushtarë... E di, unë vajzës ia kam gjetur edhe emrin: Krenare. Më duket një emër i kohës.

PERTEFI — Kurse mua më duket se po dëgjoj një të qarë bebeje.

(Zëri i një punonjëseje: «Kujdes vajzën!»)

PERTEFI — Kujdes vajzën — tha. Urime i dashur!

(Hyn punonjësja.)

PUNONJËSJA — *(Pertesit)* Urime, shok. Vajzë!

PERTEFI — Mua vajzë?! Jeni e sigurt?

PUNONJËSJA — Po dhe gruan e keni mirë.

PERTEFI — Mos po më ngatërroni gjë me këtë shokun!

PUNONJËSJA — Jo!

PERTEFI — E dija. 14 djem! Ekuilibri. Po këtij?

PUNONJËSJA — Kurse ju, shok... ju lindën dy vajza topolake. Urime!

BESNIKU — Urra! Ju falem nderit! *(I sulet telefonit.)* Po marrë mamane.

PERTEFI — Merr edhe babanë se ka për të dy.

BESNIKU — *(I qeshur)* Po ti, shok, s'po ikën?

PERTEFI — Ku të shkoj pa ty... Nënë time vetëm ti mund ta ngushëllosh dhe bile ta

gëzosh se flet bukur për ushtaret, për Republikën dhe ke të drejtë... Unë për vete do t'i them që djemtë u ndanë që në mëngjes e kush është në festë dhe e çon gruan tani, vajzë ka... Ha, ha!...

BESNIKÛ — Më prit se po vij. (Në telefon.) Ma, ma, e tejkaluam... Dy ushtare... Gëzuar Vitin e Ri bashkë me to!

PORTRETE PA MAKIAZH


Fantazia e një burokrati

Një zyrë. Një derë e mbyllur ku lexohet me germa të mëdha: «Ndalohet rreptësisht hyrja jashtë orarit të pritjes. Orari i pritjes: 12³⁰ — 1400». Dera hapet vetvetiu dhe shfaqet interieri i zyrës. Nëpunësi është i thelluar në leximin e revistës «Shkenca dhe jeta.»

NËPUNËSI — (Duke u shkëputur nga leximi)

Interesant! Këtu thuhet se në polin e Veriut nata vazhdon gjatë muaj. Pastaj vjen

dita tjetër. (Duke psherëtirë.) Atje ta kisha zyrën. Të ka lezet shpirti t'i thuash tjetrit: «Eja nesër!»



Në dyqanin «Gjysmë të gatshme»

SHITËSJA — Banakët i kemi plot me asortimentet gjysmë të gatshme.

BLERËSI — Këtu keni gjëra ose aspak të gatshme ose të gatshme fare.

SHITËSJA — Pa hë, ju lutem!

BLERËSI — Biftekët, për shembull, kanë gjithë atë punë për t'u përgatitur... Ku e keni ju gjysmën e punës?

SHITËSJA — Po therja e viçit, rrjepja, copëtimi?!



BLERËSI — Kurse djathi është gati. Vezët gati... S'të mbetet veç t'i hash.

SHITËSJA — Sepse keni qejf t'i bini shkurt!.. Me vezët ju mund të bëni supë pule.

BLERËSI — (E korrigjon.) Supë me vezë!

SHITËSJA — Supë pule po them! Vezët mund t'i vini të ngrohen. Të dalin zogj. Të rriten...

BLERËSI — Ohu! Më kënaqët!

SHITËSJA — Pse, ç'dashkeni ju? Gati fare? Ne, i kemi gjysmë të gatshme!

Djali, babi, mami

BABI — M'u duk sikur u zgjua djali.

MAMI — (Pasi vë vesh.) Jo, po fle. Ju bëftë mami! E kam mbuluar mirë. Shyqyr, filloi të flasë. E dëgjove sot në mëngjes? Sa lezet i kishte kur tha «mama».

BABI — I kishte lezet, por ama tha «baba».

MAMI — «Mama»!

BABI — «Baba»! Vetë ndërtimi i fjalës «baba» është më i lehtë.

Ba-ba!

MAMI — Fjala e parë që mëson çdo fëmijë është «mama»!

BABI — S'është e vërtetë! Fjala e parë që kam thënë unë, për shembull, është «marmelatë»!

MAMI — Ti bën përjashtim!

BABI — Dhe djali ynë bën përjashtim. Thua «baba». Pikë. Diskutimet mbyllen.

ZËRI I BEBIT — (Që tej.) Babá! (Qan.) Ba-ba!

BABI — (Që përton të ngrihet.) Hë, moj, tundu! «Mama» po thërret. Nuk dëgjon?! Tundu!

Shfrytëzimi i lejes krijuese

LEXUESI — Shoku dramaturg, si shkon leja krijuese?

DRAMATURGU — Shumë mirë!

LEXUESI — Po punë? Keni marrë leje krijuese dhe keni premtuar një dramë me tre akte.

DRAMATURGU — Ah po, kam filluar nga puna.

LEXUESI — Dhe deri tani ç'keni shkruar?

DRAMATURGU — Pushimet midis akteve dhe më kanë dalë shumë emocionante.

Kur hyjnë në fuqi cigaret

SHITËSJA — Një nga këto pasta kushton tetëdhjetë qindarka. Urdhëroni pastën. Meqë s'kam të vogla, urdhëroni si kusur dy cigare.

KLIENTI — Mos m'i jepni. (Duke nxjerrë paketën.) Ja dhe gjashtë cigare të tjera dhe më jepni edhe një pastë tjetër...

Vjehrra mungon

Përpara derës së një apartamenti, një nuse e re me një pjatë. Aty ka një pako gjalpë dhe dy kokrra vezë. Nusja i bie ziles. Derën e hap një burrë që është duke u përtypur.

KOMSHIU — Urdhëroni, komshie!

NUSJA — Është aty jot shoqe, Vjollca?

KOMSHIU — (I qeshur.) Mos na i keni marrë hua këto dy vezë?

NUSJA — Jo... Po dua të ha drekën edhe unë.. A mund të m'i skuqë pak Vjollca? Nuk ju kemi bezdisur kurrë, por sot ime vjehërr u nis për në llixha...

Orari dhe bifteku

Sporteli i një kuzhine restoranti. Në sportel kuzhinierja. Para sportelit përgjegjësi. Vjen kamerieri.



KAMARIERI — I çova biftekun atij klientit atje... Ka gjysmë ore me thikë, gësh-gësh-gësh, e nuk e pret dot. Gjysmë ore nuk ka prerë akoma një copë.

PËRGJEGJËSI — I thuaq që në ora dhjetë, fiks lokali mbyllet.

Burri i lagur

*Interieri i një apartamenti. Korridori.
Gruaja hap portën. Hyn burri shumë i lagur.*

GRUAJA — Je lagur? Po çadrën?

BURRI — E humba.

GRUAJA — Përsëri?

BURRI — Përsëri... Dhe e di kur u kujtova që
më kishte humbur?

GRUAJA — S'do mend. Kur zuri shiu.

BURRI — Jo! Kur pushoi... Pashë të tjerët që
po i mbyllnin çadrat, dështa ta mbyll dhe
unë. S'e kisha!

Dirigjentin e njohin të gjithë

Sporteli i hotelit.

SPORTELISTI — (Në telefon.) Hotel Turizmi je-
ni mirë. Të gjitha të zëna. Veç një dhomë po
është e ruajmë për dirigjentin Aleks, që pre-
sim të vijë i ftuar nga orkestra simfoni-
ke e qytetit tonë.

(U telefonin e diç shkruan Sportelit i
afrohet Aleks.)

ALEKSI — Mirëdita! A keni ndonjë vend?

SPORTELISTI — Asnjë për fat të keq. Shkoni
në hotele të tjera.

ALEKSI — Desha këtu... Po nejtë... Ditën e
mirë!

(Bën të largohet.)

SPORTELISTI — Ditën e mirë! (Befas) Shok!
Shok! Ju jeni shoku Aleks, apo jo?

ALEKSI — Po. Më njihni?

SPORTELISTI — Ju njoh shumë mirë. Ju lu-

tem, ejani t'ju regjistroj! Ju është rezervuar dhoma që para pesë ditësh.

ALEKSI — *(I jep letërnjoftimin.)* Mirë që më njohë.

SPORTELISTI — Ju njoh shumë mirë. I ndjek vazhdimisht koncertet tuaja. Në televizor dhe në skenë. Ju njoh shumë mirë.

ALEKSI — *(Duke qeshur.)* Po pse më thatë «jo» në fillim?!

SPORTELISTI — Ishit me fytyrë nga unë... Kur u kthyet me kurriz ju pashë dhe ju njoha... Ju dirigjentët njiheni menjëherë... nga kurrizil!

Detyra e afishes

Në llozhën e teatrit. Autori i komedisë me gjithë të shoqen po shohin premierën.

GRUAJA — Nuk e kuptoj. Fundi i aktit të dytë e nuk po dëgjoj të qeshë asnjëri me komedinë tënde!

AUTORI — *(Duke mbajtur zemërimin.)* Ah, i humburi, piktori, ka harruar të shënojë në afishe se kjo është komedi. Edhe e porosita!

KARTOLINAT PËR VITIN E RI

Kartolina e një formalisti

Në mbështetje të kartolinës suaj datë njëzet e shtatë i dymbëdhjeti, dërguar prej jush në adresën tonë, ju kthejmë përgjigjen si vijon:

— Urimet që ne të kemi suksese në punë, gëzime dhe lumturi në familje i morëm. Po nuk u realizuan, e tërë përgjegjësia bie mbi ju!...

Kartolina e një snobi

Shoqja Bubushe! Me satisfaksion spiritual të jashtëzakonshëm ju dërgoj urimet optimale për Vitin e Ri.

Insinuatat që familja ime i ka bërë tëndes, në lidhje me probabilitetin e një kombinacioni martesor midis meje dhe teje janë elokumente dhe evidente, që ta themi popullorçe: intrashendente pa precedent!

Kjo e obligon familjen tënde me responsabilitet. Ajo me siguri do të përfitojë nga ky okazion dhe do të japë pëlqimin që ne të martohemi

ose ta themi troç shqip: do prononcohet afirmativisht për unifikimin tonë shumë të aspiruar!

Me respekte superlative — Dulla

Kartolina e një individualisti

Merr: Çeço Faslli Karafili — Rruga Dodona, numër një.

Dërgon: Çeço Faslli Karafili — Rruga Dodona, numër një.

Të uroj, o miku im më i dashur e më i shtrenjtë, o më i talentuari i të talentuarëve, o më i afti i të aftëve!

Ty dhe vetëm ty — jo të ngjitesh në majat më të larta të diturisë, shkencës dhe kulturës masive, se ti atje je ngjitur dhe maja më të larta s'ka, por — u ngjitsh përpjetë me gjithë maja! Ti dhe vetëm ti! Shëndet, Çeço! Gëzuar Vitin e Ri! Shpirt!

Kartolina e një shpifësi

Të uroj! Veç... po të them një gjë që, të lutem shumë, mos e bëj për fjalë: kam marrë vesh nga burime të sigurta që Viti i Ri këtë radhë vjen më datën dy janar! Veç — qepe!

Kartolina e një mëndjemadhi

Mos ma merr për mburrje, po më dërgojnë kaq shumë kartolina, sa nuk kam mundësi t'u përgjigjem. Prandaj nuk i uroj dot miqtë e mi vit për vit. Me një kartolinë uroj shumë vite ba-

shkë. Njërin e kam uruar deri në Vitin e Ri 2000!
Po ty të kam nga miqtë e mi më të afërt.
Urime për vitet e rinj të periudhës 1980-
-1990!

Kartolina e një prepotenti

Ç'janë more këto lloj urimesh: të uroj, të
uroj?! **TË URDHËROJ: GËZUAR VITIN E RI!**

NJË GRUA ME SHËRBIM

Skeç

Personat:

PASHOJA
DULJA
SHPRESA

Një sportel hoteli. Pashoja pret klientët duke kënduar një këngë gazmore. Hyn Dulja.

DULJA — Njatjeta. Pasho! Qenke rehat nga klientët sot. Ja ke marrë këngës.

PASHOJA — Ç'të bësh, o Dule... Po ti s'je në punë sot?

DULJA — Kam pushimet javore.

(Bie zilja e telefonit.)

PASHOJA — Hotel «Luleshqerra» jam... Po ju keni klientë? More, si shumë qetësi sot... Këtë po më thotë dhe Dulja, se e kam këtu.. Si, si the? Të erdhi një kliente dhe ma nise mua?... Demek, hiq belë nga unë i the ti... Mos u bëj merak se ta postoj prapë. Ju të hotel «Shkëmbit» kështu e bëni

gjithnjë. (Mbyll telefonin me inat dhe shikohet sy ndër sy, pa folur me Dulen.)

DULJA — Ja, po të vjen, o Pasho...

(Në sportel paraqitet Shpresa, një grua e re, me një çantë e me një triko në dorë.)

SHPRESA — Më falni, a keni vende?

(Pashoja dhe Dulja ia ngulin sytë dhe pa u nxituar e matin dhe e psikologjisin mirë.)

PASHOJA — Vetëm je?

SHPRESA — Vetëm.

(Pauzë)

PASHOJA — Nga vjen ti, moj shoqe?

SHPRESA — Nga Tirana.

PASHOJA — E pse ke ardhur?

SHPRESA — Me shërbim.

PASHOJA — Me shërbim! Po pse, u mbaruan burrat andej nga Tirana që të dërguan ty me shërbim?

SHPRESA — E, kështu e do puna.

PASHOJA — (Shihet sy ndër sy me Dulen.) E do puna. Po nuk ke njerëz të afërm këtu ti?

SHPRESA — Kam një kushëri të tretë të nënës, po nuk dua ta bezdis.

PASHOJA — Nuk do ta bezdisësh...

DULJA — (Mënjandë, Pashos) Prit t'i bëj unë një pyetje me marifet, (Shpresës) Po njerëz të tjerë nuk ke? Nga të burrit, për shembull!

SHPRESA — Jam e pamartuar.

PASHOJA — Qenka e pamartuar! Nuk kam vend, moj shoqe. Shiko një herë nëpër hotelet e tjera.

SHPRESA — Më falni, po ç'ishte nevoja për gjithë ato pyetje?

PASHOJA — T'u prish ndonjë punë? Sos harxhove dietat!

SHPRESA — Më humbët kohën.

PASHOJA — Keq më vjen, por e kam për detyrë të pyes. Këtë detyrë më ka vënë shoqëria mua. *(E mbyll sportelin.)*

(Shpresa largohet disi e mërzhitur.)

PASHOJA — Edhe këta të Tiranës nuk dinë ç'bëjnë, o Dule!

DULJA — Nuk dinë, nuk dinë...

PASHOJA — Po niset një vajzë e re me shërbim në qytet të huaj, ë? Sos ishte ndonjë e shëmtuar...

DULJA — Një klient.

(Vjen një klient.)

KLIENTI — Kini vende?

PASHOJA — Letërnjoftimin!

(Ia merr, e regjistron pa fjalë, i merr paratë dhe i jep çelësin. Klienti ngjitet në dhomë.)

PASHOJA — Je drejtor... Ke për të dërguar femër me shërbim?

DULJA — Me marifet dërgo dhe dy të tjera... Të venë të tria bashkë.

PASHOJA — Posi... ruajnë njëra-tjetrën ato pastaj... Më vijnë mua, u jap një dhomë treshe.

DULJA — Treshe, treshe... Edhe e fle mendjen...

PASHOJA — Kam dhoma njëshe, or vëlla, kam, po gra në to nuk fus unë...

DULJA — As unë...

PASHOJA — Pse, mos do rri të ruaj te dera e tyre gjithë natën unë...

(Kthehet klienti dhe hedh çelësin në sportel.)

- PASHOJA — Mirë, vëlla... Ah, po kemi punë të vështirë, or Dule vëllai.
- DULJA — Atë thuaj... Përgjegjësi e madhe...
- PASHOJA — Shoqërore në radhë të parë... hm... Kam kushëririn e tretë të nënës, thotë.
- DULJA — Po s'dua ta bezdis.
- TË DY — E hamë në atë, ore!
- PASHOJA — Unë për vete shtëpinë e kushëririn të tretë të nënës e kam si shtëpinë time... I thonë nënë, ore! Nënë! Ka më afër se nëna!
- DULJA — Mbylle se erdhi prapë.
(Në sportel duket përsëri *Shpresa që troket.*)
- SHPRESA — Më falni, a ka mundësi të më sqaroni pak?
- PASHOJA — Urdhëro!
- SHPRESA — Ju paskeni vende. Tani posa i lëshuat vend një burri.
- PASHOJA — Burri? Po a pe t'i lëshojmë vend ndonjë gruaje?
- SHPRESA — E ç'rëndësi ka kjo?
- PASHOJA — Si, moj, nuk paska rëndësi!... E, ore, Dule!
- DULJA — Burri, moj shoqe...
- PASHOJA — Burri është burrë... kuptoje vetë tani.
- SHPRESA — Nuk dua të kuptoj asgjë, shok... dua të fle... Pikë... Me sa shoh në regjistër ju keni shumë boshllëqe.
- DULJA — Mirë, o Pasho, rregulloje në një dhomë me katër vende.
- PASHOJA — Dhomë katërshe do?
- SHPRESA — Pse jo, nuk kam pretendime.
- PASHOJA — Mirë, na jep 16 lekë...

SHPRESA — 16 lekë?! Për një krevat në hotel të kategorisë së tretë!!

PASHOJA — Është i kategorisë së dytë, shoqe, me çezmë brenda dhe me çimka jashtë... Dhe ti s'do të paguash një krevat, por të katër krevatet!

SHPRESA — Të katër krevatet?! Ju falemi-nderit, po më mjafton vetëm një.

PASHOJA — E po s'më mjafton mua se?! Kujt do t'ia shes unë krevatet e tjerë? Gra këtej nuk na vijnë shpesh, kështu që...

SHPRESA — E mos kam faj unë për këtë?

PASHOJA — Po sipas teje e kam fajin unë për këtë? Pse të më mbeten mua, krevatet pa shitur? Do të flesh? Paguaji të rrish rehat. Nuk do? Hotel «Luleshqerra» i ka dyert hapur si për të hyrë ashtu dhe për të dalë.

SHPRESA — Po si t'ia bëjmë?

PASHOJA — Nuk e di unë... Me burra s'ta plotësoj dot dhomën se kam frikë se gërhasin natën...

DULJA — Dhe të prishin rehatin.

(Ia krisin të qeshurit të dy.)

SHPRESA — Si guxoni?!

DULJA — Bëjmë shaka, moj motër. Do zgjidhje ti? Shko tek ai kushëriri i nënës... Dhe kur të të pyesin në shtëpi, u thuaj: fjeta te filani.

PASHOJA — Dhe ti del faqebardhë dhe ne s'kemi përgjegjësi.

SHPRESA — *(Befas fillon të qeshë.)* Pse, ju kemi përgjegjësi?

DULJA — Sa të duash, moj motër.

PASHOJA — Shoqërore më shumë.

DULJA — Për të mirën tënde e themi, ëh!

SHPRESA — Qenkeni të lezetshëm ju! Mendoni për të mirën time dhe kërkoni të më lini të fle jashtë! Të fle në lulishte?

TË DY — Punë për ty!

SHPRESA — Po atje nuk ka njerëz që «gërhasin» dhe më prishin rehatin?...

DULJA — Ka me siguri.

PASHOJA — Ka, po ne për atje s'mbajmë përgjegjësi.

SHPRESA — Me pak fjalë, ju ndaj shoqërisë përgjigjeni vetëm për këto katër muret e hotelit... Mjaft që shoqëria, të mos shthurret në këta katër muret. Ka mundësi të flas pak me telefonin tuaj?

PASHOJA — Po, siurdhëroni! *(Ia jep.)*

SHPRESA — Mos e dini numrin e telefonit të drejtorit tuaj?

PASHOJA — *(I zgjat një karton.)* Ja ku e ke.

SHPRESA — *(Në telefon.)* Alo!... Drejtorin desha... Është i zënë? Ju lutem lajmërojeni pak... I thoni se e kërkon një kushërira e tretë nga nëna. Po pres në telefon.

DULJA — O burra, Pasho, merr kthesën, po avash-avash se s'ka lezet. Jemi burra...

PASHOJA — Të të jap një treshe, moj shoqe?

SHPRESA — Dhe ta paguaj dhomën komplet?
Jo! *(Në telefon.)* Po e marr më vonë.

PASHOJA — Si të duash.

DULJA — Mbylleni këtë muhabet, gjeji një dyshe, o Pasho. E ka më lehtë.

SHPRESA — Jo.

PASHOJA — *(I nxehur.)* Merre këtë dhomë me një krevat... Dhe do ta paguash komplet se s'bën... Pashoja s'tërhiqet nga e tia!

U R I M O M A N I A

Monolog

Nuk them ndonjë gjë të re po të them që zakonet e vjetra të mira t'i mbajmë e t'i zhvillojmë e të ligat, prapaniket, t'i hedhim tutje...

Po e dini se kanë filluar të na shfaqen ca zakone prapanike të reja që mundohen të futen në jetën tonë...

Këtë themi me plakën. Pse nusja e djalit tonë dhe nusja e Pilos, që kemi përballë, i ndjekin kaq këto zakone?! Morëm frigoriferin — hop Piloja me nusen për urim. Duart plot: tri rosa nga ato të kalamajve që bëjnë grëc-grëc dhe një ëmbëlsirë...

Gëzim kishim ne se kishim qenë të rrogosit e shtronim përdhe, e u bëmë me tërë të mirat, e hua ku do vemi!

E mirë bënë që na uruan, po pse tërë këto harxhime?!... Sos kanë një e dy frigoriferë. Të tërë kanë.

Mori Piloja përballë televizorin — hop t'u ngritën këta tanët, djali me nusen: dy albume, njëzet pasta e një qillo karamele qu-mështi.

Pa të nesërmen t'u ngrinë nusët e vanë

tek ajo sipër nesh e i panë atë lavatricën... Po lavatricia nuk u paka dot as me sy as me gjyslyqe, po me pako llokumesh.

Papo të venë këto të dyja... për fejesa e për martesë po se po se helbete, ato duhen, po jo se Shazos i erdhi çupa nga aksioni! Epo, mirë se i erdhi!... Shëndoshë e faqekuqe. Aksionet për rininë janë... Këto dhuratat pse?... I venë Zakes se ishte llogaritar e u bë shef llogarie — iku nga një tryezë e vate tek ajo dy metra më larg e një pëllëmbë më lart e varda llokumet! S'bëhen dot urimet më thjesht, xhanëm. Apo nuk ngjitin e duhen ngjitur me llokume. Një fabrikë llokumesh duhet të punojë për nuset e katit tonë, se ato të vijnë të urojnë kur jep provim, kur merr kategorinë, kur lyen shtëpinë, kur Beni mbush katër vjeç, kur mbush katër e gjysmë e pesë pa një çerek, kur Albës i del dhëmbi i parë, kur i del dhëmbi i dytë, kur i del i tretë... I thonë tridhjetë e dy dhëmbë, xhano!... S'ia dalim dot. Urimet e tepërta s'kanë lezet.

Jam trembur nga nusja e Pilos se rrezik të vjen kur blen këpucë e kur të sjell komunalja drutë.

«Bobo, — thoshte një ditë, — u turpërova me Vasilikën. Bleu sobën majolike s'më është bërë mbarë ta uroj. Kur e shoh ndërroj rrugë». «Unë e kam syrin pishë, — i thoshte kjo nusja jonë, — se i bleva një qen allçie dhe vajta». Më thjesht, moj bija, më thjesht! Ne një herë e një kohë uronim gëzimet e mëdha: fejesa, martesë, lindje... I vinim me harxhe tjetrit për shtëpi se e bënte vetë shiste plaçkë e katandi e harxhonte i ziu qimet e kokës. Epo një dhuratë e shtrenjtë — mirë ishte, se e ndihmoje.

Po sot ta jep shteti apartamentin gati. Ndririt. Ta lëpish me gjuhë! Këtu jam unë për një ëmbëlsirë apo ca llokume... Po jo t'i shpi-esh komplete e stërkomplete!...

Bëmë shamatë kur mori shtëpi Stefoja, nipi nga motra. Djali me nusen ngulën këmbë... Ta djegim! Jo po na kanë ardhur duarplot! Jo po ne nuk biem më poshtë! Jo po e kemi nip!... E hip e hip vajtën tek soba me vajguri, ore! Plaça në ju gënjej!

E që t'i jap fund historisë, se kjo që e bukur, sollën në shtëpi sobën e vjagurit që ta mbështillnin e t'ia shpinin Stefos. ... Kur do të niseshin hop ra zilja dhe ç'të shohim? Stefoja me të shoqen! Veshur e ngjeshur erdhën e na u plasën në dhomën e pritjes.

— Na falni, ju mbase po dilni! — tha Stefoja. — Pamë që bletë një sobë vajguri dhe erdhëm t'ju urojmë. Dhe fap na nxorën për sobën e tyre një tortë të madhe e një luan me leshra përpjetë!...

Mos qesh me këto zakone po të duash!

TELEFONI I RI NË SHTEPI

Komedi me një akt

Personat:


SHAQOJA — pensionist

DEMOJA — shok i tij

TRIFONI — komshi, rreth të pesëdhjetave

ZELIHAJA — komshie, rreth tridhjetë e pesë
vjeç

PETROJA — komshi



Në apartamentin e Shaqos. Skena paraqet kuzhinën dhe korridorin e apartamentit. Në një kolltuk është ulur Demoja.

Sipër frigoriferit një telefon i ri. Shaqoja me një tabaka në dorë futet në kuzhinë të gostitë mysafirin.

SHAQOJA — (I zgjat tabakanë shokut.) Urdhëro!

(Demoja merr gotën.)

DEMOJA — Epo telefonin e ri ta gëzoni! Dëgjofshi vetëm të mira e thënci vetëm sihariqe!

SHAQOJA — Të lumtë goja!

(Përplasnin gotat dhe pijnë.)

DEMOJA — Telefoni në shtëpi duhet.

SHAQOJA — U dashka, more Demo, u dashka.

DEMOJA — Edhe ne do ta vemë së shpejti.

Në shkallën tonë bëhen gjashtë telefona.

SHAQOJA — Do të llafosemi bashkë pastaj.

DEMOJA — Po është i mirë, ëh Shaqo? Të kënaq, ëh?

SHAQOJA — Ç'pyet?! S'ka lehtësi më të madhe, Demo! Pyet: kur niset treni. Kur niset filan autobus. Apo merr djali nga zyra: sonte do të vonohem, mos u bëni merak. Të merr krushka: ju mora, thotë, se nipçes i doli dhëmbi i parë.

DEMOJA — Po dhëmbi i parë nipçes i doli pa vënë ju telefonin.

SHAQOJA — E e, xhanëm, i doli, s'na priti... Ta kishim vënë do të na e thoshin në telefon.

DEMOJA — Ashtu është... Kollajllëkun e ka ky qerrata, telefon.

SHAQOJA — Po që e ndien tamam-tamam lezetin, ja do ta provosh e të më japësh të drejtë, kur bie shi. Shiu rrjedh jashtë

me litarë. Rrezik t'i laget njeriut gjuha në gojë. Ti flet që këtu brenda.

DEMOJA — Po na mbushet shtëpia me tërë të mirat, o Shaqo. Ku ishim e ku jemi.

SHAQOJA — Atë i them plakës. A do të qahesh më, i them. Ç'të mungon? Nuk di ç'të thotë. Mendohet. S'di ç'të kërkojë më. *(Qesh për një kohë të gjatë, befas.)* Dhe sot e di psë iku tek çupa? Nuk kishte asnjë punë, iku që të më flasë me telefon!

(Qeshin të dy.)

DEMOJA — *(Duke qeshur.)* Nuk kini folur ndonjëherë me njëri-tjetrin?

SHAQOJA — Kemi folur, ka pasur raste. Po tani: dhëndri ka, ne kemi, duam të flasim me telefonët tanë.

DEMOJA — Lehtësi e madhe, për nder!

SHAQOJA — Ç'pyet Demo! Vëreni sa më shpejt.

(Bie zilja e telefonit.)

SHAQOJA — Ja! Plaka!... E kujtuam dhe ja! *(Nxiton dhe merr dorezën e telefonit.)* Alo! Urdhëro! E moj... *(Befas)* Po. Ja ta shohim. *(Lë dorezën.)* Kërkojnë këtë komshiu që kemi sipër. *(Del me nxitim.)* Telefonin e ka lënë të hapur. Demoja afrohet aty ngadalë dhe e sodit.)

DEMO — Të kënaq. *(E merr me kujdes dhe e ve në vesh.)* Urdhër! Jo nuk jam unë. Vajti, vajti Shaqoja ta thërresë. Shaqoja them, ore! Ja erdhi! *(I jep telefonin Shaqos.)*

SHAQOJA — *(Me mirësjellje.)* Alo... Trokita... Nuk ka njeri... Po. po mos u bëj merak,

kur të vijë i them unë. Të të marrë ai, ëh? Që këtej? Mirë që këtej. (*Lë dorezën në vend.*) Ja, e kërkoi tjetrin, s'e gjeti... La porosinë.

DEMOJA — Hiç mos e zgjat: lehtësi e madhe.

SHAQOJA — Jo po të vinte deri këtu.

DEMOJA — Pu pu pu!

SHAQOJA — (*Zgjat dorën në drejtim të kuzhinës.*) Urdhëro ta mbushim edhe nga njëherë.

(*Nisen për nga kuzhina. Në atë çast nga dera e jashtme futet Trifoni. Është një burrë tepër i sjellshëm me një ecje elegante.*)

TRIFONI — Mirëdita... Do t'ju lutesha shumë shumë, përunjësisht do të thosha, që të më falni për bezdinë që do t'ju shkaktoj.

SHAQOJA — Urdhëro, Trifon, urdhëro!

TRIFONI — Desha të bëja përsëri një telefonatë.

SHAQOJA — Natën, ditën — kur të duash! Pa merak, Trifon!

TRIFONI — E ndiej ngrohtësinë tuaj. Ju jam tepër mirënjohës. E kam tmerrësisht të domosdoshme. (*Formon numrin.*) Alo? Garancia e televizorëve? Trifoni jam... Me kë kam nderin... Ah jeni ju vetë dora!... Ju njoftoj zyrtarisht se televizori im nuk funksionon... Nuk pasqyron asgjë... Asgjë, po ju them... Vetëm miza dhe khëhëhë... Dakord, mbrëmë e rregulluat, sot rezulton i parregulluar... Ah, po ju lutem, ky është fakt! Ah, i shtrenjti shok, unë s'dua as miza as khë... Unë dua figurë dhe tingull... Punoni kualitativisht dobët, ju shokë të garancisë... Pa ndër-gjegje, pa responsabilitetin minimal. Këtë e them me kompetencë absolute. Oh,

ky të mos ju duket ton i ashpër. Ligjë-rata ime e ka mirësjelljen në çdo rrokje! Në çdo germë... Mirë. Ja prisni, po e pro-voj. Mos u largoni nga riçevitori, ju lu-tem. (*Le dorezën e telefonit mbi frigori-fer.*) Kafshë parahistorike! (*Pleqve me mirësjellje.*) Mos e mbyllni telefonin, ju lutem.

SHAQOJA — Mos ki merak, Trifon.

TRIFONI — (*Duke dalë.*) As portën, ju lutem. Do të kthehem në çast, sa të provoj diç-ka që më rekomandoi tekniku.

(*Trifoni del.*)

SHAQOJA — I ziu Trifon! Me sa duket ia ka prishur qejfin televizori i ri.

DEMOJA — E po për fat të mirë, ju ka juve këtu. Do të vente deri tek garancia.

(*Kthehet Trifoni.*)

TRIFONI — (*Në telefon.*) Vërtet. Kishit pasur shumë të drejtë. Absolutish në rregull. Ashtu ishte. Kisha harruar pa futur fillin e antenës prapa... Ju lutem, ju lu-tem asgjë... Ju jam thellësisht mirënjohës. Më falni për bezdinë që nuk e meritoniit aspak. (*Ul telefonin.*) Duhet ta kemi men-djen dhe tek antena tani, idiotë! (*Niset dhe del duke sharë.*)

DEMOJA — Ç'eshtë ky, more. As ditën e mirë nuk tha.

SHAQOJĀ — Lere, mbase do të vijë prapë, i gjori Trifon.

(*Përpjekin gotat përsëri.*)

DEMOJA — S'të mori plaka...

SHAQOJA — Mbase ka marrë po e ka gjetur zënë me Trifonin.

DEMOJA — Ç'do të të thotë në telefon, më qafsh?

SHAQOJA — (*Qesh*) Asgjë. Do të më pyesë: a të kthehem vetë apo do vish të më marrësh? Unë do t'i them: hajde vetë se nuk e lë dot shtëpinë vetëm, kushedi cilin kërkojnë në telefon.

DEMOJA — (*Duke qeshur.*) Vetëm për kaq gjë shkoi te çupa?

SHAQOJA — Asgjë, a derëzi, qejfi i telefonit.

DEMOJA — Ka hak plaka... Gëzohet. E ka shtëpinë larg çupa?

SHAQOJA — Ç'larg! Ja, pallati përballë. Ja. (*I tregon nga dritarja.*) E sheh atë saksinë në jeshile atje... Dritarja e çupës është...

(*Bie zilja e telefonit.*)

DEMOJA — Plaka!

SHAQOJA — (*Gjithë qejf.*) Merre ti, Demo!

DEMOJA — Si ta marr unë?

SHAQOJA — Merre telefonin ti... Të tallemi një çikë me të.

DEMOJA — (*Që mezi mban gazin.*) E ç'ti them?

SHAQOJA — Thuaj... ke gabuar numrin, thuaj.

DEMOJA — Ashtu do t'i them.

(*Shkojnë të dy tek telefoni duke qeshur. Demoja ngre dorezën.*)

DEMOJA — Alo! Urdhëro?... (*Shaqos*) Kërkojnë prapë këtë komshiun sipër. (*Në telefon.*) Ta shohim. Që parë nuk ishte. Ta shohim prapë? (*Shaqos*) Shihe prapë.

(*Shaqoja del.*)

DEMOJA — Ja prit. Vajti Shaqoja. (*Ul dorezën.*) I ziu Shaqo... tërë jetën korrier ka punuar... Doli në pension, po zanatin.

(Kthehet Shaqoja.)

SHAQOJA — Prapë nuk është.

DEMOJA — (Në telefon.) Nuk është prapë. Nuk gjendet aty. Urdhëro? (Shaqos) Thotë shikojeni mos është tek i vëllai në katin e gjashtë.

SHAQOJA — (I merr dorezën Demos.) Nuk janë as ata. Na kanë lënë kyçin. Ja. (E mbyll.) Oho!

DEMOJA — (Pas një pauze.) Lehtësi, lehtësi, po paska telashe...

SHAQOJA — Ç'lehtësi, or Demo, më qafsh! Ka pesë ditë që e kemi vënë... na dhëmbin këmbët... Kur kam plakën, herë vete lajmëroj unë, herë ajo... Po sot ajo ma bëri me hile.

DEMOJA — Jo, ore, dhe ti!

SHAQOJA — Ja, ta them unë... I bëri bisht korrierllëkut!

(Futen përsëri në kuzhinë.)

DEMOJA — E mos u mërzit.

SHAQOJA — Ç'të mërzitem! Isha mirë e bukur. Bëja ndonjë punë, lexoja ndonjë libër... Më dhëmbin gjunjët nga të ngjiturat e noçkat e gishtërinjve nga të trokiturat.

DEMOJA — S'ka gjë, s'ka gjë... Pa mendo kur binte shi e ti flisje që brenda.

SHAQOJA — Ia mbyta kot unë... Që kur e kemi marrë s'ka rënë asnjë ditë shi.

(Pauzë)

DEMOJA — Ti, Shaqo, vuan se nuk prish qejf.

SHAQOJA — Ah, po të vjen zor, more vëlla... E di ç'do të bëj, Demo? Do ta marr vetë plakën e t'i them të vijë. Ta, kem për ndihmë. Herë unë herë ajo.

- (*Shaqoja niset për te telefoni. Hyn Zelihaja. Nën sjetull mban një triko që, mesa duket, e punon kur ka kohë të lirë.*)
- ZELIHAJA — (Që tek porta e jashtme.) Xha Shaqo!
- DEMOJA — Kush është kjo?
- SHAQOJA — Zelihaja.
- ZELIHAJA — Xha Shaqo!
- SHAQOJA — Hajde, Zeliha!
- ZELIHAJA — (*Fut kolecën në kuzhinë.*) Nuk e paske plakën? (*Duke marrë numratorin, Demos.*) Si jeni, ju xhaxha? (*Kontrrollon numëratorin.*)
- DEMOJA — Mirë, faleminderit! Si je, zotrore? Si i ke fëmijët?
- SHAQOJA — (*Nxiton ta përmbajë, me zë të ulët.*) Ssst! Na djallose!
- DEMOJA — (*Me zë të ulët.*) Pse?
- SHAQOJA — (*Me zë të lartë.*) Zelin e kemi vajzë të pamartuar. E kemi gonxhe, e kemi... Do të na shëmtojë pallatin kur të na e marrin...
- DEMOJA — (*I hutuar, ngadalë.*) Kjo e pamartuar?!
- SHAQOJA — (*Mënjatë*) Dy herë e fejuar, po është grindur e ndarë. (*Shkon tek telefoni.*) Hë, Zeli?
- ZELIHAJA — Ja, dua të marr dikë.
- SHAQOJA — Të marr një herë dikënë time unë, Zeliha, pastaj merr dhe ti dikënë tënde.
- ZELIHAJA — (*I shtyn dorën.*) Tani u kujtove ti, xha Shaqo?! Ke tërë ditën këtu... Telefoni yt është. Ta marr unë njëherë se ashtu është puna.

SHAQOJA — (Nuk heq dorë.) Ja, e mora e ta lashë ty pastaj. (I merr dorezën.)

ZELIHAJA — (Duke formuar numrin e saj.) Ti e sheh që unë numrin e parë e rrotullova... I thonë çështje jete kësaj times! Ja katër!... Ja nëntë! Tani, meqë e ke në vesh... (Me një nuancë dhelëparake.) kush të dalë thuaj: dua Kason, jam i vëllai.

SHAQOJA — (Me dorezën nëpër duar.) Kason?! I vëllai?!

ZELIHAJA — Tafti bafti... Sot vendoset gjithçka... Po u prish, përgjithmonë...

SHAQOJA — (Në telefon.) Jam i vëllai. Dua Kason. (Ia le telefonin vajzës.) Vajtën ta thërrasin.

(Zelihaja pret. Shaqoja shkon tek Demoja.)

DEMOJA — Si e ka hallin kjo?

SHAQOJA — Ç'hall?! Do që të martohet.

DEMOJA — (I habitur.) Dhe ti po e merr për tët vëlla?

SHAQOJA — Jo, a derëzi, dhe ti! Ohu!... Ky Kasoja është ai i fejuari. Më duket se po pajtohet për së treti.

ZELIHAJA — (Në telefon.) Kaso! (Shaqos) Doli. (Në telefon.) Gjeje kush jam. Nuk e gjen dot?... Jo, jo gjeje... E gjete. (Mbyll telefonin dhe u drejtohet pleqve.) E gjeti. (Në telefon.) Ta priste mendja që do të të marr në telefon? Jo?! Unë përkundrazi... Kisha një parandjenjë të madhe që do të të marr... Sa interesant! Ç'është telepatia!... Që nga po të flas?... Nuk e di ti?... Tani ne kemi vënë telefon... Ëhë... Ja, kemi pesë ditë.. Shpëtuam tani... Ti do numrin e telefonit?! Vërtet e do?!... Oh. Jo, në numëror akoma s'na kanë shë-

nuar... Do të më marrësh? Ta jap unë.
(Xha Shaqos.) Xha Shaqo, o burra, numrin!

SHAQOJA — Eh?

ZELIHAJA — Numrin.

DEMOJA — Numrin?!

ZELIHAJA — Numrin e telefonit.

SHAQOJA — (Duke e kërkuar nëpër sirtare e nëpër xhepa.) Ku e di unë... Akoma s'e di përmendësh.

DEMOJA — Po dhe ti, a derëzi! Vë telefon dhe s'di numrin!

SHAQOJA — E kishim të shkruar në një copë paketë po e mori me vete plaka që të më marrë që andej... E marrtë lumi!
(Zeliasë me shenja e avash.) Nuk e di.

ZELIHAJA — (Mbledh buzët.) Ah! (Në telefon.) Kaso, e ndërrova mendjen. Dua që ta gjesh vetë. Të shohim sa do të përpiqesh. (Xha Shaqos gati më të qarë.) Si nuk mban mend numrin tënd, xhanëm! (E qeshur, në telefon.) Jo! Nuk dua të ta jap... Ç'kemi?... Më thanë, po po... Kasoja më thanë ka shkruar ca poezi të bukura, po nuk ia botojnë. Gjynah... I ke aty? Pa ma lexo njëren prej tyre... Po dëgjoj. Mbështetet mirë në murin që ndan kuzhinën me korridorin, mban telefonin në sup dhe, pasi hedh perin në qafë, fillon të thurrë triko. Lëmshi i bie dhe pasi rrokulliset, vjen përpara dy pleqve. Ata shohin lëmshin pastaj shihen sy ndër sy e pastaj përsëri shohin lëmshin.)

DEMOJA — Bobo... Mbarohet gjithë ky lëmsh, o t'u mbylltë!

SHAQOJA — Eh!... Uh! (*Papritur.*) Ju, Demo, kur do ta merrni?

DEMOJA — Kë?

SHAQOJA — Telefonin.

DEMOJA — Muajin tjetër, po na kanë dhënë shpresa që do të na e anulojnë.

SHAQOJA — Do të shpëtoni.

ZELIHAJA — (*Në telefon.*) Shumë-shumë e bukur!Ua! Çudi si s'e pëlqejnë? Kjo duket që ka karakter eretik... Si?... E po dhe unë erotik thashë, po është telefon i ri... Akoma nuk punon si duhet... Tani dëgjo...

(*Zelihaja mbyll gojzën e telefonit dhe vështron Shaqon dhe Demon.*)

ZELIHAJA — Më falni, ëh... A... s'mund të dilni pak në ballkon?

SHAQOJA — Në ballkon?!

DEMOJA — Oho!

ZELIHAJA — Ose... jashtë...

SHAQOJA — Nuk dal sikur të përmbysët!

ZELIHAJA — Le ta marrin vesh të gjithë, Kaso... Të dua!

(*Hapet dera e jashtme dhe hyn me rrëmbim Petroja.*)

PETROJA — Ku je ti, xha Shaqo! Plaka të ka marrë pesë herë në telefon. Të del i zënë. Hadje, fol nga telefoni im. E kam lënë hapur... Taksirat e ke deri në katin e gjashtë.

SHAQOJA — Unë... të flas me telefonin tënd?!

PETROJA — Ashtu thotë ajo.. Këtu s'të merr dot.

SHAQOJA — Nuk vi, ore, jo! Po shko e i thuj të dalë në penxhere, këtej nga ana jonë.

(*Petroja del.*)

SHAQOJA — Demo, po pate komshij të tillë
telefon mos vënç kurrë!

*(I këput lëmshin Zelihasë dhe e ve mbi
bufe. Pastaj shkon tek dritarja që sheh
nga shtëpia e së bijës.)* Ja, doli plaka.

(Hap me nxitim kanatën e dritares.)
Hej!... Na, moj! Hajde, ç'pret! Urdhëro?
Lere, moj, telefonin e hajde! Na dashkë
salltanete... Hajde këtu të them se... Nuk
jam Kasoja unë!

*(Demoja mezi mban të qeshurën. Zelihaja
vazhdon të bisedojë duke thurrur triko.)*

O FUTBOLL, NA LE PA GJUMË

Bisedë rreth tryezës

Personat:

KONFERENCIERI

MUÇO GJULLURDIA — trainer

ZEKO SHUTERI — futbollist

KONFERENCIERI — Shumë skuadrave tona u vëmë faj për mungesë stabiliteti në lojë. Ato kalojnë nga loja e shpejtë në atë të ngadaltë, nga futbolla spektakular në atë të mërzitshëm, nga rezultati pozitiv në një ndeshje, në humbjen e ndeshjes tjetër.

Vetëm skuadra që po marrim sot në analizë, skuadra «Furtuna», ka një stabilitet të mrekullueshëm: ajo s'ka asnjë lëkundje. I ka humbur që të gjitha ndeshjet dhe nuk ka shënuar asnjë gol. Kemi ftuar këtu trainerin e skuadrës «Furtuna» Muço Gjullurdinë dhe qendërsulmuesin Zeko Shuterin.

Shoku Muço, na flisni pak për skua-

drën tuaj. Sa është mosha mesatare e lojtarëve?

MUÇOJA — Moshë e pjekur... Të gjithë burra të respektuar. U ecën fjala në shoqëri... Por s'jemi të kënaqur. Për të rritur autoritetin e skuadrës, në të ardhmen moshën mesatare do ta çojmë edhe më tej.

KONFERENCIERI — Ç'udhëzime u jepni lojtarëve para ndeshjes?

MUÇOJA — Udhëzime u jap plot, por kundërshtarët, gabimisht, na i prishin të gjitha, sepse nuk i dinë planet tona... Kështu që të tjera plane bëjmë në letër e të tjera na dalin në fushë. Merrre me mend, pa dijenin time, në ndeshjen e parë dhe të dytë të kampionatit, lojtarët e mi goditën nga dymbëdhjetë shtylla! Me shtylla vazhduan edhe në ndeshjet e tjera... Shtylla dhe asnjë gol... Nishanxhinj të mëdhenj!

KONFERENCIERI — Ç'masa morët?

MUÇOJA — Pesë veta i kaluam në ekipin e qitjes dhe morëm pesë të tjerë.

KONFERENCIERI — Të rinj?

MUÇOJA — Jo, jo, të rinjtë kanë kohë... Morëm pesë të pjekur të tjerë... Ata deshën ta linin futbollin, por ne bëmë një punë të dendur sqaruese...

KONFERENCIERI — Kurse nga ana taktike...

MUÇOJA — (E ndërpret.) Kaluam në variant tjetër. I thjeshtë, por origjinal... Aftësinë e lojtarëve për goditjen e shtyllave u munduam ta shfrytëzojmë. Kështu, Zeko?

ZEKOJA — Po, morëm porosi që të gjuajmë vetëm në shtyllë. «Do gjuani shtyllat, — na tha shoku Muço, — gol hëpërhë në asnjë

mënyrë! Shtyllë! Kundërshtari natyrisht do të kthehet të shohë shtyllën kurse topi do të vijë prapë tek ju. Rrezik ofsajti nuk ka. Atëherë gjuani për në rrjetë... Kundërshtari do të jetë i hutuar dhe me kurriz, dhe goli do të dalë në dritë.»

MUÇOJA — Tamam ashtu!

KONFERENCIERI — Sa variant i thjeshtë dhe i pashfrytëzuar! Ju dha rezultat?

ZEKOJA — Hiç fare? Se që atë ditë ne nuk goditëm dot më asnjë shtyllë.

KONFERENCIERI — Na flisni pak për cilësitë e futbollistëve tuaj... Ja, për shembull, cilësitë tuaja vetjake, Zeko.

ZEKOJA — Për vete nuk flas dot.

MUÇOJA — Ju flas unë për Zekon. Zekoja ka një disiplinë personale shembullore: në stërvitje vjen gjithnjë me gjysmë ore vonesë. As më parë e as më pas! Nuk e ndërron ndonjëherë markën e cigareve dhe fle gjithmonë pas orës 12 të natës. Fiks!

KONFERENCIERI — Njeriu i rregullt bie në sy...

MUÇOJA — Është këmbëngulës i madh!

KONFERENCIERI — Si këmbëngulës? Mos doni të thoni se po nguli këmbët në zonë nuk shkulet që andej për të kërkuar top?

MUÇOJA — Pikërisht. I ka këmbëngulja këto!

KONFERENCIERI — Shoku Zeko, na flisni pak për cilësitë tuaja teknike. Sa e keni kërcyeshmërinë?

ZEKOJA — (*Sheh nga treneri, i hutuar.*) Kërcyeshmërinë?

KONFERENCIERI — Kur kërceni, sa kërceni?

MUÇOJA — Zekoja kërcen vetëm kur e kritikojmë në analizat e ndeshjeve.

ZEKOJA — Dhe sa kërcëj varet nga kritika.

- KONFERENCIERI — Jo, unë pyes, si luftoni në ajër?
- ZEKOJA — Ne në ajër nuk luftojmë... Nuk shkëputemi nga toka mëmë!... Jemi këmbësorë.
- KONFERENCIERI — Për sa sekonda e bëni njëqind metërshin?
- ZEKOJA — Nuk më ka takuar të vrapoj ndonjëherë njëqind metra.
- KONFERENCIERI — E drejtë... Na flisni për gjuajtjet.
- MUÇOJA — Gjuajtjet e Zekos janë nga më të llahtarshmet!
- KONFERENCIERI — U hapka punë kundërshtarëve!
- MUÇOJA — Kundërshtarëve jo, po kalamajve që mbledhin topat, ua ka nxirë jetën... Se i gjuan të gjitha jashtë dhe i dërgon shumë larg.
- KONFERENCIERI — Në ndeshjen e fundit vuamë re...
- MUÇOJA — Ah, lere mos na e kujto... Nuk do të na ecë!
- KONFERENCIERI — Na e komentoni pak.
- MUÇOJA — Unë nuk shoh gjë, se gjatë gjithë ndeshjes sytë i mbaj të mbyllur... Nga emocioni.
- ZEKOJA — Jua komentoj unë... Kundërshtarët tanë me fanella jeshile ishin mbledhur në zonë. Unë lashë prapa një fanellë jeshile. Më dalin përballë dhe fanella të tjera jeshile. I kaloj dhe ato.. Shoh përpara meje pesë fanella jeshile...
- KONFERENCIERI — Ku luanit kështu? Në mapo? Apo në trikotazh?! Ç'janë këto fanella që po na thoni?
- ZEKOJA — Kundërshtarë! Po në gjuhën e ko-

mentatorëve quhen fanella. Nuk e keni dëgjuar? (*Imiton*) «Ai ka topin, do ta pasojë, kërkon një fanellë të kuqe, nuk gjen asnjë fanellë të kuqe dhe ia dorëzon topin një fanelle blu!»

KONFERENCIERI — Vazhdoni.

ZEKOJA — Pra, pasi kaloj dhe këto fanella, që kishin brenda pesë kundërshtarë...

KONFERENCIERI — Këto i kaluat me top, me driblime?

ZEKOJA — Me driblime, pikërisht. Por pa top! Topin e kishte sulmuesi ynë i djathtë. Ai u bë gati të krosonte. Unë e nuhata! Mbylla sytë dhe fluturova përpara me kokë.

KONFERENCIERI — Shoku e krosoi?

ZEKOJA — Jo. As e krosoi as e ka krosuar akoma dhe sot!

MUÇOJA — Zekoja bëri të tijën. Kështu e kisha dhënë variantin unë!

ZEKOJA — Unë u hodha pingul dhe rrëzova dy kundërshtarë. Njërën e futa brenda në rrjetë po nuk ma quajtën. U rrëzuam të tre... Meqenëse ata e bënë gafën e u ngrihën më parë se unë, arbitri Peço Bilbili dha penalti.


KONFERENCIERI — Penalti?!

ZEKOJA — Ju duhet ta njihni Peçon! Është ai që të gjitha ndeshjet i nxjerr një me zero, për skuadrat vendase dhe që në çdo përplasje e jep faullin kundër atij që ngrihet më parë nga toka... Kështu u dha penalltia. Pastaj ju e patë vetë. U zgjat ajo punë — portieri kishte frikë. Kishte rrahje zemre për shkak të famës së goditjes sime të fortë. Sollën doktorin. I bënë elektrokardiogramën... E panë që mund të rezistonte.

KONFERENCIERI — Pastaj?

ZEKOJA — Pastaj filloi gjuajtja e penaltisë. E gjuajta shtatë herë... Godisja portierin. Ai s'dinte ku të futej... Unë gjuaj — bam portierit! Ai më hapte rrugën unë — bam prapë atij! Pa dashje! Dëshën të më hidhnin në gjyq për rrahje me top futboll.

KONFERENCIERI — Dhe nuk u bë gol?



MUÇOJA — O po kush po pyet për golin! Shyqyr që shpëtoi njeriu!

KONFERENCIERI — Për humbjet tuaja kush e ka fajin?

ZEKOJA — Nuk i kemi gjë spektatorët!

MUÇOJA — Drejt e ka Zekoja. Spektator për mua, është detyrë me përgjegjësi. Spektatori nuk duhet të pushojë asnjë çast. Bravo! Gol! Forca! Gol!

KONFERENCIERI — Të thërrasin gol kur ju nuk bëni dhe bravo kur pasoni gabim?!

ZEKOJA — S'ka rëndësi... Ata le të bëjnë punën e tyre, ne tonën! Në fund i bëjmë hesapet.

MUÇOJA — Bile për këtë unë propozoj të ha-

pet një kurs nëntëmujor për spektatorë.
KONFERENCIERI — E drejtë. Njëfarë mase
duhet marrë.

MUÇOJA — Posi... Dhe në këtë kurs të prano-
hen njerëz të zgjedhur. Të kenë marrë
pjesë në kore dhe komplekse vokale. Të
bëjnë dhe analizat e gjakut. Njerëz me
gjak të butë nuk duam në kurs. Kursi
të ketë dy lëndë kryesore: bërtitje dhe
taktikë.

KONFERENCIERI — Mirë bërtitja, po taktika
pse duhet?

ZEKOJA — Ah, të zezhtë ne thuaj!... (*Shpjegon.*)
Taktika është dredhi. Spektatorët tanë janë
tapë në këtë drejtim. Sapo unë marr topin
e përgatitem të gjuaj, ata nga shkallët
bërtasin: «Gjuaje, Zeko!». Kundërshtari e
kupton menjëherë ma heq topin nga këm-
bët... Po lereni, more, pse ia kujtoni.

KONFERENCIERI — Mbase harrojnë... Bile në
njëfarë mase, kjo është tradhti.

MUÇOJA — Tradhti jo, por pa faj nuk janë.

KONFERENCIERI — Për humbjet tuaja faj ka-
në edhe kalamajtë që mbledhin topat, fo-
tografët, komentatorët, arbitrat. Por më
shumë nga të gjithë...

MUÇOJA DHE ZEKOJA — Ajo dihet: kundër-
shtarët!

VËREJTJET E MIA

Monolog

Unë, një spektator i thjeshtë jam. Spektator i estradës. E dua estradën. Ma jep ku të duash: në skenë, në ekran, në radio — unë e ndjek. Le të jetë daç amatore, daç profesioniste unë e pëlqej. Po të jetë e bukur ama, ndryshe unë kam vërejtje. Si fillim kam vërejtje për disa shkrimtarë që premtojnë të shkruajnë për estradën e të thonë: «Nisa të shkruaj një skeç, po m'u ndez frymëzimi, m'u flakërit fantazia e do ta bëj komedi.» Në fund nuk i del as komedi, as skeç, po një artikull i gjatë mbi nevojën e angazhimit të disa shkrimtarëve të kualifikuar në gjininë e estradës.

Kam vërejtje për disa aktorë që zotohen të njohin sa më mirë jetën e popullit, po në të vërtetë njohin vetëm jetën e tyre. Në skenë i ndërrojnë kostumet, po në thelb mbeten po ata. Nga një aktor i tillë mos u habit kurrë kur interpreton në skenë një monopolist të huaj e ta dëgjosh të flasë kështu: «Njëmëthi, mister, unë mejtonj që t'i shtojmë hinvestimet dopje e jo si njëvitëzaj, ore».

Kam vërejtje për disa këngëtarë. Ca nga këta e ndjekin orkestrën, kurse ca të tjerë i ndjek

orkestra. Një të njohurin tim këngëtar ka dymbëdhjetë vjet që e ndjek orkestra dhe nuk po e zë dot! Po më simpatiku nga të gjithë është tenori Muço, që këndon me afsh e me zjarr, po nuk i merret vesh asnjë fjalë. Për të kënduar tekstin: «Unë jam i qeshur, jam i gëzuar, nuk ka më i lumtur se unë», këndon me një fytyrë të tillë sikur i ka ngrënë derri brumin.

Po pse, për vetë spektatorët, për një takëm de, thonë se nuk kam vërejtje? Kam që ç'ke me të! Ca nga këta vijnë vetëm të qeshin e të bëjnë bis nga katër herë rresht për këngët që u pëlqejnë e thonë: oh sa këngë e bukur! Ja kësaj i them këngë unë! Biiis! Fiiiu! Biiis! Dhe kur del këngëtarja që t'ua këndoje këngën që u pëlqen, ata venë duart rreth gojës e thonë: «Tjetër, tjetër, eej!» U prishin punë festivaleve dhe olimpiadave, ua sjellin në majë të hundës spektatorëve të sjellshëm e të edukur, ngatërrojnë edhe juritë në punët e tyre.

Meqë ra fjala kam edhe vërejtjen e fundit për disa juri që mbliidhen e stërmbliidhen e nuk duan t'ia prishin asnjë grupi, po japin dy çmime të para, tre të dyta e katër të treta. Juri ishte ajo që i dha grupit tonë amator çmimin e tretë. Hajde juri, hajde. Ajo ndau shtatë çmime të para, dymbëdhjetë të dyta e njëzet e dy të treta! Mrekulli! Të gjithë fitimtarë. Të humbur dolën vetëm ata që nuk morën pjesë.

PERSONAZHET KUNDËR SHKRIMTARIT

Shaka miqësore rreth disa krijimeve të D. Agollit.

Personat:

HALIL SHKOZA — nga «Fytyra e dytë»
ZYLO KAMBERI — nga «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo»

Një stol në një lulishte. Në të është ulur Halil Shkoza që po dredh duhan. Me hapë të shpejtë i afrohet Zyloja.

ZYLOJA — Halil Shkoza në mos gabo hem!

HALILI — I tëri. Nga koka te këmbët. Zotrote pa një pa dy do të jesh Zylo Kamberi!

ZYLOJA — Dora vetë...

HALILI — Më ka llafosur kushëriri Bektash.

ZYLOJA — Futemi në temë?

HALILI — Ku?

ZYLOJA — Në temë!

HALILI — (Shikon për qark.) Unë them mirë je mi këtu.

ZYLOJA — Në temë, thashë, në çështjen që na intereson. Ç'mendim ke për atë?

HALILI — Për kë?

ZYLOJA — Për atë. (Tregon kopertinë e një libri.) Për këtë... Për Dritero Agollin!

HALILI — Aha... për atë që na ka bërë gazin e botës? Veç në mos e pafsha! I kam vajtur dy-tri herë atje ku rri... E gjej me shërbim... Bredh, Zyo, bredh...

ZYLOJA — Pse të mos bredhë!

HALILI — Na bëri lolon e dynjasë.

ZYLOJA — E ç'të bëri ty, a derbardhë! Në fshat ishe, në fshat mbete... Mua më shkatërroi karrierën... Më ke lexuar?

HALILI — Jo, ore, dhe jam turpëruar... Kam dashur të të lexoj po ku gjendesh ti!... Je shitur shpejt... Po të kam dëgjuar... Po mua më ke parë nëpër teatrot?

ZYLOJA — Të kam parë në të Tiranës, në të Shkodrës, të Vlorës... E njeh shkrimtarin tonë?

HALILI — Ah, e njoh, e njoh. E kemi nga anët tona... Kështu nuk është njeri i keq...

ZYLOJA — Kush? S'mban inat ti, Halil... Ju, masa, fshatarët, dua të them, jeni të gjerrë... Është njeri që të qepet...

HALILI — E di, e di... Ai ma martoi çupën me atë horr, elektrikhiun! ...Elektrixhiu duhej të bëhej gazi i botës e jo unë... Këtej vinte dritat, kurse çupën ma shpinte andej nga s'kishte drita... E po punë e pastër është kjo?! Ja këtu them unë, ai Driteroi ma drodhi. I la rehat ata e m'u sul mua, pabesisht!

ZYLOJA — Kurse mua më bëri leckë... Sot mund të isha ambasador... Lëre, po desh më ndau edhe nga gruaja... Më solli pas përgjimit e fëmijëve të mi, të cilët kanë arritur deri aty sa mbajnë nëpër raftet e nën jastëqe librin mbi shkëlqimin dhe rë-

nien e babait të tyre! Në bashkëpunim me ndihmësin tim, Demkën, një devolli tjetër ky — tarafilëk i organizuar — më ka vjedhur mendimet dhe eset e mia!

HALILI — Ooo, më pëlqen se ti qenke më i ndezur nga unë!

ZYLOJA — Dhe kjo nuk është vjedhja e tij e parë... Do t'ia faktoj... Prandaj unë them që ne, personazhet, t'i bëjmë një fejton.

HALILI — Urdhëro?

ZYLOJA — Fejton.

HALILI — Fejton — pajton... Kanë gjë lidhje?

ZYLOJA — Uh!... Me kë kam të bëj!... Kritikë, them, në gazetë!

HALILI — Kundër shkrimtarit!?

ZYLOJA — Pikërisht.

HALILI — Po ia qëndisim, pse jo?... Po do të na i marrin për inate personale... ankesa...

ZYLOJA — Hallet tona nuk i përmendim ne... E sulmojmë për të tjera gjëra. Po të duam ne, ia gjejmë anën. Për ca figura, për shembull... Unë kam vërejtje thelbësore plot... Ia ke lexuar «Baballarët?»

HALILI — Jo.

ZYLOJA — Atje baballarët, prindërit, i krahason me kosorë e jataganë... Më duket një figurë e ngushtë! Krahasim otoman! I pagoditur e pse jo, tendencioz?... Ta themi troç: në vetë jemi baballarë... Ja, unë baba jam... Më shih mirë, a jam unë si kosor?

HALILI — Jo.

ZYLOJA — Po si jatagan?

HALILI — Jo, ore, ç'ne! Ti më shumë ngjet si një vandak.

ZYLOJA — Pa fyerje, pa fyerje! Po mirë, ja, t'i lemë figurat. Ai ka bërë dhe një akt të

shëmtuar... Para se të vidhte esset e mia
ka vjedhur tokë.

HALILI — Jo, ore! Tokë?!

ZYLOJA — Po, po... Baltën e arave!

HALILI — Luaj vendit! Vërtet?!

ZYLOJA — E ka pranuar vetë. E kam këtu!

HALILI — Pse s'thua ti!... Ia gjetëm anën më
duket. (*Me mosbesim.*) Po... e thotë vetë
me gojën e tij?

ZYLOJA — Me shkrim, o, me shkrim!... (*Hap
librin.*) Ja... siç duket në shenjë pendimi
ka shkruar këtë poemën autokritike «De-
voll, Devoll». Ja dëgjo! (*Lexon.*)

*Po, Devoll, i tillë qenkam unë!
Paskam marrë baltën tënde arave
në një trastë leshi, ndënë gunë
për t'ia sjellë Lidhjes së Shkrimta-
rëve.*

HALILI — Oh, oh e zumë!

ZYLOJA — Urdhëro. Ja se ç'njeri është!

HALILI — E zumë, Zylo vëllai, e zumë!... A ka
faj më të madh? Ku ke parë ti të vje-
dhësh tokë?!

ZYLOJA — Tokën mëmë, thuaj, tokën, që, siç
thotë ai vetë, e do aq shumë. «Toka ime,
kënga ime», «Njeriu i tokës», «Selishtet la-
ra-lara», «Dielli është ndalur mbi grurë». Do
ndalemi ne tashti tek ai sepse ka mar-
rrë baltën.

HALILI — Ashtu, ashtu... I është dukur e ëmbël.
Balta, më e ëmbël se mjalta, thotë në një
vend.

ZYLOJA — Nuk e thotë ky këtë.

HALILI — Ky, ky... e kam lexuar unë! I ka qejf
fushat ky... Fushat e gjëra me lule, që

ju kam ndër mend ditë e natë, — thotë në një vend tjetër.

ZYLOJA — Ky është tjetër.

HALILI — Njësoj është. Njësoj janë këta, të thotë Halili... Si, more, të marrësh baltën arave?! Po kush të le! Avash!

ZYLOJA — Po, po... Dhe kur e bën këtë? Në një kohë kur ngrihet me forcë ruajtja e tokës nga erozioni!... Në një kohë kur bujku thotë toka është flori!... Hm... Ky e merr dhe e shpie kot në Lidhjen e Shkrimtarëve, ku s'ia kishte kërkuar njeri, dhe ku, me sa kemi të dhëna, s'e ka mbjellë hiç... Po, se mos ka plan drithërash Lidhja e Shkrimtarëve!

HALILI — Rrofsh, o Zylo, rrofsh!

ZYLOJA — Do kisha dëshirë ta kishte zënë ndonjë nga rojet e kooperativës!

HALILI — *(Me afsh.)* Ah, ta zinte!... Po s'e zë dot... Ja, unë kam qenë rojë... Nën gunë nuk dallohet trasta... Qenka finok ky... Po si vete dhe e pranon vetë! E po se mos e mora për vete, thotë... E shpura atje, në Lidhje, si i thonë...

ZYLOJA — Ah, dakord, po ka rregulla, ligje, kadastër!

HALILI — Po s'do mend... S'ka gjë, mund të thonë liberalët, një trastë leshi! Sa merr trasta!

ZYLOJA — Faji, shoku Halil, duhet të dënohet që në vezë, se mësohet.

HALILI — Ashtu, posi!

ZYLOJA — Sot të merr një trastë...

HALILI — ...nesër të mbush vallixhen. Apo s'vjen shpesh nga Devolli!

ZYLOJA — Pasnesër të mbush dy tre kamionë e dalngadalë të sjell tërë baltën e Devo-

llit, tërë Devollin në rrugën «Konferenca e Pezës» apo të Kavajës, si i thonë, e rrezikon të na e bëjë përshesh gjeografinë e vendit e hartat...

HALILI — Pu pu... Dhe vete ma shkruan në libër! Bie vetë brenda me këmbët e tia!... Po ç'dënim ka marrë për këtë punë, më qafsh?

ZYLOJA — Dënim?! Hm... Në vend që ta dënojnë e recitojnë, e pëlqejnë e duartrokin...

HALILI — Ua!... Ka miq, Zylo, ka miq... E shoh unë, s'kemi ç't'i bëjmë.

ZYLOJA — S'kemi ç't'i bëjmë, Halil, s'kemi ç't'i bëjmë!

qafsh
vash

FSHTARËT DHE KADIU

Rrëfenjë popullore e përpunuar për skenën e estradës.

Personat:

KADIU

MANIA

FSHATARI I

FSHATARI II

FSHATARI III

BUMBASHIRI

FSHATARË TË TJERË

Një sop buzë një pylli. Mania i dëshpëruar është ulur këmbëkryq, me duar në prehër.

KONFERENCIERI — Fshatarit Mane i ka ndodhur gjëma e gjëmave, i ka humbur shoku i tij i punës... I ka humbur gomari...
MANIA — *(U vë veshin zhurmave në pyll.)*
Kërr-kërr, kërr-kërr! Na! Nqë Nqë!... më bëjnë veshët... Gomarin ose ma ka çarë ujku ose do ta ketë trembur asqeri që kaloi

një ditëzaj mizëri, e ai ka marrë arratinë. ... U bënë tri ditë sot... Kam rrahur dhe në... Pa gomarin tim, pa Mashon tim, nuk bëj dot... Mashoja nuk ishte gomar, siç themi ne, gomar e vate. Mashoja dhe unë punonim e i hiqnim hallet tok. (*Tregon torbën e tagjisë që ka në krah.*) Vetëm torba e tagjisë më ka mbetur si kujtim prej tij... (*I përvëlur nga malli.*) Ia zgjatja torbën, sa mirë ia dinim huqet njëri-tjetrit, ia zgjatja torbën dhe ai t'ek! — më shihte... Unë ia zgjatja prapë, ai linte çdo gjë dhe vinte t'ek-t'ek-t'ek e fuste kokën në torbë... Edhe kur më inatosoj kështu e afroja... Me torbë... Dhe e zhdëpja... Se e kam rrahur nganjëherë për gomarllëqet e tij, m'u thaftë dora! Po ma sillte në majë të hundës. Se ishte gomar i madh!... Ia punoja. E afroja me torbë... Nuk kuptonte, ishte ca budalla... gomar me një fjalë... e ndjeftë perëndia! Më thau krahun. (*U ve përsëri veshin zhurmave. Del në drejtim të pyllit dhe që andej vijnë thirrjet e tij. Pas pak shfaqen dy fshatarë.*)

FSHATARI I — E vraftë baba Aliu! Nga na u poftis ky kadi i ndyrë!... Medemek gjykon njerëzit! Gjykon nga qypat e nga hejbetë që i sjellin.

FSHATARI II — Maskarai!

FSHATARI I — Edepësezi!

FSHATARI II — Po qe thesi bosh s'ke të drejtë!

FSHATARI I — Uh, e zëntë një rrufe dhe e lëntë përmbys!

MANIA — (*Që është shfaqur pas.*) Mos u ka rënë në sy një gomar pullali?

FSHATARI I — U rëntë kolera e Hindit dhe i
shoftë kadi, bumbashir e aga! Ikën de-
let tona!

MANIA — Mos... u... një gomar pullali?

FSHATARI II — Pullali?

FSHATARI I — Posi!... Gomar? Posi!... Shko!
Ta kanë bërë kadi!

MANIA — Kadi?!... Unë kam hall, ju...

FSHATARI II — Pse ne nuk kemi halle?

MANIA — Mua më ka humbur gomari!

FSHATARI I — Nuk të ka humbur, or, jo! Ta
kanë bërë kadi! Bën gjyqin e njerëzve,
që i bëshja gropën! Ashtu si gjykon ai
vetëm gomarët gjykojnë!

MANIA — Or, po të jetë për të njohur, e njoh
unë jo kadi, po pasha të bëhet!

FSHATARI II — E po ja, e gjete!

(Fshatarët dalin.)

MANIA — *(Vetëm)* Ç'thonë këta? Të m'i ke-
në bërë Mashos magji?! Po shkoj ta shoh
njëherë atë kadiun e po i rrëfej torbën...
Po të mos e futë kokën, këta miqtë janë
tallur me mua... Po e futi, s'ka — pa një
pa dy, është gomari im!... Njeriu s'ka pse
ta, futë kokën nëpër torba!... *(Del)*

KONFERENCIERI — Dhe u nis fshatari i padja-
llëzuar Mane për të gjetur Mashon e tij...
Kohë të errësirës e të paditurisë, plot pa-
ragjykime e bestytnira... Kufij të prishur
në mes të përrallës dhe të realitetit. ...Dhe
me shpresë arriti e u fut në çardakun ku
kadiu zgjidhte hallet e zënkat e shumta...

*
* *
*

Çardaku ku jep gjykimet kadiu. Një sallë e errët. ... Një gjysmëhënë në murin përballë... Një bumbashir (sekretar) që shkruan përmbys. Kadiu i ulur këmbëkryq edhe ai përmbi një tryezë të madhe ka përpara një libër të trashë me ligje, sheriatin.

KADIU — (*Fshatarit që ka përpara tij.*) Dëgjo, more kokëgdhë! More zorzop!

FSHATARI III — Urdhëro!

KADIU — Agai i fshatit ankohet se njëra nga pulat e tua...

FSHATARI III — Njëra?! Po unë një pulë kam, kadi efendi.

KADIU — Njzë vetëm?!

FSHATARI III — Njzë, më rrofsh sa malet e fushës! Lopë, ka, mëshqerrë — atë kam unë!

KADIU — E eee... Po kur paske një të vetme pse nuk e ruan? Agai ankohet se pula, jote është zënë duke i çukitur me sqep kalinjtë e grurit!

FSHATARI III — Po pulë është, kadi efendi!

KADIU — Ajo është pulë, po s'jemi ne pula!... Ne të punojmë qindin! Se kemi ligjin këtu! Kemi sheriatin!

FSHATARI III — Ç'thotë ligji, efendi? Ç'thotë sheriati?

KADIU — (*Duke hapur sheriatin.*) Bismilahi! Pthtu!... Pulë thamë... Me P... (*Kërkon.*) Pë-pë-pë... Ja — pilaf, pisqollë, popla-popture... Pu-pu-pu pucak, puçër, pulë... M-m-m-m-më! Sheriati thotë që ti duhet

t'i japësh agait të tëra vezët që do të bë-
jë pula këtej e tutje!

FSHATARI III — Po ajo veç një herë çukiti
kallinjtë e agait.

KADIU — Një herë, një herë po ama qe ngo-
pur mirë. Ndaj këtej e tutje vezët do t'ia
japësh agait.

FSHATARI III — Po kjo hata! Po atëherë t'i
jap pulën e t'i laj duart.

KADIU — Jo! Pula është jotja! Kështu thotë
sheriati... Pula është jotja!

FSHATARI III — E po unë atëherë do ta, ther!

KADIU — Jo. Nuk ke të drejtë ta therësh. Po
e there të pret burgu...

*(Të pranishmit presin me murmurima pa-
kënaqësie vendimin e kadiut.)*

FSHATARI III — Oho... Dhe po më ngordhi?

KADIU — Sakën se të ngordh!

FSHATARI III — E po unë s'do të rri pas pu-
lës tani t'i ruaj shëndetin.

KADIU — Po si... Se e ke tënden.

FSHATARI III — Timen, xhanëm, timen, vezët...

KADIU — Janë të agait.

FSHATARI III — Kështu thotë ligji, efendi?

KADIU — Pse, nuk të pëlqen ty, sojsëz?

FSHATARI III — Uaaa!... Më pëlqen si s'më
pëlqen. Të dija të këndoja, do kisha zënë
këngën! Po ç'thotë më, kadi efendi? Ve-
zët agait t'ia jap të ziera apo të skuqura?
Pa vështro sherianë...

KADIU — Avash ta shohim!

*(Kadiu zhytet në lexim. Fshatari i merr
qypin një fëmije që po dëgjon gjyqin.)*

FSHATARI — Ma jep pak, biro! *(Dëgjuesve të
gjyqit.)* Të shihni si do vërtitet sheriati
për mua tani.

KADIU — Këtu nuk thuhet gjë. (*Ngre sytë e i sheh fshatarit qypin. Bumbashirit.*) Ç'e ka atë qyp ai? Për ne?

BUMBASHIRI — Nuk di gjë.

KADIU — Nuk bëri ndonjë shenjë?

BUMBASHIRI — Nuk pashë gjë, u qorrofsha!

KADIU — (*Fshatarit*) Ç'ngjyrë e ke pulën ti, qafir?

FSHATARI III — Të zezë.

KADIU — Për pulat e zeza ka rregulla të tjera këtu.

FSHATARI III — Më të buta apo...

KADIU — Të buta fare. (*Duke hapur librin me zell.*) Po me kujdes... Mbaje mirë se do të derdhet ai qypi që ke në dorë.

FSHATARI III — S'ka gjë ky... Bosh është.

KADIU — Bosh fare?

FSHATARI III — Fare. Ja s'ka gjë. (*E përmbys.*)

KADIU — Epo as këtu nuk ka gjë. (*E mbyll sheriatin.*) Mbetet vendimi i parë. Gjyqi u mbyll.

(*Zhurme. Njerëzit murmurisin.*)

ZËRA — Ama gjyq! Ky qenka kafshë! Hajde, hajde!

(*Hyn Mania me torbën e tagjisë në krah.*)

FSHATARI III — (*Manes.*) Po ky qenka gomar fare!

MANIA — E di! Është gomari im!

KADIU — Pusho!... Qetësi! (*Vendoset qetësia. Turfullon.*) Tfu!

MANIA — Ai është... kështu turfullon gjithnjë.

KADIU — (*I drejtohet Manes.*) Pusho ti atje! Qepe!

MANIA — Ma...

KADIU — Pusho, se të nxora jashtë!

MANIA — (*Me vete.*) Nuk është ai, apo s'më njohu?!

KADIU — Po shpallim vendimet për disa gjyqe që kemi bërë më parë... Telo Haska padit Tolo Hyskën se e ka goditur me shqelmë... Gjyqi dënon Tolo Hyskën me tre vjet burg....

ZËRA — Oooooooo!

BUMBASHIRI — (Nën zë.) Teneqenë me gjalpë e solli Toloja jo Teloja. Nga Teloja s'del gjë.

KADIU — (Nën zë.) Toloja?

BUMBASHIRI — (Nën zë.) Toloja!

KADIU — Po pse s'thua ti?! Unë xheç e futa brënda. (Me zë të lartë.) Qetësi!... Gjyqi thamë e dënon Tolo Hyskën me tre vjet burg po ta ketë goditur me shqelm... por Toloja shpëton se e ka goditur vetëm me opingë. Ishte apo s'ishte këmba e Tolos brenda në opingë kjo nuk ka asnjë rëndësi.

MANIA — Ai është!... Pa t'i rrëfej torbën. (Ia rrëfen torbën me marifet. Kadiu e sheh por nuk e kupton.) Filloi të më njohë.

KADIU — Një hamall ankohet se të birin ia ka kafshuar qeni i kapterit... Kapteri nuk ka faj. Gjyqi vendosi që të verë në vend drejtësinë. Djali i hamallit të kthehet e të kafshojë qenin e kapterit! Siç ia bëri t'ia bëjë.

ZËRA — Ama e zgjidhi!

(Mania tund torbën.)

BUMBASHIRI — (Nën zë.) Se ç'ka sjell një njeri në torbë?

KADIU — Po e shoh... Kryeplakun Rushit fshatarët e paditën se ka ngrënë paratë e mbledhura për çezmën e fshatit. ...Për çezma këtu s'ka të shkrojtur asgjë... Kësaj pune do t'i dalë uji më vonë. (Sheh Manen që po i tund torbën.) Me kaq gjyqi mbyllet...

(Mania tund torbën, kadiu zbret tek Mania dhe fut kokën brenda në torbë.)

MANIA — Zakoni... po u bë zakon nuk harrohet!
Po kam tri ditë që po të kërkoh, more i
paudhë! *(I futet me shkop.)* Na, ore vesh-
gjatë! Na, ore gdhë! Ush... Ush!
*(Britma gazmore e të qeshura të fshata-
rëve.)*

PASIGURIA E JETËS

(Aventurat e një të papuni në botën kapitaliste)

Pasiguria e jetës një fjalë goje... Del nga shtëpia, thua «mirupafshim» e nuk shihesh më. Rrëmbehet foshnja nga karroca me gjithë biberonin e shishen e qumështit... Rrëmbehet vajza nga krahët e dashnorit, dhe kur ky nuk e lëshon, përlehet me gjithë dashnor! Rrëmbehet kryeministri, ndërsa shkruan fjalimin ku premtton garantimin e qetësisë publike. E rrëmbejnë me gjithë fjalim e me gjithë stilograf!... Ndonjë hallexhi, që mbledh kursimet e i fut në bankë, i shpëton paratë nga hajdutët e vegjël e ua dorëzon hajdutëve të mëdhenj... Po hajdutët e vegjël nuk ndahen lehtë. I vjedhin fëmijën e i thonë: nxirr paratë që të të kthejmë fëmijën!

Para jush — kostumi i djalit të industrialistit të madh don Pietro, që prodhon parfum për sjetullat dhe ka një mal me para.

Brenda kostumit jam unë, i papunë kronik, që ngjas me të birin e industrialistit, por nuk jam ai. Gafa ime nis atë çast që provova t'i jap si këmbim për këtë kostum, rrobat e mia me arna që atij iu dukën të mrekullueshme se e shndërruan në varfanjak dhe ai kollaj — kollaj hipi në një anije kontrabandistësh dhe u nis për

aventura, larg vatrës familjare, larg nuses së tij të re dhe larg babait, don Pietros, që gatitej të zgjeronte fabrikën e parfumit...

Mos u çuditni që njeriu mund të bëhet milioner me parfumin e sjetullave... Në shoqërinë tonë të mrekullueshme sjetullat dalin në plan të parë, se në çdo qoshe rruge të thonë «duart lart!»

Që nga moli i tundja shaminë të zotit të shamisë, që po largohej. Më dukej sikur përshëndesja jo atë, po lëvozhgën time që tani mbështillte atë.

Një orë më pas, katër vetë me tetë duar e me tetë shqelma, më lidhën gojën e sytë e më plasën në një veturë duke thënë:

— Tani ta shohim don Pietron kur të na i numërojë drëng në dorë milionat... Ndryshe të birin do t'ia varim nga sjetullat e parfumuara!

E hëngra! Banditët të morën për të birin e industrialistit.


Desha t'u them që ishin gabuar, por atë çast një shami, të themi të drejtën jo e larë aq mirë, më hyri me forcë në zgavrën e gojës... «Po hesht, — thashë, — fundja unë pa punë jam e familjen e kam larg... Po e kaloj ndonjë muaj me këta surretër me maska, derisa don Pietroja të bëjë pazarin me këta.»

Kështu vendosa ditën e parë po pastaj më zuri frika.

Po sikur don Pietros t'i pushonte zemra për të birin?! Zemra e babait është e dhemshur. Një murator nga Gjënova pat shitur shtëpinë për djalin që ia kishin marrë... Po sikur nusja e re të vriste veten nga dëshpërimi për mua, d.m.th. për kostumin, dua të them për të

zotin e kostumit?! Kush do të kujdesej për mua?
...Do shikoja për pesë para spec...

U thashë të vërtetë, por aha... Tërë sendet në xhepat e kostumit thoshin që i biri i industrialistit isha unë... Gabimisht nga xhepat ai pat marrë vetëm paratë, duke më lënë doku-



mentet, fotografi e pako me çamçakizë. Bile në qafë më pat varur një medalion me fotografinë e së shoqes.

Ndërkohë tërë gazetat botonin lajmin e rrëmbimit të don Pietros. Filluan përçapjet për t'i zhvatur paratë milionerit. Filluan intervistat e nuses që qante për dhëndrin e ri... Filluan dhe punimet për zgjerimin e fabrikës së don Pietros.

Kështu e shtymë një muaj.

Fill pas një muaji për mua desh ranë këmbanat. Kishte ardhur përgjigjia përfundimta-

re: babai i «dashur» u kishte thënë banditëve se tërë hallin e kishte tek zgjerimi i fabrikës dhe se nuk do të jepte asnjë grosh e djalit le t'i bënin ç'të donin! Kurse nusja e medaljonit, kishte deklaruar në intimitet se mezi ç'priste vrasjen e burrit, se ishte e bindur që i shkonin për mrekulli rrobat e zeza.

Asaj rrobat mund t'i shkonin po koburja në kokë mua nuk më shkonte hiç. Fat i madh që me një anije u kthyen rrobat e mia të dashura, që sollën edhe djalin aventurier, se banditët s'besonin që s'besonin se ishte bërë një gabim.

Me një mijë mundime mezi më lëshuan. Kështu që unë fillova përsëri të matja rrugët... Televizorët tregonin se si e pritën në shtëpi djalin plangprishës. Don Pietro e puthte me mall, kurse nusja lante me lot burrin e shtrenjtë, që për pak e veshi me të zeza!

PAS ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE

Personat:

PRESIDENTI

PIRSONI

REPORTERË të shtypit dhe të televizionit

NJË SEKRETAR

Ngjarjet zhvillohen në Uashington. Kabineti i presidentit të porsazgjedhur.

PIRSONI — I dashur mik, më në fund!... Pas një fushate të gjatë elektorale u bëtë president i SHBA-së! Urime!

PRESIDENTI — Ju falemi nderit!

PIRSONI — Gjatë fushatës ne ju ndihmuam mjaft.

PRESIDENTI — E di.

PIRSONI — Në fjalimet para zgjedhësve folët për ngritjen e nivelit të jetesës, për begatinë e njerëzve e tjera, e tjera... Ju, si president, mund të kërkonit të fitoni zemrat, po në qarqet e monopoleve nuk ju ndjekin dot. Besoj më...

PRESIDENTI — Ju kuptoj, zoti Pirson.

PIRSONI — Premtoni ulje çmimesh, zhdukje papunësie, barazi për zezakët e të tjera ço-

kollata si këto. Jam i dërguar t'ju porosit që t'i vini gjërat në vend.

PRESIDENTI — Tani nuk ju kuptoj...

PIRSONI — T'i saktësoni programet tuaja... (Pre-rë) Fund ëndrrave! Që sonte me gazetarët...

PRESIDENTI — Po prestigji?...

PIRSONI — Prestigjin tuaj... hëm... Ruajeni prestigjin!

PRESIDENTI — Po si ta bëj këtë kur që ditën e katërt të hipjes në kolltuk, të ha fjalët e thëna... Të gjithë i kanë ngrënë, po me kohë.. gjatë katër vjetëve.

PIRSONI — Gjuha jonë është e pasur... Sonte në konferencën e shtypit mund t'i sqaroni mendimet. Mund të rrëshqisni nëpër nuancat.

PRESIDENTI — (Në hall.) Nuk ju premtoj.

PIRSONI — (Pas një pauze.) Më vjen shumë keq, miku im... Do të bisedojmë përsëri... Ju shoh pak të tronditur para takimit me gazetarët tanë... Keni shumë të drejtë. Kanë ardhur kohë që as për presidentin nuk ka siguri... Besoj se e mbani mend tragjedinë... dua të them... fundin tragjik të dy Kenedëve... Në përgjithësi presidentët e SHBA-së nuk janë të garantuar. I ndjekin plumbat.

PRESIDENTI — Dhe ju jeni ngarkuar që të ma përmendni këtë?

PIRSONI — Për ne jeta juaj është e çmuar. (Tund automatikun.)

PRESIDENTI — Ç'është ky automatik?! Ky është kërcënim i hapur!

PIRSONI — Ç'patët?

PRESIDENTI — Ju keni ardhur tek unë me automatik.

PIRSONI — Oh, jo, gaboheni... Shiko, shiko!...

Më vjen keq që nuk e njihni si duhet teknikën moderne... Ky nuk është automatik, por një aparat marrës televiziv. Çfarë s'u pjell mendja fabrikave tona! (*Nxjerr një revolver.*) Po këtë e shikoni? Çfarë kujtoni se është?

PRESIDENTI — Revolver?

PIRSONI — Jo, mikrofoni. Për intervistë... Shiko se çfarë shpikin! Jua vënë tytën në gojë...

PRESIDENTI — Në gojë? Çudi!

PIRSONI — Po si! Ka aparate marrës si mitra-loza... Mikrofona si bomba... Stilografë në formë thikash, studio si tanke, kinokamera si topa...

PRESIDENTI — Dhe unë do të paraqitem para tyre?

PIRSONI — Po.

PRESIDENTI — Atëhere unë do të dal me helmetë dhe mburojë çeliku.

PIRSONI — Jo, jo, nuk do të ishte figurë e bukur.

PRESIDENTI — Do t'i kërkoja policisë t'i hiqnin këto lloj aparatësh, por belaja është se siguri prapë nuk ka. Ashtu si shpikin mikrofona si bomba, shpikin dhe bomba si mikrofona.

(Hyn sekretari.)

SEKRETARI — Mister president! Kanë ardhur zhurnalistët e gazetave të qarqeve monopoliste.

PRESIDENTI — Le të hyjnë!

(Sekretari del. Pas pak në skenë hyjnë gazetarët. Të gjithë me automatikë, revolverë e bomba. Një gazetar i vë presidentit revolverin në gojë.)

REPORTERI I — Mister president, një përgjigje në mikrofonin tim. Ju keni thënë se po të fitoni në zgjedhje premtoni uljen e çmimeve... Kështu?

PRESIDENTI — Po, por unë e kisha fjalën për faktin se në shumë vitrina çmimet vendosen mbi mallrat shumë lart dhe klientët nuk i lexojnë dot... Do jap urdhër qysh nesër që çmimet të ulen aq poshtë, sa të lexohen!

(Të qeshura, duartrokitje që i udhëheq zoti Pirson.)

REPORTERI II — *(I drejton automatikun.)* Një pyetje lidhur me zezakët, mister president... Aparatin e kam plot...

PRESIDENTI — Plot?!

REPORTERI II — Fillojmë. Ju keni thënë gjatë fushatës së zgjedhjeve se zezakët duhet të respektohen... të nderohen...

PRESIDENTI — Po... Nga vetë zezakët. Njëri me tjetrin.

REPORTERI II — Hokej... Jam i kënaqur, mister!

REPORTERI III — Po të më bëni president, keni thënë ju, unë do të zhduk papunësinë.

PRESIDENTI — Oh jo.. Kam thënë se do të zhduk të papunët... Nuk është po e njëjta gjë.

(Të qeshura e duartrokitje.)

REPORTERI IV — Ç'mendim keni për zbulimet kozmike?... A do të bëhet udhëtimi në kozmos një realitet për të gjithë apo vetëm një luks për të pasurit? Për shebull, a mund ta shikojë hënën një i varfër?

PRESIDENTI — Pa diskutim. Ne kemi plot të varfër pa strehë. Hëna duket për bukuri natën.

(Duartrokitje)

REPORTERI V — Çfarë kishit parasysh kur thoshit: po të bëhem president unë do të marr masa, sepse shpenzimet për armatime janë të rënda... Këto nuk duhet të bien mbi kurrizin e amerikanëve të thjeshtë.

PRESIDENTI — Po... Duhet t'i mbajë dhe kurrizi i amerikanëve të Amerikës Qendrore dhe të Jugut.

REPORTERI VI — Në lidhje me marrëdhëniet me jashtë thatë se 50 % të vëmendjes do t'ia kushtojmë bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe 50 % me Kinën... Bashkëpunimi me këtë të fundit a nuk është rritur ca si shumë? Këto përqindje do të ruhen?

PRESIDENTI — Jo, por me Kinën kemi deficit nga vitet e kaluara. Interesat tona kërkojnë që ato të vihen në vend.

(Duartrokitje)

REPORTERI I RI — Faleminderit mister president. Mund të largohemi?

PRESIDENTI — Ju lutem!

(Dalin të gjithë, përveç Pirsonit.)

PRESIDENTI — *(Duke fshirë djersët.)* Jeni i kënaqur, mister Pirson?

PIRSONI — Plotësisht! *(Duke përkulur kokën.)*

PRESIDENTI — Nuk e kuptoj! Përse më shtrënguat ta them me fjalë atë që po e bëj me vepra?

PIRSONI — Puna është se disa ish-in të shqetë-

suar për deklaratat tuaja gjatë fushatës dhe...

PRESIDENTI — Fushata është tjetër gjë dhe karriera presidenciale është gjë tjetër.

PIRSONI — Si urdhëron, zoti president!

PRESIDENTI — Këtë e di edhe bufi!

PIRSONI — Tamam ashtu, zoti president! Marr leje të largohem... Më lejoni?

PRESIDENTI — Si të dëshironi, zoti Pirson!

PIRSONI — Oh, ç'është ajo! Si të dëshironi ju, zoti president... Ne do të bëjmë ashtu si thoni ju... Ju jeni presidenti... Ne të gjithë jemi nën urdhërat tuaja!



INSPEKTIMI I GJENERAL BURLLAKOVIT

Skeç

Personat:

GJENERAL BURLLAKOVI

TOGERI

SAMUELI — ushtar

DAVIDI — ushtar

USHTARË TË TJERË

Ngjarja zhvillohet në një fushë stërvitjeje të ushtrisë sovjetike. Një skuadër e rreshtuar në «gatitu». Një toger gjithashtu në «gatitu». Asgjë nuk pipëtin. Gjenerali Burllakov i shikon i ndërkyer.

BURLLAKOVI — Mos doni t'ju lajmërojmë një muaj më parë që do të vijmë për inspektim?! Dridheni kur ju vijmë papritur! Eh? Derra të majmur! Pa fjalë! Hm! Ju përgatiteni si ushtarë sovjetikë apo si turistë? *(Duke ulëritur.)* Derra! Hmm!... Pa fjalë, toger!

TOGERI — Nuk thashë gjë, tavarish...

BURLLAKOVI — *(Ulërin)* Pa fjalë! Pa t'ju shohim, bukurosha, sa ju vlen lëkura. Apo kini ndonjë kundërshtim?

USHTARËT — Jo, tavarish...

BURLLAKOVI — Pa fjalë! Pa të fillojmë kontrollin e dijeve tuaja luftarake. (Heq pallton e mbushur me dekorata që tringëllinë dhe mbetet me xhaketën gjithashtu të

mbushur me dekorata. Toger, si një robot, i afrohet dhe gjenerali i var pallton në dorën e tij.)

BURLLAKOVI — (Samuelit) Ti! (Davidit) Ti. Që të dy: tre hapa marsh! (Ushtarët dalin.) Po ju bëj një nga kontrollet më të thjeshtë të thjeshtë fare. Ju të dy më thoni të dhënat e karabinës. (Dy ush-



tarët nuk flasin.) Flisni. Filloni. (Ata heshtin.)

A dini të flisni?

USHTARËT — Si urdhëroni, tavarish...

BURLLAKOVI — Pa fjalë të tepërta! Më thoni vetitë e karabinës. (Heshtje) Ti. Ti tjetri! (Heshtje) Nuk i dini?!... Toger, për këtë ti shkon në litar.

TOGERI — E dini si është puna, tavarish...

BURLLAKOVI — Ushtarë sovjetikë që nuk dinë, të dhënat e karabinës?! Kur liroheni nga ushtria ju të dy?

DAVIDI — Pas një jave!

BURLLAKOVI — Nuk do të liroheni kurrë! Zbërtheni rripat! (Ata i zbërthejnë.) Kalojini rreth qafës! (Ata i kalojnë.) Do t'ju var me rripat tuaj se litarin e ka zënë togeri.

TOGERI — Tavarish gjenerall...
 BURLLAKOVI — Qepe, ti! (*Ushtarëve*) Të mos
 njihni pushkën tuaj!... Po atëherë çfarë
 njihni ju?!...
 DAVIDI — Pushkët amerikane...
 SAMUELI — Ato i njohim për bukuri.
 BURLLAKOVI — Çfarë?! Amerikane?!
 DAVIDI — Me ato stërvitemi ne.
 SAMUELI — Ato i përdorim shkëlqyeshëm! Pu-
 shkët amerikane të tipit të fundit.
 BURLLAKOV — S'njihni pushkët sovjetike dhe
 njihni pushkët amerikane?!... Po kjo është
 të luash mendsh! Ç'janë këta tutkunë,
 toger! A janë ushtarë sovjetikë?
 TOGERI — Këta të dy... të flas? (*Pasi Burllako-
 vi jep shenjë.*) Janë çifutë sovjetikë, çif-
 futë sovjetikë... Lutja u është aprovuar.
 Pasi të lirohen do të shkojnë në Izrael...
 S'do të jenë më sovjetikë. Vetëm çifutë...
 Atje këta përdorin armë amerikane... Se-
 pse Izraeli armët i blen nga amerikanët...
 Kështu që ne i ramë shkurt, po i stërvi-
 tim me to.

(*Pauzë e gjatë.*)

BURLLAKOVI — Kujt i shkoi në mend kjo?
 TOGERI — Mos bë më keq?
 BURLLAKOVI — Kujt i shkoi në mend?
 TOGERI — Keq?
 BURLLAKOVI — S'është keq jo.
 TOGERI — Mua.

(*Gjenerali qesh. Qesh me të madhe. Qesh
 dhe togeri. Fillojnë të qeshin dhe ushtarët.*)

TOGERI — Unë do t'jua thosha, por ju. «Pa fja-
 lë, pa fjalë!» Ha, ha, ha!

SAMUELI — (*Duke qeshur.*) Ne nga Rusia, armët nga Amerika... Takohemi atje dhe pam-pum kundër arabëve, kundër palestinezëve! (*Të gjithë pas gjeneralit e togerit qeshin për mbarimin gazmor të këtij keqkuptimi.*)

TOGERI — Na ngriu gjaku...

BURLLAKOVI — Ja një ide gjeniale. Do të dekorohesh, toger.

NJË USHTAR — (*Njofton*) Në rrugë po kalojnë veturat e delegacionit palestinez!

BURLLAKOVI — (*Menjëherë serioz.*) Rreshtohuni! Përshëndetje! Ata ne i kemi miq! (*Togeri*) Kujdes, ruaj çifutët ti! (*Togeri shkon dhe kap dy bishtat e rripave që u varen çifutëve në qafë dhe mezi i mban. Ata vështrojnë me urrejtje në drejtim të veturave.*)

BURLLAKOVI — Përshëndetni, derra! Qeshni! Tundni duart! Kapelet! (*Të qeshur tundin duart gjenerali e skuadra pas tij. Çifutët mezi i mban togeri nga rripat.*)

KONFERENCA E «ÇARMATIMIT»

Skeç për kukulla


Personat:

KRYETARI I SEANCËS
SALLAMSONI
VELLCOJA
URTISOLI
DELEGATI AMERIKAN
DELEGATI SOVJETIK
KUKULLA TË TJERA

Rreth tryezës kanë zënë vend delegatët. Bisedojnë.

KRYETARI — *(Pasi i ka rënë ziles.)* Seanca 7777!
Raundi 3333!... Shkëlqesitë e tyre delegati
amerikan dhe delegati sovjetik!...
*(Nën tingujt e fanfarave pompoze futen në
sallën e konferencës, të zënë krah për
krah, përfaqësuesit e SHBA dhe BS. De-
legatët kukulla ngrihen në këmbë. Në try-
ezë përballë njëri-tjetrit, janë vendosur
dy kolltuqe dhe aty ulen të dy delegatët,
që bien në sy me përmasat njerzore për-
bri kukullave.)*

KRYETARI — Xhentelmenë, mësje, sinjori, efëndëmë e gospoda! Meqënëse disa shtete duan t'i tërheqin delegatët e tyre ngaqë këtu në Gjenevë po harxhojnë shumë para, kam nderin t'ju njoftoj se harxhet e delegatëve, dietat dhe shpenzimet e varrimit, nëse ndonjë nga delegatët vdes këtu, i marrin përsipër SHBA dhe BS. Hani e pini, zotërinj, se Konferenca do të vazhdojë gjatë!



(Brohoritje, entuziazëm, duartrokitje.)

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: Rëndësia e çarmatimit. Fjalën e merr zoti Sallamson.

SALLAMSONI — Zotërinj! Bota është ngarkuar me armë. Njerëzimi e mban frymën pezull. Dhe ka të drejtë. Po sikur një natë prej netësh t'i shkrepet, fjala vjen, Luksenburgut dhe të zbarkojë në Moskë e të pushtojë Bashkimin Sovjetik? Tmerr! Po sikur Lihtenshtajni me tridhjetë policët e tij të shkulet e t'i bjerë SHBA? Lihtenshtajni mbase aeroplanë nuk ka, por mund t'u presë bileta me aeroplanin amerikan të pasagjerëve që vete çdo ditë në Amerikë. Do të ndodhte katastrofa! Ja pse duhen çarmatosur të gjithë!

(Duartrokitje të stuhishme.)

KRYETARI — Fjalën e merr zoti Vellço Bullgarov!

VELLÇOJA — Drugari! Ku ka më mirë se çarmatimi vre! Ja, Bullgaria s'ka ç'i do armët. Tek ne, populli bullgar dhe ushtria sovjetike rrojnë për bukuri, në harmoni të plotë, vre! Ju kujtohet gushti i 1968-s kur iu sulëm Çekoslovakisë? Sa mirë që ajo ishte e çarmatosur që më parë. Nuk u derdh asnjë pikë gjak. Le t'i hedhim armët. Këtë nuk e them unë... Ky është... vu... vu... vu... (Delegatit sovjetik.) Çfarë më ke shkruar këtu?

DELEGATI SOVJETIK — (I zënë ngushtë, me zë të ulët)... Vullneti i lirë.

VELLÇOJA — ... (Vazhdon fjalimin.) Ky është vullneti i lirë i popullit bullgar... vre... Broftë çarmatimi!

(Duartrokitje)

KRYETARI — Ia japim fjalën zotit Hoze-Maria-Antonios-Feriera-Urtisol.

URTISOLI — Senjores! Le të bëjmë el çarmatimento për opinion internacional. Por el çarmatimento të mos jetë total! Të mbajmë armë se kjo na siguron nga çdo revolucion! Me gusta muço! Po u bë ndonjë revolucion, me gjithë ata të burgosur që kemi në prixhion dhe i gjithë ai proletariado që dhëmbët shtrëngon, sikuramjente, me gjithë lecka na fluturon!... Si konklusion: Somo dakordos, kompletamjente, ke el çarmatimjento të bëhet tamam, siç thotë el delegado Amerikan!

(Duartrokitje)

KRYETARI — Tani do të flasim së bashku delegati amerikan dhe ai sovjetik.

AMERIKANI — Xhentelmenë!

SOVJETIKU — Tavarrishi! Kjo konferencë po i tregon botës dëshirën tonë për paqe.

AMERIKANI — Kjo konferencë është simboli i vullnetit tonë të mirë.

SOVJETIKU — Të gjithë do t'i hedhim armët.

AMERIKANI — Për këtë po përpiqemi.

SOVJETIKU — Për këtë nuk na zë gjumi.

TË DY — Për çarmatimin!

(Një shpërthim i rëndë. Lëkundje në sallën e konferencës.)

ZËRA — Tërmet! Bobo! Ç'është kjo?! Bobo, tërmet!

AMERIKANI — Nou! Tani ne porsa bëmë një shpërthim të ri bërthamor në Nevada.

SOVJETIKU — Jo vetëm ju. Edhe ne provuam një bombë bërthamore në shkretëtirat e Karakumit.

NJË KUKULL — *(Me drojtje)* Po kjo sikur nuk tingëllon mirë. Nga njëra anë flasim për çarmatimin dhe, nga ana tjetër bëjmë prova bërthamore.

SOVJETIKU — Shto ti! Hesht! *(E mbulon me kapelen e tij.)*

AMERIKANI — Kush guxon të ngrihet kundër provave bërthamore?

TË DY — *(Me kërcënim.)* Ëh?

(Delegatët kukulla zhduken nën tryezë.)

AMERIKANI — Ka njeri kundër? (Heshtje) Jo,
ëh?

SOVJETIKU — Kush është pro?

*(Delegatët pa ngritur kokën nxjerrin që
poshtë duart. Duar që dridhen. Janë të
gjithë dakord. Pa kokë. Vetëm me duar.)*

GËZIME NËN ÇATITË E MBROJTURA

Komedi me një akt

Personat:

SOTIRI

ZENUNI

BARDHOSHI — djali i Sotirit

RINA — vajza e Zenunit

XHAXHAI i parë i Rinës

XHAXHAI i dytë i Rinës

Pamja e parë. Në rrugë. Sotiri i veshur me kostum e kravatë bën ecejake nervoze duke trokitur në trotuar majën e bastunit.

SOTIRI — *(Duke liruar kravatën.)* Donte një dru të mirë ai që shpiku kravatat.

(Afrohet me vrap Bardhoshi i djersitur.)

BARDHOSHI — Baba!...

SOTIRI — *(Duke i nxjerrë orën përpara hundëve.)*
Mbarë po e fillojmë!

BARDHOSHI — Baba!...

SOTIRI — Ç'baba, more! Ba-ba! I kërkon vajzën tjetrit, i lë orën që të të presin që t'u shkosh bashkë me tët atë, i lidh

qafën me kravatë babait dhe... Mbarë, shumë mbarë po e fillojmë!

BARDHOSHI — Shiko si është puna, baba..

SOTIRI — Ç'punë! Do të më thuash që bëtë qitje me mitraloz kundërajror? I dëgjova gërr-gërret... Po ama ka një orë e ca që mbaruat. Do të martohesh edhe ti, spurdhjak! Hajde tani.

BARDHOSHI — Nuk vij dot akoma, baba.

SOTIRI — Nuk vjen?! Epo hidh sytë gjetiu. Zenuni s'ta jep çupën. Ia njoh unë huqet atij. Bile unë po habitem si nuk të zuri me dru kur të gjeti me çupën duke i bërë çy-çy-çy përpara pallatit.

BARDHOSHI — E bëjmë kështu: shko ti në fillim...

SOTIRI — Të shkoj unë?! Unë jam martuar një herë... Ai të do ty.

BARDHOSHI — Po kuptojmë, baba. *(Ul zërin.)* Gjatë qitjes, nga pakujdesia e një shokut tonë, mitralozi kundërajror pësoi një defekt. Ne s'mund ta lëmë të bllokuar.

SOTIRI — *(I bie inati që ka me të birin.)* Po pse... Ç'pati?

BARDHOSHI — Ta shpjegoj më vonë. Ti shko përpara tek xha Zenuni e gjej një justifikim për mua.

SOTIRI — *(Pa ditur ç'të bëjë, sheh orën.)* Ku ta gjesh justifikimin? Ata do të jenë mërzitur si puna ime, e presin... Dhëndri i lë kërcu... Phë...

BARDHOSHI — *(E ndërpret.)* Të lutem, baba, mos e zgjat...

SOTIRI — Ke hak xhanëm, ke hak... Ika... Do t'u them të drejtën. *(Niset.)*

BARDHOSHI — Po jo, mor baba! Ky është sekret.

SOTIRI — Ke hak, hiç mos e zgjat... (*I pavendosur.*) Sekret? Po ne do t'i bëjmë miq, more bir...

BARDHOSHI — Miq, miq, po çdo gjë...

SOTIRI — Ashtu... Përsëri ke hak. Asnjëri nuk duhet ta dijë se një mitraloz kundërajror nuk është në gatishmëri... Po hajde shpejt, ëh... Dua të them, bëje punën sagllam, pastaj hajde.

(Bardhoshi ikën me ngut.)

SOTIRI — (*Duke ndjekur të birin me sy.*) Ush-tar i babait!... Po unë ku të vete?! Se mos i mori malli për mua ata! Pastaj ç't'u them? Qenka sekret... Po gënjeva, mua më mbulojnë djersët... Jo, jo. Po e pres Bardhoshin tim këtu. Me atë rast çliroj ca dhe këtë kapistrën, se do të bllokohem dhe unë pastaj e s'ka usta që më ndreq...

(Hiqet mënjanë.)

Pamja e dytë: Shtëpia e Zenunit. Dhoma e pritjes. Zenuni, xhaxhai i parë dhe xhaxhai i dytë, veshur e ngjeshur me kostume, presin. Në një qoshe Rina bluan kafën. Zenuni sheh orën e xhepit. Pas tij shohin orët edhe xhaxhallarët.)

XHAXHAI I — Ama burra!

XHAXHAI II — E dëgjove mirë ti, Zenun, atë djalin? Më orën dymbëdhjetë të tha?

ZENUNI — Nuk më kanë lënë veshët mua! (*Rinës*) Fol, moj ti, ti që na hape këto punë, a tha për sot, të dielën më dymbëdhjetë?

RINA — Më dymbëdhjetë.

ZENUNI — Sytë s'para më shohin mirë, po ama veshët i kam pipëz. S'më shpëton gjë. Ja

dhe mbrëmë... Me vesh i dallova dhe jo më sy. Më erdhi zëri i kësaj: «Të dua, Bardhi!» (*Xhaxhai i parë lëviz pa qejf, Rina ul kokën.*) Posi! «Ah, — thashë, — ime bijë!» Afrohem rrëzë pemëve të rrugës, kur shoh dy hije. Një të gjatë e një të shkurtër. E shkurtër ishte kjo. «Pa dale, pa dale! — i them vetes. Mbahu, Zenun, se të iku vajza! Po kush është ky Bardhi?» U afrova dhe ca... Kjo ma kishte zënë atë zdapin e gjatë për dore...

RINA — Ua, po s'është e vërtetë, baba! Për dore më kishte zënë ai!

ZENUNI — Pusho, ti!

XHAXHAI I — Pusho, ti moj! Dëgjon?

XHAXHAI II — Rina!

RINA — Jo po unë them si është e vërteta.

ZENUNI — Bluaj atë kafe aty dhe hesht! E vërteta është kjo që të them unë... Nuk po të thoshte ai ty «S'ka forcë që të na ndajë»! Eh fol!

RINA — (*Duke ulur kokën.*) «S'ka forcë që të na ndajë», i thashë unë.

ZENUNI — A a a, the ti?! Epo, është një forcë! Kjo forcë është Zenun Dushku! Kur vendos unë...

XHAXHAI II — Po të kesh vendosur ti byrazer, kot na ke thirrur.

ZENUNI — S'kam vendosur akoma... Po si! Hm!... A nuk i the ti «takohemi nesër në mëngjes?»

RINA — I thashë.

XHAXHAI I — Po ai ç'i tha, mor aman?

ZENUNI — «Më mirë në drekë, i tha ai, se në mëngjes kemi qitje me kundërajrorë.»

Mua më hipën nervat,

XHAXHAI II — Po mirë i ka thënë.

ZENUNI — Si mirë?

XHAXHAI II — Pse mos deshe ti që të linte stërvitjen?! Këtë t'i thoshte?

ZENUNI — T'i thoshte që s'do vinte ta takonte kurrë, ore! Se Zenun Dushku nuk i ka qejf këto! Këtë t'i thoshte... Unë rrija e dëgjoja. Pa po m'u ngritën leshrat për-pjetë dhe iu afrova. Nuk ishte mbështetur tek pema ai?

RINA — Tek pema.

ZENUNI — Afrohem unë, që thoni ju dhe i bie me kokë.

XHAXHAI I — Mirë ia bëre!

ZENUNI — Kujt?

XHAXHAI I — Atij de! A i re me kokë djalit?

ZENUNI — Jo, i rashë pemës! Ishte një degë. Mendja vërdallë mua.

XHAXHAI I — Pastaj?

ZENUNI — Pastaj lëre... Jo ç'je ti, jo ç'jam unë! Jo qëllime serioze, jo s'janë serioze! Jo je horr, jo s'jam horr! «Mirë, i thashë, ti merr babanë, unë vëllezërit dhe vajzën e asnjë tjetër dhe qëllimet tuaja të bukura e serioze hajde të na i thoni ditën me diell!»! Kështu e lamë. Ora dymbëdhjetë ai së bashku me të atin do të vinte ta pleqëronim. Të atin e njoh. Burrë i mirë. Po seriozitetin e djalit nuk ia njoh. (Tregon orën.) Ja serioziteti i tij!

(Xhaxhallarët shohin orët.)

ZENUNI — (Rinës) A tha gjallë-vdekur më dymbëdhjetë më ke atje?

RINA — Tha.

ZENUNI — Bujrum! As i gjallë e as i vdekur! Ora një e gjysmë. Vëllezërit e mi presin.

XHAXHAI — Dhe ç'të pritur pa! Hatri yt, vëlla Zenun, pa një minutë nuk prisja. Një minutë! Të kishte ardhur nuk do të më vinte keq për tërë punët që lashë sot. Tani që s'na përfillin më vjen keq edhe për punët më pa rëndësi. Edhe për ty më vjen keq.

XHAXHAI II — Po nuk është halli për punët tona...

XHAXHAI I — Për të tuat ti mos u merakos, kurse të miat...

XHAXHAI II — E çdo të bëje? Do të shkoje për peshk!

XHAXHAI I — Atë e di unë. Mbase edhe për peshk. Shokët më thirrën ...Kurse tjetri s'ta var fare! Mos e ka penguar gjë ky shiu?

RINA — Xhaxhai flet kështu se nuk e njeh Bardhin.

XHAXHAI I — Ja, po e njoh.

XHAXHAI II — Po... kushedi ndonjë gjë serioze...

ZENUNI — Pse, a ka gjë më serioze se kjo?!

XHAXHAI I — S'ka ku të vejë!

XHAXHAI II — Mos e kanë thirrur në punë urgjent?

ZENUNI — *(Prerë.)* Pyeta qëparë në telefon. Në punë s'është! Qitja mbaroi se ja, djemtë e komshiut u kthyen.

XHAXHAI I — *(Brof në këmbë.)* Unë jam shumë i prekur! Nuk na ka mbetur vajza ne në derë! S'presim më!

XHAXHAI II — Presim dhe pak.

XHAXHAI I — Asnjë sekondë!

XHAXHAI II — Edhe pak.

ZENUNI — Presim dhe pak.

XHAXHAI I — Po ama të vemë një kufi.

ZENUNI — Tamam... Deri në orën... (Sheh orën.)

XHAXHAI II — Do t'i mbajmë sytë te ora tani!

ZENUNI — Mirë... E lemë orën.. Po nuk patën ardhur derisa të bluajë vajza kafënë që ka në mulli, çdo gjë mori fund! (Rinës) Luaji duart ti!... Dhe pastaj, të pashë më me të s'je më vajza ime! Jam shumë i fyer! Jam burrë unë nuk jam krap!

XHAXHAI I — (Nën zë.) Mos na kujto edhe peshkun tani!

(Rina e ngadalëson bluarjen. Kur ata e shohin, ajo e shpejton dorën e kur ata i heqin sytë prej asaj ajo bluan fare, fare ngadalë.)

XHAXHAI II — Si familje, Zenun...

ZENUNI — Janë familje e mirë. I njoh me rrënjë. Po ç'e do, s'janë të përpiktë.

XHAXHAI I — Mbaroi kafeja?

RINA — Jo, jo... Ky mezi bluan.

ZENUNI — Është ca i pamprehur djalli.

XHAXHAI I — (Me inat.) Shpjereni tek ustai!

XHAXHAI II — Dëgjoj zhurmë. Erdhën më duket.

XHAXHAI I — Po s'do mend. Pushoi shiu.

(Zilja. Ngrihen të gjithë. Xhaxhai II del t'i presë.)

XHAXHAI I — T'i thonë faleminderit mullirit.

(Hyn Bardhoshi me Sotirin.)

SOTIRI — (Duke hyrë.) Ju lutem të na falni. Kishim një punë që...

ZENUNI — (Duke i dhënë dorën.) A ka punë më të rëndësishme se kjo që kishim lënë në orën dymbëdhjetë?

XHAXHAI I — Hm... ne e dimë se përse keni ardhur këtu...

SOTIRI — Kam ardhur të bëhem i miq.

XHAXHAI I — Mbase nxitohem po... të bëhem i miq me njerëz që na, fyejnë që ditën e parë, që çupën tonë e vlerësojnë më pak se, fjala vjen, psonisjen e së dielës!

SOTIRI — *(Duke ruajtur buzagazin.)* Nuk psonisi njeri, ore krushk!

XHAXHAI I — Ende nuk jemi bërë krushq!

ZENUNI — Fjala është fjalë!

SOTIRI — Meqë ju e çmoni fjalën atëherë, ju lutem, na besoni në fjalë. Kishim arsye të fortë.

ZENUNI — Duhet të ketë qenë më e fortë se pleqësimi i një martese?

SOTIRI — Më e fortë, Zenun, më e fortë... Se nusja e njerëzit e saj presin por...

XHAXHAI I — Ju po na fyejeni përsëri!

BARDHOSHI — Po thuaja, baba... Ata duhet të na kuptojnë.

SOTIRI — *(Bardhoshit)* Nuk është sekret?

BARDHOSHI — Jo, tani s'është sekret.

SOTIRI — Thuaja vetë.

BARDHOSHI — Babai i Rinës! Ju, xhaxhallarë! Ti, Rina...

XHAXHAI I — Këtej, këtej! S'ke punë me Rinën ti!

XHAXHAI II — Rina të beson, mor djalë, po na e thuaj neve.

BARDHOSHI — Kur po mbaronim qitjen, arma na pati një defekt të vogël... Ne u vonuam për ta ndrequr, për ta lënë në gatishmëri.

(Pauzë)

SOTIRI — Ja, kjo ishte.

(Pauzë)

XHAXHAI I — S'mund të na lajmëronit?

SOTIRI — Ke të drejtë, po s'para lajmërohen këto gjëra.

XHAXHAI I — S'mund ta ndreqnin të tjerët?

RINA — (Me nxitim.) Bardhi është mekanik.

Më mirë se ai... Ai i ka duart flori!

XHAXHAI I — Jo, moj!

ZENUNI — Pusho, ti!

XHAXHAI I — Megjithatë...

SOTIRI — (Duke u munduar të ruaj gjakftohtësinë.) O po, çfarë megjithatë. Ti u preke për vonesën. S'them jo. Po pse, mua s'më vjen mirë që djali të vijë siç duhet?! Ne veshur e ngjeshur me kostume e kravatë, kurse ky, kryesori... Shikoja këpucët! (Duke i zbërthyer pardesynë.) Dhe pardesynë e ka të komisarit, një pensionisti të lagjes sonë. Ja shiko! (I hap gjoksën.) As kostum, as kravatë e as trëndafil. Ushtar. E kështu e kam djalin unë, ushtar. Do të ma jepni pëlqimin?

(Pauzë)

XHAXHAI II — Unë jam dakord!

RINA — Dhe unë.

XHAXHAI I — S'të pyeti njeri ty! Ka radhë kjo punë. Fol, Zenun. Më duket se arsyeja është vërtet shumë e fortë. Vetëm për këtë s'na vajti mendja.

BARDHOSHI — Kjo s'na kishte ndodhur asnjëherë.

ZENUNI — Po do të ndodhë më?

BARDHOSHI — Kurrë më!

RINA — Bardhi i ka duart e arta!

BARDHOSHI — Vetëm një mitraloz ishte, por edhe ai duhej lënë në gatishmëri... Ndo-

njëri mund të thotë: «Dhe nesër ndreqej ai. Një i vetëm është! Se mos do të na sulmonin armiqtë sot!»

XHAXHAI I — S'thashë gjë unë!

BARDHOSHI — Edhe unë s'thashë për ty, xhaxha, po komisari thotë se agresionin ushtarak nuk duhet ta mendojmë për nesër. Ne s'përgatitemi për nesër. Jemi të përgatitur për sot, për këtë ditë, për këtë orë, për këtë minutë. Dhe gatishmërinë e kemi xixë. Le të urdhërojnë po të duan!

SOTIRI — Shoku Zenun Dushku, do të ma japësh vajzën për djalin?

XHAXHAI I — Zenun!

XHAXHAI II — Zenun!

ZENUNI — Prishur mos qoftë! Çupë, thuaju grave — kafetë!

XHAXHAI I — (Nën zë) Po po po!... Ajo s'e ka bluar akoma!

RINA — (Së cilës i ndrisnin sytë.) E e! Unë e kisha bluar me kohë. Kot po e rrotulloja dorën!

PASQYRA E LËNDËS

Njeriu i vitit 2001	3
Gjyshi dhe nipi	6
O burra, se na zunë	11
Fryma vullnetare	17
Mëngjese prilli... ..	25
Ilaçet kushtojnë lirë	32
Kungull, kungull... ..	35
Kontroll në magazinë	40
Kostumi	47
Gruaja ime e dashur me pallton me çërka... ..	54
Përvojën e ke pranë	56
Shoku Burhan del për kontroll	62
Njeriu i «mrekullueshëm»	65
Lidhemi me linjë	70
Ëndrrat e Lipës	75
Drejtori i ndërmarrjes	79
Peçoja ka rezerva	87
Alma rrjedh nga majmuni	92
Ushqimi i fëmijëve tanë	95
Fantazi me temë provimesh	99
Një ngjarje në tren	104
Katër sy të mbyllur drejt gjendjes civile	110
Kujt i bërtisni ju?!	114
Në maternitet natën e Vitit të Ri	117
Portrete pa makiazh	123